- Ф. ЛОЈ, Организација на истрагите и на односите со судската полиција, Collection of texts, Twinning project: Fight against organized crime and corruption unit – Public Prosecutor’s Office, ISISC, Ohrid 2009;
- В. МАФЕО/ Ц. САНТАЛУЧИЈА, Истражна постапка, Collection of texts, Twinning project: Fight against organized crime and corruption unit – Public Prosecutor’s Office, ISISC, Ohrid 2009;
- Ј.-М. ЈЕХЛЕ / М. ВАДЕ (Eds.), Coping with Overloaded Criminal Justice Systems- The Rise of Prosecutorial Power across Europe, Göttingen, 2005;
- Н. МАТОВСКИ, Казнено процесно право, Општ дел, Скопје/ Штип, 2003;
- Н. МАТОВСКИ, Казнено процесно право, Посебен дел, Скопје/ Штип, 2004;
- Н. МАТОВСКИ /Г. БУЖАРОВСКА/ Г. КАЛАЈЦИЕВ, Казнено процесно право, Скопје/ Штип, 2009;
- М. MOSKOWITZ, Problems in Criminal Procedure: The Police, 4th edition, LexisNexis, 2004;
- D. NOVOSEL, Rezultati istraživanja u vezi rada policije, državnog odvjetništva i istražnog suca u predkaznenom (predistražnom) postupku – uhićenja i odbačaj kaznene prijave, МРКПК, год. 15, бр. 1, Скопје, 2008;
- D. NOVOSEL., Prijedlozi i predložena rješenja o istrazi i posebnim istražnim radnjama u nacrtu Zakona o kaznenom postupku Republike Hrvatske i tekstu prednacrtu Zakona o kaznenom postupku Republike Makedonije, МРКПК, год. 15, бр. 2-3, Скопје, 2008;
- В. ПАВИШИЌ, Europski sustavi kaznene istrage na početku trećeg milenija, во Зборник на трудови на Правните факултети во Скопје и Загреб, Скопје/Zagreb, 2007, 321-341;
- В. ПАВИШИЌ, Pogled na prethodni postupak u europskom kaznenom pravu, во: Suzbijanje kriminaliteta, Beograd-Kragujevac 2004, 463-469;
- В. ПАВИШИЌ, Ed. and G. Insolera, G. Giostra, Talijanski kazneni postupak, Pravni fakultet Sveučilišta u Rijeci, 2002;
- П. ПРОФИТИ, Нов однос помеѓу полицијата и јавното обвинителство, Collection of texts, Twinning project: Fight against organized crime and corruption unit – Public Prosecutor’s Office, ISISC, Ohrid 2009.
- K. REID, A Practitioner’s Guide to the European Convention on Human Rights, Sweet & Maxwell, London, 1998;
- Т. СТОЈАНОВСКИ, Балансот на моќта меѓу полицијата и јавниот обвинител, МРКПК, год. 15, бр. 1, Скопје, 2008;

94

- М. ТРОМБЕВА, Претходната постапка според новините во Нацрт текстот на ЗКП на РМ, во: *Iustitia*, Бр. 2, 2010, стр. 20;
- Т. ВИТЛАРОВ, Улогата на јавниот обвинител во новиот нацрт на ЗКП, во: *Iustitia*, Бр. 2, 2010, стр. 16;
- М. ШКУЛИЌ, Коментар Законика о кривичном поступку, Сл. Гласник, Београд, 2007.







CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

343.132(497.7) (035)

БУЖАРОВСКА ГОРДАНА

Истражни дејствија : прирачник за практичари / [автори Гордана Бужаровска,
Дејвид Ре, Мајкл Г. Карнасас], - Скопје : OSCE, 2010 - 264 стр ; 21 см

Текст на мак., алб., и англ., јазик. - фусноти кон текстот -
Библиографија: стр. 91 - 94 ; 177 - 180 ; 261 - 264. -
Содржи: Veprimet hetimore ; Investigative activities

ISBN 978-608-4630-08-1

1. Ре, Дејвид [автор] 2. Карнасас Мајкл Г. [автор]. - I. Vuzharovska, Gordana види
Бужаровска Гордана. - II Vuzharovska Gordana види Бужаровска Гордана
а) Кривична постапка - Истражни дејства - Македонија - Прирачници
COBISS.MK-ID 86374154

Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimin
apo qëndrimin e Misionit Vëzhgues të OSBE-së në Shkup.

Të drejtat e autorit:
Misioni Vëzhgues i OSBE-së në Shkup
Oktomvriska Revolucija pn
Shkup
www.osce.org/skopje

VEPRIMET HETIMORE DORACAK PËR PROFESIONISTËT

Dhjetor 2010

osce Organization for Security and
Co-operation in Europe
Spillover Monitor Mission to Skopje



Autorë:

Veprimet hetimore sipas Ligjit të ri të Procedurës Penale*

Praktika komparative mbi hetimin

Dejvid Re

Mbledhja e dëshmimeve nga palët

Majkl G. Karnavas

** Përgatitur nga Prof. Dr. Gordana Buzharovska
në bashkëpunim me Prof. Dr. Gordan Kalajxhiev*



■ PËRMBAJTJA

PJESA 1. VEPRIMET HETIMORE SIPAS LIGJIT TË RI TË PROCEDURËS PENALE ..11

1. VËREJTJE HYRËSE	11
2. BRAKTISJA E HETIMIT GJYQËSOR	11
2.1. Analizë e shkurtër e hetimit aktual	11
2.2. Arsyt kryesore për braktisjen e hetimit gjyqësor	13
3. RAPORTE TË REJA PROKURORI - POLICI	15
3.1. Konstruktimi i policisë gjyqësore	15
3.2. Qendrat hetimore të prokurorisë publike	16
4. ECURIA E PROCEDURËS PARAPRAKE	17
4.1. Procedura parahetimore	18
4.2. Procedura hetimore	23
5. VEPRIMET HETIMORE	26
5.1. Bastisja	27
5.2. Sigurimi i përkohshëm dhe konfiskimi i sendeve apo i pronës	28
5.3. Marrja në pyetje e të dyshuarit	28
5.4. Marrja në pyetje e dëshmitarëve	29
5.5. Ekspertiza	30
5.6. Inspektimi dhe rekonstruktimi	30
6. MASAT E VEÇANTA HETIMORE	31
7. HETIMET E MBROJTJES	32

PJESA 2. PRAKTIKA KOMPARATIVE MBI HETIMIN	35
1. HYRJE	35
2. ANGLIA DHE UELLSI (BRITANIA E MADHE)	37
2.1. Hyrje.....	37
2.2. Roli i policisë si hetuese	38
2.3. Roli i prokurorit	40
2.4. Akuzimi i të dyshuarve për veprën penale	41
2.5. Hetimet nga Prokurori.....	43
2.6. Roli i avokatit mbrojtës	43
2.7. Zbulimi i dëshmive	44
3. ITALI.....	45
3.1. Hyrje.....	45
3.2. Prokurori si hetues	46
3.3. Roli i gjykatësit të procedurës preliminare gjudice per le indagini preliminare (gip)	47
3.4. Marrja në pyetje e personave të cilët janë nën hetime, të dyshuarve dhe të drejtat e tyre.....	48
3.5. Mbarimi i hetimeve	49
3.6. Dëgjimi preliminar	50
3.7. Të drejtat e të pandehurit dhe hetimet e mbrojtjes	51
4. BOSNJA E HERCEGOVINA	52
4.1. Hyrje.....	52
4.2. Paraburgimi gjyqësor	53
4.3. Roli i prokurorit	53
4.4. Roli i mbrojtjes në fazën hetimore.....	55
5. GJYKATAT DHE TRIBUNALËT NDËRKOMBËTARE PENALE	56
5.1. Hyrje dhe pasqyrim	56
5.2. Tribunali Ndërkombëtar për Krime në ish Jugosllavi	57
5.3. Il Gjykata Ndërkombëtare për Krime	59
5.4. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut	60

VEPRIMET HETIMORE - DORACAK PËR PROFESIONISTËT 9

PJESA 3. MBLEDHJA E DËSHMIVE NGA PALËT	65
1. HYRJE	65
2. ZHVILLIMI I TEORISË SË RASTIT	67
3. LISTA E DETYRAVE PËR PËRGATITJEN E RASTIT PËR NË GJYKIM	70
4. GRUMBULLIMI I PROVAVE NËPËRMJET HETUESIT	73
5. MODEL RAPORTI HETIMOR	79
 LITERATURA.....	85



PJESA 1. VEPRIMET HETIMORE SIPAS LIGJIT TË RI TË PROCEDURËS PENALE

1. VËREJTJE HYRËSE

Me Ligjin e ri për procedurë penale (LPP)¹ ndryshohet në tërësi koncepti i deritanishëm, i cili në thelb ka qenë procedurë inkuizitore, i dizajnuar si hetim zyrtar i gjyqit. Heqja dorë nga paternalizmi gjyqësor paraqet diçka më të madhe se sa vetëm një ndryshim kozmetik i modelit ekzistues². Është me rëndësi të kuptohet se sistemi i ri nuk është vetëm zëvendësim i thjeshtë i hetimit gjyqësor me hetim të prokurorit. Gjithsesi, prokurori publik nuk do ta bëjë të njëjtën gjë që deri tani e ka bërë gjykatësi hetues. Hetimi policor dhe hetimi i prokurorit në sistemin e ri plotësojnë dhe bashkëpunojnë njëri me tjetrin, ndërsa hetimi gjyqësor praktikisht anashkalohet dhe nuk zëvendësohet me ndonjë hetim formal të prokurorit. Në tekstin në vazhdim paraqiten çështjet më të rëndësishme të modelit të ri të hetimit dhe të logjikës së përdorimit të tyre.

2. BRAKTISJA E HETIMIT GJYQËSOR

2.1. Analizë e shkurtër e hetimit aktual

Procedura paraprake tani përfshin *procedurën parahetimore* dhe *hetimin*. Vendimi për padinë penale dhe procedura parahetimore kanë për qëllim të qartësojnë se vallë dyshimi fillestar për kryerjen e veprës penale është i arsyeshëm. Prandaj, prokurori publik dhe policia nën udhëheqjen e tij, mbledhin informata në mënyrë joformale. Gjatë procedurës prokurori publik i ndërmerr të gjitha veprimet me ligj për të cilat është i autorizuar, qoftë vet, apo nëpërmjet personave të cilët në bazë të ligjit për prokurorinë publike janë të autorizuar ta përfaqësojnë atë gjatë procedurës penale.

¹ "Ligji ekzistues" i referohet Ligjit për procedurë penale të vitit 1997 me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, ndërsa „Ligji i ri“ për Procedurë Penale i referohet Ligjit për Procedurë Penale i cili u soll në vitin 2010.

² Shih G. BUZHAROVSKA dhe G. KALAJXHIEV, Reforma e procedurës penale, Përmbledhje tekste nga projekti për luftë me krimin e organizuar të prokurorisë publike, Shkup/Ohër, 2009, 13.

12

Nëse ekzistojnë baza të dyshimit se është kryer veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, MPB-ja është e obliguar t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme të gjendet autori i veprës penale, ashtu që ai ose bashkautori të mos mund fshihen ose të ikin, të zbulohen dhe të sigurohen gjurmët e veprës, si dhe sendet të cilat mund të shfrytëzohen si dëshmi. Për këtë arsye, policia mund të kërkojë njoftime të nevojshme nga qytetarët, të ndalojë, të legjitimojë, të kryejë kontrollime dhe bastisje, të orientojë në drejtim tjetër apo të kufizojë lëvizje të qytetarëve dhe të mjeteve për transport, të organizojë ndjekje, të shpallë urdhër arresti apo lajmërim për pronën apo përfitimin nga pronë. MPB-ja mund të thërret persona në bisedë informative, mirëpo personi i thërritur mund të sillet me forcë vetëm me vendim gjyqësor dhe vetëm atëherë kur qartazi i shmanget paraqitjes sipas ftesës së dorëzuar në mënyrë të rregullt, ku paraprakisht i është tërhequr vërejtja për mundësinë e sjelljes me forcë.

Kur sillet vendimi për padi penale, e nëse të dhënat në të nuk japin bazë të mjaftueshme për të vendosur këtë, atëherë prokurori publik nëse nuk ka mundësi këtë ta bëjë vet ose nëpërmjet organeve të tjera, mund të kërkojë nga MPB-ja mbledhje të njoftimeve të nevojshme dhe masa të tjera për të zbuluar veprën penale dhe autorin e saj. Prokurori publik, gjithashtu, mund ta thërrasë parashtruesin e padisë penale, të dyshuarin dhe mbrojtësin e tij dhe persona të tjerë, për njohuritë e të cilëve konsideron se mund të kontribuojnë në vlerësimin e vërtetësisë së të dhënave të shënuara në padi, veç kësaj si dëshmi gjatë procedurës ai mund të shfrytëzojë edhe procesverbalet për njoftimet e marra, të nënshkruara nga personat. Në bazë të rezultateve nga procedura parahetimore, prokurori publik vendos se a do të ngrejë akuzë të menjëhershme, do të parashtrorë kërkesë për kryerje të hetimeve apo do të heqë dorë nga ndjekja.

Gjatë procedurës parahetimore, policia është mjaft e fuqishme. Kjo mund të shihet edhe nga dispozitat e Ligjit mbi policinë, i cili asaj ia jep detyrat për pengim të kryerjes së veprave penale dhe kundërvajtjeve, zbulim dhe kapje të autorëve të tyre, si dhe ndërmarrje të masave të tjera të parapara me ligj për ndjekje të autorëve të këtyre veprave (neni 5 par. 1). LPP gjithashtu e obligon policinë ta gjejë autorin, t'i sigurojë të gjitha dëshmitë dhe t'i mbledhë të gjitha informatat relevante. Mirëpo, kjo nuk paraqet fund të hetimeve policore të cilat vazhdojnë *ex officio*, gjë që në praktikë nuk shkakton asnjë reagim të prokurorëve publikë. Është shumë e paqartë se në cilat raste ekziston nevoja që prokurori publik ta marrë në dorë hetimin nga policia. LPP i jep policisë autorizime të mëdha, duke e përfshirë edhe autorizimin e gjerë për të ndërmarrë "masa dhe veprime të tjera të nevojshme", prandaj është e qartë se ligji në mënyrë të hapur i drejtohet policisë si organ që është përgjegjës për kryerje të hetimit. E gjithë kjo rezulton me mungesë të ndarjes së qartë të funksioneve të organeve shtetërore në procedurën paraprake.

Hetimi gjyqësor është pjesë e procedurës paraprake dhe me të udhëheq gjykatësi hetues. Hetimi fillon me kërkesë të prokurorit publik ndaj një personi të caktuar, kur ekziston dyshim i arsyeshëm se ai ka bërë vepër penale. Kur ekziston dyshimi për kryerje të veprës penale për të cilën është paraparë dënim me burg mbi 5 vjet, fillimi i hetimit është i detyrueshëm. Gjykatësi hetues e përfundon hetimin kur të shohë se gjendja në të cilën ka arritur hetimi është qartësuar në nivel të mjaftueshëm. Pas përfundimit të hetimit, gjykatësi hetues ia dorëzon aktet prokurorit publik, i cili është i obliguar që në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh të japë propozim që hetimi të plotësohet, të ngrejë aktakuzë ose të japë deklaratë se heq dorë nga ndjekja e mëtutjeshme.

2.2. Arsyet kryesore për braktisjen e hetimit gjyqësor

Ndarja e paramenduar fillimisht e procedurës paraprake, edhe atë në stadin e parë (procedura parahetimore) – në duart e pushtetit ekzekutiv, të cilit i ishin besuar punët që lidheshin me zbulimin dhe me kapjen e autorit të veprës penale, si dhe me gjetjen dhe me sigurimin e dëshmive, dhe në stadin e dytë – në duart e pushtetit gjyqësor, në të cilin prezantohen dëshmitë të cilat do të mund të shfrytëzoheshin juridikisht gjatë gjykimit, në praktikë dështoi dhe kjo u bë e panevojshme. Nga njëra anë, punët policore për zbulim dhe sigurim të dëshmive janë zgjatur nëpër tërë procedurën paraprake, e nga ana tjetër, prokuroria publike punët e saj i redukton në rolin teknik të “vlerësuesit” të rezultateve policore, duke i lanë anësh punët tjera, thelbësore të ndjekjes penale. Prandaj, mund të thuhet se sistemi ekzistues i procedurës paraprake, sipas të cilit të gjitha subjektet në mënyrë të ngjashme i kryejnë punët e hetimit dhe të ndjekjes penale, nuk arrin që në mënyrë të qartë dhe të prerë t’i ndajë detyrat e policisë, të prokurorëve publikë dhe të gjykatësve.

Dallimi në mes të veprimeve parahetimore dhe hetimeve në sistemin ekzistues e ka humbur rëndësinë dhe është shndërruar në një formalitet të thjeshtë: me veprimet parahetimore do të duhej të udhëhiqte prokuroria shtetërore, mirëpo ajo nuk e bën një gjë të tillë, por ia lë policisë; hetimet duhet t’i bëjë gjykatësi hetues në mënyrë të pavarur, mirëpo ai kufizohet në zbatimin e propozimeve të prokurorisë publike, të cilat vetvetiu, më së shpeshti vetëm e përsërisin atë që prokuroria e ka marrë nga policia. Me këtë, praktika është larguar mjaft nga qëllimi të cilin historikisht e kanë pasur ligjvënësit kontinentalë evropianë.

Në këtë mënyrë, modeli ekzistues, në njëfarë mënyre, u bë redundant dhe joekonomik: faktet relevante juridike në fillim i vërteton policia për nevojat e ndjekjes penale, pastaj gjykatësi hetues dhe në fund gjyqi, edhe pse do të mjaftonte që procedura paraprake të orientohej vetëm te njoftimet dhe dëshmitë

14

të cilat janë të nevojshme për vendimin dhe për ndjekje penale, të përfundohet me kontrollin e padisë, ashtu që shqyrtimi kryesor të organizohet dhe realizohet në funksion të sjelljes së aktgjykimit të merituar, në përputhje me principet e prezantimit dhe vlerësimit të drejtpërdrejtë dhe kontradiktor të dëshmive. Prandaj, reforma e procedurës ndëshkuese i hodhi poshtë këto kundërthënie me një shpërndarje të menduar mirë dhe precize të punëve që janë të qarta dhe të ndara mirë për policinë, prokurorinë publike dhe për gjyqet.

Nëse qëllim kryesor i hetimit është me të vërtetë mbledhja e dëshmive për të sjellë vendim se prokurori a do të ngrejë padi, atëherë nuk është e logjikshme që dëshmitë për këtë prokurorit publik t'ia mbledhë gjykatësi hetues. Edhe më i çuditshëm është fakti që gjykatësi hetues të punojë në qartësimin e rastit, e në fund nuk jep as mendim për atë se a konfirmohen dyshimet nga fillimi i hetimit, por vetëm, ia kthen aktet si një grumbull materialesh, të cilat ky do t'i shqyrtojë më pas për ta sjellë vendimin e tij. Me këtë komplikim, hetimi zgjatet pa nevojë, ndërsa me kyçjen e gjykatësit hetues si hetues aktiv, shpeshherë ndodh që ai të jetë i njëanshëm, e me këtë edhe i papërshtatshëm si garantues i të drejtave dhe i lirive të qytetarëve.

Njëra nga arsyet kryesore për heqje dorë nga gjykatësi hetues është ajo se ai u tregua joefikas në të dy rolet: në fakt nuk mbledhte shumë dëshmi, të ndryshme nga ato që i kanë mbledhur më parë organet e zbulimit dhe të ndjekjes, e as nuk i mbronte në mënyrë efikase të drejtat dhe liritë e individit. Prandaj, procedura hetimore tani *çformalizohet* dukshëm – dëshmitë nuk prezantohen, por vetëm *mbledhen*, ndërsa për herë të parë prezantohen në shqyrtimin kryesor, përveç në raste të caktuara, kur mund të organizohet seancë e veçantë dëshmuese gjyqësore. Me këtë, procedura paraprake përshpejtohet dukshëm, e po ashtu edhe potencohet rëndësia e shqyrtimit kryesor, si pjesë qendrore e procedurës penale, ku dëshmitë testohen në shqyrtim publik dhe kundërshtues, që është esenciale për një gjykim të drejtë.

Në këtë aspekt rregullat për dëshmim gjatë hetimit nuk janë të rregulluara deri në fund, kurse mjetet dëshmuese nxirren dhe përpunohen në Kapitull të veçantë të LPP-së. Ligji po ashtu ka edhe koncept tjetër për *veprimet hetimore* nga Ligji aktual i procedurës penale, për shkak se implementimi i përpiktë i konceptit të ri nuk nënkupton marrje në pyetje të dëshmitarëve dhe të ekspertëve me qëllim të prezantimit të dëshmive qysh gjatë hetimit.

3. RAPORTE TË REJA PROKURORI - POLICI

Sot, shumica e shteteve bashkëkohore, udhëheqjen e tërë procedurës paraprake ia besojnë prokurorisë publike, në bashkëpunim të ngushtë me policinë dhe numrin gjithnjë e më të madh të organeve të specializuara të cilat punojnë në përcjelljen, analizën dhe zbulimin e formave të ndryshme të kriminalitetit dhe korrupsionit. Me qëllim që të bëhet institucion i respektuar që do të garantojë sundimin e të drejtës në demokracitë bashkëkohore, prokuroria publike gjithnjë e më shumë profilohet si organ i veçantë dhe i pavarur i gjyqësisë, duke u distancuar nga pushteti ekzekutiv.

Policia dhe organet e tjera me autorizime të veçanta, në princip punojnë nën udhëheqjen e prokurorisë publike, mirëpo edhe më tej gëzojnë autonomi të caktuar dhe mbikëqyrjet policore i udhëheqin në mënyrë të pavarur dhe me iniciativë vetjake. Kjo nuk do të thotë se policia me njoftimin apo dorëzimin e padisë te prokurori publik do të tërhiqet tërësisht nga rasti.³ Përkundrazi, asnjë dispozitë e ligjit të ri nuk duhet të interpretohet si marrje e pushtetit apo pasivizim i policisë në hetimet e saja kriminalistike. Përkundrazi, me bashkëpunimin më të afërt me prokurorinë, ata do të fitojnë në kualitet, do të jenë më të suksesshëm në gjyq, e gjithashtu do të fiton edhe besim më të madh te qytetarët. Policia me të vërtetë më shpesh dhe më herët se sa tani do ta informojë prokurorin publik, mirëpo edhe më tutje do të ruajë një autonomi të rëndësishme te veprat më të lehta kriminale, e në bashkëpunim me prokurorin publik dhe në bazë të urdhrave dhe udhëzimeve të tij, do t'i ndihmojë në mënyrë aktive në zbardhjen e e veprave më të rënda kriminale.⁴ Me fjalë të tjera, kur prokuroria publike do të japë urdhëra ose orientime të caktuara, policia është e obliguar t'i respektojë ato, mirëpo nëse në ndonjë rast konkret, pasi ta informojë prokurorin nuk merr asnjë udhëzim, ajo do të vazhdojë me procedurat standarde të zbulimit dhe të sigurimit të dëshmive dhe për këtë do ta informojë prokurorin publik, dhe atëherë kur do të konsiderojë se rasti është qartësuar deri në atë nivel që konsiderohet dyshim i arsyeshëm ndaj një personi të caktuar, do të parashtrijë padi penale te prokurori.

3.1. Konstruktimi i policisë gjyqësore

Ligji i ri për procedurë penale parasheh të ashtuquajturën „*policia gjyqësore*“.⁵ Në fakt bëhet fjalë për polici kriminale e cila bashkëpunon së afërmi me prokurorinë

³ Shih G. KALLAJXHIEV/ D. ILIQ, Formimi, organizimi dhe funksionimi i policisë gjyqësore dhe i qendrave hetimore të prokurorisë publike, RMDPK, nr. 2, 2009, fq. 121-154.

⁴ Shih G. KALLAJXHIEV, Reforma e hetimit në Republikën e Maqedonisë, në: *Iustitia*, Nr. 2, 2010, fq. 12.

⁵ Shih G. KALLAJXHIEV, dhe të tjerët, Raportet e reja në me stë policisë, prokurorisë publike dhe gjyqit në procedurën paraprak, RMDPK, nr. 1, 2008 dhe G. KALLAJXHIEV dhe të tjerët, Rirregullimi i procedurës paraprake në Republikën e Maqedonisë, RMDPK, Nr. 2/3, 2008, fq. 79-120.

publike, ndërsa një pjesë e vogël e saj do të jetë në kuadër të ekipit të prokurorisë publike nëpër qendra hetimore të prokurorisë publike.⁶

Policia kriminalistike, tani si polici gjyqësore, bëhet bashkëpunëtor kryesor i prokurorisë publike. Ato të bashkëpunojnë që në fazën më të hershme të procedurës është me rëndësi të veçantë, ashtu që më vonë të mos vijjnë në ndonjë konflikt, nëse në fund të hetimit prokurori publik vlerëson se ndoshta dëshmitë nuk janë të mjaftueshme ose nuk janë prezantuar në mënyrë ligjore, me ç'rast do të detyrohej ta refuzojë rastin, pasi që edhe vet nuk do të mund ta fitojë atë në gjyq. Kjo tani bëhet shumë më reale pasi që me braktisjen e rolit aktiv të gjyqit në zbardhjen e rastit, barra e dëshimit në tërësi kalon te prokuroria. Prandaj, bashkëpunimi i prokurorit publik dhe i policisë është në një dritë krejtësisht të re, në një sistem i cili tani për nga natyra është i huaj.

3.2. Qendrat hetimore të prokurorisë publike

Për ta realizuar funksionin e zbulimit dhe të ndjekjes në kushtet e reja, koncepti i ri parasheh që për zonën e një ose më shumë prokurorive publike të formohen të ashtuquajtura *qendra hetimore të prokurorisë publike*.

Punët në qendrën hetimore i kryejnë inspektorë, pjesëtarë të policisë gjyqësore, të cilët *zgjidhen* për kryerje të punëve *në afat të caktuar*, nëpërmjet publikimit të *shpalljes së brendshme*. Kjo duhet të garantojë një stabilitet të caktuar dhe specializim të pjesëtarëve të policisë gjyqësore, të cilët në këtë mënyrë bëhen pjesë e ekipit të prokurorisë publike. Ky stabilitet, bashkë me pamundësinë që pjesëtarët e policisë gjyqësore të qendrave hetimore të shpërndahen në detyra të tjera në MPB dhe instrumentet e tjera (ndikimi në karrierë dhe përgjegjësia disiplinore e inspektorëve të policisë gjyqësore etj.) duhet të sigurojnë një shkallë të pavarësisë në raport me përgjegjësit e tyre në MPB dhe një lojalitet pak më të madh ndaj prokurorisë.

Inspektorët e krim-policisë të cilët kanë kaluar në qendrën hetimore janë në dispozicion të prokurorit publik kompetent, *punojnë nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e tij*, i kryejnë urdhrat e prokurorit publik, *punojnë sipas orientimeve dhe udhëzimeve të tij dhe për punën e tyre i përgjigjen atij* (neni 51 LRPP). Thënë të vërtetën, këto raporte të vënies në dispozicion dhe të ngjashme me to, të policisë gjyqësore në raport me prokurorinë publike, vlejnë për tërë policinë gjyqësore. Megjithatë, përderisa udhëheqja e prokurorisë me policinë realizohet vështirë sa i përket zyrtarëve policorë të cilët mbeten në MPB dhe MF dhe, të cilët në fazën e hershme të zbulimit kanë iniciativë më të madhe dhe kompetenca fillestare të

⁶ Pjesa më e madhe e policisë gjyqësore do të përbëhet nga inspektorët e MPB-së, PF-së dhe të DD-së, të cilët edhe më tej do të ngelin në ministrinë e tyre dhe do të punojnë njësoj si edhe deri tani, vetëm se tani me një lidhje më të qartë dhe më të fortë me prokurorin kompetent. Ndërsa pjesa tjetër e policisë gjyqësore do të përbëhet nga inspektorë të cilët do të kalojnë në ekipin e prokurorisë publike.

përcaktuara edhe me ligje të tjera,⁷ tani kjo bëhet shumë më reale për inspektorët të cilët do të bëhen pjesë përbërëse e ekipit të prokurorisë publike. LPP-ja siguron se derisa të punojnë në qendrën hetimore ata *nuk mund të angazhohen në vend tjetër pune* në organet shtetërore nga të cilat vijnë, apo të largohen e të mos punojnë në ndonjë rast konkret, pa miratim eksplicit nga prokurori publik.

Pjesa e Policisë gjyqësore në qendrat hetimore kryesisht do të veprojë në pjesën që ka të bëjë me akuzën, gjegjësisht në fazën e mbledhjes paraprake të njoftimeve, më shumë se sa në procedurën hetimore, ku veprimet i ndërmerr drejtpërdrejt prokuroria, edhe pse policia gjyqësore mund t'i ndihmojë. Kjo nuk do të thotë se policia gjyqësore në qendrat hetimore nuk mund të punojë edhe në fazën e zbulimit dhe të lajmërimit në procedurën parahetimore, në raste kur prokuroria vetë do të kuptojë për dyshimet se vallë është kryer vepër penale (këqyrje e drejtpërdrejtë, fjalë e dëgjuar, famëkeqësi e të ngjashme).

4. ECURIA E PROCEDURËS PARAPRAKE

Qëllimi i procedurës paraprake është të mblidhen dëshmi për gjasat që të ketë ndodhur vepra e dënueshme dhe për autorin e saj, që të mund të vendoset se a do të gjykohet ai, apo procedura kundër tij do të ndërpritet. Deri te një vendim i tillë, organet e ndjekjes penale vijnë gradualisht, duke realizuar procedurën paraprake nëpër disa faza. Fazën e parë e paraqesin mbikëqyrjet policore, të cilat i iniciojnë autoritetet policore me iniciativë vetjake (nëse ekziston dyshim i arsyeshëm se vallë është kryer vepër e dënueshme e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare) ose me kërkesë të prokurorit publik.

Formalisht, procedura paraprake edhe më tej është e ndarë në dy faza – faza e zbulimit dhe e paraqitjes (parahetimore) dhe procedura hetimore, fillimi i së cilës shënohet me sjelljen e urdhrit nga prokurori publik për kryerje të hetimit.⁸ Edhe përkundër kësaj ndarjeje formale të procedurës paraprake, me dispozitat të cilat lidhen me obligimet dhe me autorizimet konkrete ligjore të subjekteve të saja, faktikisht është dhënë mundësi ligjore që procedura paraprake të zhvillohet në mënyrë kontinuale, si një fazë e pandarë e procedurës penale. Kjo, para së gjithash, del nga fakti që prokurorit publik, si bartës i procedurës paraprake, i është dhënë mundësia që t'i ndërmarrë të gjitha mjetet dëshmuese dhe masat për gjetje dhe

⁷ Shih G. KALLAJXHIEV, dhe T. STOJANOVSKI, Shqyrtim kritik i Ligjit për policinë, Buletini nr. 1, FISHHM, Shkup, 2006, fq. 13-28; G. KALLAJXHIEV, Çfarë autorizimesh policore për Drejtorinë doganore, RMDPK, Nr. 1, 2006, fq. 51-84.

⁸ Argument për këtë rregullativë ligjore është nevoja për të përcaktuar një veprim konkret procedural që do ta shënonte fillimin e procedurës penale, e më këtë do të paraqiste edhe veprim të ndërmarrë procedural me të cilin ndërpritet vjetërsimi i ndjekjes penale, për vepër penale për të cilën zhvillohet procedura penale. Shih M. TROMBEVA, Procedura paraprake sipas risive në Propozim tekstin e LPP të RM, në: *lustitia*, Nr. 2, 2010, fq. 20.

18

sigurim të personave dhe sendeve, gjatë tërë procedurës paraprake, që do të thotë, si në fazën e zbulimit dhe të paraqitjes, po ashtu edhe gjatë procedurës hetimore.⁹

Shikuar nga aspekti ligjor, koordinator i aktivitetit të policisë dhe i organeve të tjera shtetërore është prokurori publik, prandaj edhe këto organe duhet të veprojnë sipas urdhrave apo propozimeve të tij dhe t'i japin raporte për aktivitetet e ndërmarra, edhe pse në praktikë, zakonisht, nga vetë natyra e gjërave, shumicën e veprimeve i ndërmarrin organet me autorizime policore, për shkak se ato janë organe operative dhe të parit marrin njohuri për veprën e kryer penale.

4.1. Procedura parahetimore

Procedura parahetimore në praktikë fillon më shpesh me mbikëqyrje policore, të cilat policia i fillon nën kushte të caktuara ligjore, sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë të prokurorit publik, me ç'rast parashihet obligim për autoritetet policore që ta informojnë menjëherë prokurorin publik për masat që janë ndërmarrë.

Procedura parahetimore e përfshin veprimtarinë e trupave të ndjekjes penale - prokurorisë publike, policisë, ndërsa në raste të parapara me ligje edhe të doganës, të policisë financiare, ndërsa për vepra të caktuara penale kundër shtetit dhe forma më të rënda të kriminalitetit të organizuar edhe të Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim (DSK), në zbulimin e veprave të dënueshme dhe të autorëve, si dhe në mbledhjen e dëshmive për ngritje të procedurës ndëshkuese dhe mbledhjen dhe sigurimin e dëshmive për realizimin e saj. Po qese rezultatet e procedurës parahetimore tregojnë se ngritja e procedurës ndëshkuese është e arsyeshme, prokuroria mund të fillojë me një procedurë pak më të fuqishme hetimore sipas normave juridike.¹⁰

⁹ Gjatë kësaj, dëshmitë të cilat janë siguruar gjatë fazës së zbulimit dhe të paraqitjes kanë vlerë të njëjtë dëshmuese si edhe dëshmitë të cilat janë siguruar gjatë procedurës hetimore. Kështu, dëshmitë me shkrim dhe dëshmitë e tjera materiale, po qe se janë siguruar në mënyrë ligjore, shfrytëzohen si dëshmi gjatë ecurisë së mëtutjeshme të procedurës – gjatë shqyrtimit kryesor, ndërsa deklaratat e të akuzuarit dhe deklaratat e dëshmitarëve gjatë seancës kryesore mund të shfrytëzohen vetëm për tu treguar, me qëllim të kontrollimit të vërtetësisë së deklaratave të tyre, të cilat i kanë dhënë gjatë shqyrtimit kryesor. Njësoj, fq. 20.

¹⁰ Procedura e re hetimore, megjithatë, është shumë më pak e normuar se sa më parë. Gjatë përgatitjes së ligjit ekzistonin disa dilema për atë se a të normohen në detaje veprimet hetimore, e posaçërisht a duhet të normohet apo jo, marrja në pyetje e dëshmitarëve gjatë hetimit, duke pasur parasysh faktin se deklaratat e tyre nuk prezantohen gjatë hetimit. Disa dispozita për mënyrën e marrjes në pyetje megjithatë mbetën, më shumë në aspekt mbrojtës. Ky opsion mund të shkaktojë ndonjë ngatërresë për shkak të praktikës së gjatë të marrjes në pyetje të dëshmitarëve në hetim.

Mbikëqyrjet policore

Mbikëqyrjet policore janë veprime dhe masa për zbulim dhe mbledhje të të dhënave për veprën penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, për autorin e saj, si dhe për rrethana të tjera të dobishme të udhëheqjes së suksesshme të procedurës penale. Veprimet e mbikëqyrjes janë edhe masat e përcaktuara me rregullat e kriminalistikës, të paraqitura në të drejtën policore dhe autorizimet e veçanta të organeve të tjera shtetërore siç janë Policia financiare dhe Drejtoria e doganave.

Inicimi i mbikëqyrjeve policore. Procedura parahetimore, gjegjësisht mbikëqyrjet bëhen me qëllim që prokurorit publik t'i sigurohet material për të vlerësuar se bazat e dyshimit si njohuri fillestare, a kalojnë në dyshim të arsyeshëm si shkallë më e lartë e dyshimit, bazuar në dëshmitë e mbledhura të cilat çojnë në përfundim se një person i caktuar ka bërë vepër penale, për të mundur të bëjë kërkesë në gjyq lidhur me zhvillimin e hetimit.

Prokurori publik dhe policia gjyqësore për një vepër penale të kryer kuptojnë nëpërmjet pamjes së drejtpërdrejtë, fjalëve të dëgjuar, apo me pranimin e padisë penale. Sikur edhe te Ligji aktual i procedurës penale, me Ligjin e ri të PP-së, për të gjitha organet shtetërore, ndërmarrjet dhe institucionet publike, edhe më tej parashihet obligimi për t'i paraqitur veprat penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare, për të cilat kanë qenë të informuara apo për to kanë kuptuar në ndonjë mënyrë tjetër. Ligji i ri i PP, jep mundësi që padia penale të mund të parashtrohet në shumë mënyra, gjegjësisht me zbatim të çfarëdo lloj mjetes - si me shkrim, po ashtu edhe me gojë, nëpërmjet telefonit apo në mënyrë elektronike.

Gjatë procedurës parahetimore, për të arritur qëllimin e saj, organet kompetente ndërmarrin një sërë veprimesh. Pas pranimit të padisë penale apo njohurive të marra për vepër të kryer penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, policia është e obliguar t'i ndërmarrë masat e nevojshme për gjetjen e autorit të veprës penale, që autori apo bashkautori të mos fshihet apo të ikë, të zbulohen dhe të sigurohen gjurmët e veprës penale dhe sendet që mund të shërbejnë si dëshmi, si dhe t'i mbledhin të gjitha njoftimet që do të mund të ishin të dobishme për udhëheqjen e suksesshme të procedurës penale.

Për këtë qëllim, gjatë procedurës parahetimore, policia mund:

- të kërkojë njoftime të nevojshme nga qytetarë;
- të ndalojë, të legjitimojë, dhe të bëjë kontrollim apo bastisje të personave, të mjeteve transportuese dhe të bagazhit, nëse ekziston bazë për dyshim se tek ata do të mund të gjenden gjurmë të veprës penale ose sende që mund të shërbejnë si dëshmi;

20

- ta drejtojë, ta orientojë ose ta kufizojë lëvizjen e personave dhe të mjeteve transportuese në një hapësirë të caktuar për një kohë të nevojshme që është e domosdoshme (deri në 6 orë);
- të ndërmarrë masa të nevojshme për të vërtetuar identitetin e personave apo sendeve;
- të marrë gjurmë të gishtave, mostër për analizë ADN dhe të fotografojë (neni 277);
- të bëjë kërkim, të shpallë fletarrest për personin dhe njoftim për pronën dhe dobinë pronësore apo për sendet të cilat kërkohen;
- të bëjë kontrollim të objekteve apo hapësirave të caktuara të organeve shtetërore, institucioneve që japin autorizime publike dhe të personave të tjerë juridikë dhe të bëjë kontrollim të dokumentacionit të caktuar të tyre;
- të bëjë identifikim (neni 278);
- të ndërmarrë masa dhe veprime të tjera të nevojshme të parapara me ligj.

Për fillim të procedurës parahetimore nuk sillet asnjë aktvendim formal.

Prokurori publik ka të drejtë dhe obligim për *kontroll* të vazhdueshëm ndaj policisë gjatë realizimit të këtyre veprimeve. Prokurori publik këto veprime mund t'i realizojë edhe vet (neni 276).

Identifikimi. Ligji i ri për procedurë penale e rregullon procedurën e identifikimit në polici për herë të parë, të cilën praktika e deritanishme e fuste nën “vërtetim të identitetit”, që është e qartë se nuk është adekuate. Në fakt, një gjë është vërtetimi i identitetit të një personi konkret, kurse diçka krejtësisht tjetër se a do ta identifikojnë dëshmitarët apo viktimat të dyshuarin si autor të veprës. Kështu, nëse bëhet fjalë për të dyshuar, identiteti i të cilit është i njohur dhe ai është i kapshëm për policinë gjyqësore, do të mund të zbatohen këto metoda të identifikimit nga ana e viktimës ose dëshmitarëve të tjerë: a) paradimi; b) identifikimi grupor; c) video filmi, dhe ç) ballafaqimi. Realizimi i këtyre llojeve të identifikimit bëhet në prezencë të prokurorit publik dhe të mbrojtësit (neni 278).

Bisedat informative. Policia gjyqësore mund të thërret qytetarë për të mbledhur njoftime për veprën penale dhe për autorin ose për rrethana të tjera të rëndësishme që lidhen me veprën penale. Thirrja bëhet nëpërmjet ftesës me shkrim dhe udhëzim për të drejtat. Pasiqë qytetarët nuk kanë obligim ligjor që të bashkëpunojnë me policinë, ata mund të ndihmojnë gjatë hetimeve duke dhënë informata në baza vullnetare. Policia tanimë nuk mund të arrestojë me forcë persona për biseda informative në stacionin policor. Nëse personi i cili do t'i përgjigjet ftesës refuzon të bëjë njoftim, ai nuk mund të ftohet përsëri për arsyen e njëjtë. „Mbledhja e njoftimeve“ nga personi i njëjtë mund të zgjasë aq kohë sa është e nevojshme që të merret njoftimi i nevojshëm, por jo më gjatë se 4 orë.

Njoftimet nga qytetarët nuk duhet të mblidhen me forcë e as me mashtrim apo maltretim, kurse policia është e obliguar që ta respektojë personalitetin dhe dinjitetin e qytetarit. Qytetari mund të thirret përsëri për të mbledhur njoftime për ndonjë vepër tjetër penale apo për autor tjetër, ndërsa për mbledhje të njoftimeve për veprën e njëjtë penale mund të thirret për arsye të rëndësishme vetëm edhe njëherë.

Policia gjyqësore nuk mund ta pyesë qytetarin e thërritur në cilësinë e të akuzuarit, dëshmitarit apo ekspertit. Në raste kur policia gjyqësore do të vlerësojë se qytetari i thirrur mund të paraqitet në cilësinë e të dyshuarit menjëherë e informon prokurorin publik.

Ngritja e padisë penale pas mbikëqyrjeve policore (neni 280). Në bazë të njohurive të mbledhura, policia gjyqësore përgatit padi penale për veprimet e kryera, ku i shënon edhe dëshmitë që i ka gjetur. Me padinë dorëzohen edhe sende, skica, fotografi, akte për veprime të ndërmarra, shënime zyrtare, deklarata dhe materiali tjetër që mund të jetë i dobishëm për udhëheqje të suksesshme të procedurës. Nëse policia gjyqësore më vonë kupton për rrethana, dëshmi apo gjurmë të reja në lidhje me veprën penale, ajo është e obliguar të mbledhë njoftime të nevojshme dhe për këtë menjëherë ta informojë prokurorin publik.

Veprimi i prokurorit publik pas padisë penale

Informimi i prokurorit publik. Pas pranimit të padisë penale ose marrjes së njoftimit për ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm se është kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, policia, pa vonesë, e njofton me shkrim prokurorin publik. Nëse ekziston dyshim i arsyeshëm për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg, së paku, prej katër vitesh ose ekzistojnë arsye për urgjencë, policia do ta informojë me gojë menjëherë prokurorin publik, e më pas do të përgatisë edhe njoftim zyrtar me shkrim.

Udhëheqja e procedurës parahetimore. Pas pranimit të padisë penale apo pas marrjes së njoftimit nga policia, me procedurën udhëheq prokurori publik. Policia gjyqësore është e obliguar të veprojë sipas urdhrave dhe orientimeve të prokurorit publik. Siç u diskutua edhe më lartë, ajo vazhdon me mbikëqyrjet edhe atëherë kur nuk ka urdhra të veçanta apo orientime nga prokurori publik dhe për masat dhe veprimet e ndërmarra e informon prokurorin publik.

Mbledhja paraprake e njoftimeve nga prokuroria publike. Prokurori publik, vet apo nëpërmjet policisë gjyqësore, gjegjësisht personave të tjerë të punësuar në qendrat hetimore të prokurorisë publike, do t'i mbledhë njoftimet që nevojiten për të vendosur për padinë penale, dhe sipas nevojës, këtë do ta bëjë edhe nëpërmjet policisë

apo organeve të tjera kompetente për zbulim.¹¹ Për masat e ndërmarra në bazë të urdhrorit apo orientimeve të prokurorit publik, policia dhe organet e tjera janë të obliguara të japin njoftim në afat, më së voni, prej 30 ditësh.¹² Në urdhër, prokurori publik mund më për së afërmi t'i përcaktojë veprimet e nevojshme, ndërsa mund të kërkojë edhe të jetë i pranishëm gjatë realizmit të tyre.

Për t'i mbledhur njoftimet e nevojshme prokurori publik mund të thërret parashtruesin e padisë penale, si dhe persona të tjerë njohuritë e të cilëve konsideron se mund të kontribuojnë për vlerësimin e vërtetësisë së pretendimeve të padisë apo për të cilët konsideron se mund të jenë dëshmitarë gjatë procedurës, me ç'rast i informon për arsyet e marrjes së tyre në pyetje. Prokurori publik mund ta merr në pyetje edhe të dyshuarin, me ç'rast zbatohen dispozitat për marrje në pyetje të të dyshuarit gjatë hetimit (nenet 205 deri në 211 të ligjit të ri). Me forcë mund të silltet vetëm personi i cili nuk i është përgjigjur ftesës së dorëzuar në rregull ose personi i cili në mënyrë të qartë i shmanget pranimit të ftesës, vetëm me vendim të gjyqit edhe atë për vepra më të rënda penale për të cilat është i paraparë dënimi me burg, së paku, prej 5 vitesh.

Vendimet në lidhje me padinë penale. Prokurori publik është i obliguar të vendosë për padinë penale në afat prej tre muajsh nga dita e pranimit të saj. Në të kundërtën, ai është i obliguar ta njoftojë menjëherë me shkrim prokurorin më të lartë publik dhe parashtruesin e padisë penale.

Prokurori publik me aktvendim e hedh poshtë padinë penale nëse konstatohet se vepra e paraqitur nuk është vepër penale që të ndiqet sipas detyrimit zyrtar, nëse ka vjetërsim të rastit, nëse vepra është përfshirë në amnisti apo në falje, nëse ekzistojnë rrethana të tjera që e përjashtojnë ndjekjen, si dhe në rastet kur nuk ekziston dyshim i arsyeshëm se personi i paraqitur në padi e ka kryer veprën penale.

Aktvendimi për refuzimin e padisë penale i dorëzohet të dëmtuarit, i cili në afat prej tetë ditësh nga pranimi i njoftimit, mund të paraqesë ankesë te prokurori publik i një niveli më të lartë, i cili është i obliguar në lidhje me ankesën të vendosë në afat prej tridhjetë ditësh pas pranimit të saj.¹³ Prokurori publik më i lartë mund

¹¹ Nga ajo që u tha më lartë është e qartë se prokurori publik nuk ka nevojë fare ta presë policinë dhe organet e tjera me autorizime të veçanta t'i "ofrojnë" rast, por pas marrjes së njoftimeve mund menjëherë të veprojë vet, për të cilën gjë tani në dispozicion e ka edhe ekipin e tij të krim-inspektorëve.

¹² Vetëm në raste jashtëzakonisht të komplikuar për vepra të rënda penale të kryera nga më shumë persona apo ndonjë grup i organizuar kriminal, policia gjyqësore mund të kërkojë nga prokurori publik miratim për vazhdim të këtij afati. Në afatin e dhënë, policia gjyqësore është e obliguar ta informojë prokurorin publik për veprimet e ndërmarra deri atëherë dhe për rezultatet e tyre.

¹³ Padia subsidiare është hequr jo për shkak të përvojave të këqija nga e kaluara si rezultat i zbatimit të saj, por për shkak se në konceptin e ri të hetimit ky lloj i padisë hasi në probleme të caktuara, thënë në mënyrë të kushtëzuar "teknike", për arsye se si mekanizëm kontrollues kundër heqjes dorë në mënyrë arbitrare ishte miratuar mundësia e të dëmtuarit për ankesë deri te prokurori më i lartë publik.

ta vërtetojë vendimin për refuzim të padisë penale ose ta pranojë ankesën dhe ta detyrojë prokurorin më të ulët publik ta vazhdojë procedurën.

Për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me burg deri në 3 vjet apo dënimi me të holla, kurse i dyshuari, për shkak të pendimit të vërtetë, ka penguar të mos ndodhin pasojat e dëmshme apo e ka kompensuar tërë dëmin, prokurori publik mund të mos ndërmarrë ndjekje penale. Një vendim të këtillë ai mund të sjellë edhe në rast se në Kodin penal (KP) është paraparë mundësia që gjyqi ta lirojë autorin e veprës penale nga dënimi, kurse prokurori publik do të vlerësojë se vetë aktgjykimi pa sanksion penal nuk është i nevojshëm, si edhe në rast i dyshuari, si anëtar i ndonjë grupi, bande apo shoqërie të organizuar kriminale, bashkëpunon vullnetarisht, ndërsa bashkëpunimi i tillë dhe deklarata e këtij personi është e një rëndësie thelbësore për procedurën penale.¹⁴

4.2. Procedura hetimore

Termi dhe qëllimi

Procedura hetimore inicohet kundër ndonjë personi kur ekziston *dyshim i arsyeshëm* se ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare apo me propozim.¹⁵ Procedurën hetimore tani e realizon prokurori publik kompetent, me ç'rast në dispozicion e ka edhe policinë gjyqësore.

Qëllim i procedurës hetimore është të *mbliidhen* dëshmi dhe të dhëna të cilat i nevojiten prokurorit publik për të mundur të vendosë se a do të ngrejë aktpadi ose do të heq dorë nga ndjekja penale, si dhe të *prezantohen* dëshmitë për të cilat ekziston rreziku se nuk do të mund të prezantohen në shqyrtimin kryesor ose se prezantimi i tyre do të kalonte me vështirësi. Edhe pse është palë në procedurë, prokurori publik është i obliguar që gjatë procedurës hetimore të mbledhë dëshmi të cilat e ngarkojnë të dyshuarin, por edhe të tilla që shkojnë në favor të tij. Gjatë procedurës hetimore, i dyshuari, mbrojtësi i tij, dhe i dëmtuari prokurorit publik mund t'i japin propozime për ndërmarrje të veprimeve të caktuara dhe për realizim të të drejtave të tyre.

¹⁴ Prokurori publik, me pëlqim të palës së dëmtuar, mund të sjellë edhe vendim që ta shtyjë ndjekjen penale për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me burg deri në tre vjet, nëse i dyshuari është i gatshëm që të silltet sipas udhëzimeve të prokurorit publik, dhe të përmbushë obligime të caktuara me të cilat zvogëlohen apo mënjahohen pasojat e dëmshme të veprës penale. Obligimet të cilat mund t'i jepen të dyshuarit janë paraparë në mënyrë taksative në LPP.

¹⁵ Ligji për herë të parë i definon termet „baza të dyshimit“ dhe „dyshim i arsyeshëm“. Baza të dyshimit janë njohuritë të cilat në bazë të njohurive kriminalistike dhe të përvojës mund të vlerësohen si dëshmi për vepër të kryer penale. Dyshimi i arsyeshëm është një shkallë më e lartë e dyshimit, i bazuar në dëshmitë e siguruar të cilat çojnë në përfundim se një person i caktuar ka kryer vepër penale (neni 21).

Ndarja e procedurës parahetimore dhe asaj hetimore. Shumë ekspertë të huaj dhe organizata ndërkombëtare të kyçura në projektin e reformës insistonin në shlyerjen e kufirit në mes të procedurës parahetimore dhe asaj hetimore, me se e tërë procedura paraprake do të thjeshtësohej. Më vonë, pas disa kontrollimeve dhe hetimeve policore do të mblidhen informata dhe dëshmi të mjaftueshme se një person i caktuar dyshohet me arsye se ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, që nënkupton mundësi që ndaj tij të zbatohen masa që i prekin interesat, të drejtat dhe liritë e tij (paraburgim, bastisje, masa të veçanta hetimore, konfiskim të sendeve e të ngjashme).

Shënimi i një lloj kufiri në mes të mbikëqyrjes policore dhe procedurës hetimore ka për qëllim ta shënojë momentin gjatë procedurës kur prokurori publik duhet të kyçet në mënyrë më aktive në hetim, e ky është momenti kur hetimi do të fokusohet te ndonjë person konkret, si dhe të shënohet momenti kur i dyshuari është i përfshirë në mënyrë serioze në hetime që t'i ketë të gjitha garancitë për gjykim të drejtë. Tanimë thamë se edhe shënimi i momentit që ka të bëjë me rrjedhjen e afateve për vjetërsimin e ndjekjes penale është shumë i rëndësishëm. Është me rëndësi të kuptohet se kjo pikë, gjegjësisht ndarje, nuk do të thotë se hetimi tani duhet të fillojë përsëri nga fillimi, se të gjithë personat do të merren në pyetje përsëri e të ngjashme.

Deformalizimi dhe përshpejtimi i hetimit. Njëri nga kurthet kryesore në të cilën u kapën disa shtete të Jugosllavisë së mëparshme gjatë reformës së LPP-së është edhe ajo që hetimin e transferuan në mënyrë të thjeshtë te prokurori publik, ndërsa hetimi edhe më tej mbeti detajisht i rregulluar dhe formal, kurse veprimet *hetimore* vetëm riemëroheshin në veprime *dëshmuese*.¹⁶ Kjo terminologji dhe ky incizim i të gjitha veprimeve gjatë hetimit çonte në drejtim krejtësisht të kundërt në krahasim me atë të modeleve (të hetimeve policore-të prokurorit) të cilat kinse po merreshin si model. Kështu, dëshmitë edhe më tej po prezantohen praktikisht gjatë hetimit, rregullat për dëshmitë po përpunohen në kuadër të hetimit dhe të ngjashme, që është një ngatërrësë e madhe e koncepteve dhe e ideve. Ligji i ri për procedurë penale përpiqet që t'u shmanget këtyre kurtheve dhe keqkuptimeve të cilat fillimisht burojnë nga kuptime dhe shprehje të rrënjosura thellë, por edhe nga ndërlikueshmëria e një prerjeje të rreptë me ligjin e vjetër. Në atë kuptim, dëshmitë vetëm mblidhen gjatë hetimit, ndërsa vetëm në raste të veçanta bëhet prezantimi i tyre në seancë të veçantë dëshmuese, nëse me arsye pritet që këto dëshmi të mos mund të prezantohen gjatë shqyrtimit kryesor. Prandaj, këto dëshmi nuk mund të nxirren gjatë shqyrtimit kryesor me lexim, bile edhe kur dëshmitari ka dhënë deklaratë në gjyq gjatë shqyrtimit. Me të vërtetë, siç është rasti edhe me të gjitha procedurat moderne të cilat u përmbahen principeve të kundërshtimit dhe të drejtpërdrejtshmërisë, deklaratat jokonsistente do të

¹⁶ Shih G. KALLAJXHIEV, Dallime më të rëndësishme konceptuale në reformën e hetimit në Kroaci dhe në Maqedoni, në "Përmbledhje punimesh shkencore të Fakulteteve Juridike në Shkup dhe Zagreb", Zagreb, 2010.

mund të lexohen për shkak të “freskimit të memories” dhe kontestimit të vërtetësisë së deklaratës së dhënë para gjyqit.

Nga ana tjetër, rregullat e përgjithshme për dëshmimin dhe për sendet dëshmuese në Ligjin e ri për procedurë penale ndahen në një kapitull të veçantë, në vend të nomoteknikës ekzistuese, e cila dëshmitë i përpunon në hetim, me specifika për shqyrtimin kryesor, që flet për qasjen inkuizicionale të Ligjit aktual të procedurës penale, si një kontroversë e ruajtur te ligjet e ish-republikave të tjera jugosllave.

Inicimi i procedurës hetimore

Hetimi fillon me sjelljen e urdhrit ku shënohen të dhëna personale, kualifikimi ligjor dhe përmenden veprimet hetimore që duhet të ndërmerren. Para se ta sjellë urdhrin për inicim të procedurës penale, prokurori publik mund ta marrë në pyetje personin ndaj të cilit kërkohet që të fillohet procedurë hetimore.

Veprimet hetimore që mund të ndërmerren gjatë hetimit janë: bastisja, sigurimi i përkohshëm apo konfiskimi i sendeve dhe i pronës, mbledhja e deklaratave nga i akuzuari, mbledhja e deklaratave nga dëshmitarët, ekspertiza, inspektimi dhe rekonstruktimi, si dhe masat e veçanta hetimore. Prokurori publik është i obliguar t'i lajmërojë në mënyrë të përshtatshme mbrojtësin, të dëmtuarin dhe të dyshuarin për kohën dhe vendin e realizimit të veprimeve hetimore, përveç nëse nuk ekziston rrezik për shtyrje.¹⁷

Kohëzgjatja e procedurës paraprake është e kufizuar. Prokurori publik është i obliguar që për për padinë e parashtruar të vendosë në afat prej 3 muajsh dhe ta përfundojë procedurën hetimore në afat prej 6 muajsh nga sjellja e urdhërit për realizim të procedurës hetimore. Ky afat, në raste të ndërlikuara, mund të shtyhet nga Prokurori i lartë publik edhe për 6 muaj, ndërsa nga Prokurori publik i shtetit edhe për 3 muaj të tjera. Pas kalimit të afatit, prokurori publik është i obliguar të sjellë vendim përkatës, gjegjësisht të ngrëjë akuzë apo të sjellë urdher për ndërprerje të procedurës hetimore.

Përfundimi i procedurës hetimore

Prokurori publik e përfundon procedurën hetimore pasi të vlerësojë se çështjet janë qartësuar në nivel të mjaftueshëm për të ngritur akuzë apo për ta ndërprerë procedurën penale.

Ekziston obligimi për lajmërim të të dyshuarit dhe të mbrojtësit për përfundimin e hetimit. Nëse këtë nuk e ka bërë para kësaj, ai para përfundimit të hetimit, duhet

¹⁷ Shih T. VITLLAROV, Roli i prokurorit publik në propozimin e ri të LPP, në: Iustitia, Nr. 2, 2010, fq. 16.

26

ta marrë në pyetje të dyshuarin. Ky lajmërim përmban përshkrim të veprës, kualifikimin ligjor, duke potencuar se kanë të drejtë t'i shohin aktet në prokurori dhe të bëjnë kopje të tyre. Gjithashtu, të dyshuarit i jepet udhëzimi se mund të dorëzojë edhe certifikata me shkrim apo dëshmi të tjera nga veprimet e ndërmarra nga mbrojtja ose të kërkojë nga prokurori publik të mbledhë dëshmi të caktuara. Prokurori publik është i obliguar ta njoftojë të dyshuarin me dëshmitë e mbledhura gjatë hetimit si dhe t'ia zbulojë dëshmitë të cilat mund të jenë në favor të tij.

Pas përfundimit të hetimit ekziston një afat prej 15 ditësh për ngritje të akuzës, i cili për vepra nga sfera e kriminalitetit të organizuar mund të vazhdohet deri në 30 ditë.

Ndërprerja dhe ndalimi i procedurës hetimore

Hetimi mund të ndërpritet ose të ndalohet. Kryesisht këtu nuk ka ndryshime thelbësore nga LPP ekzistues.

5. VEPRIMET HETIMORE

Gjatë procedurës hetimore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, prokurori publik mund t'i ndërmarrë këto veprime hetimore:

- bastisje;
- sigurim të përkohshëm apo konfiskim të sendeve apo të pronës;
- marrje në pyetje të të akuzuarit;
- marrje në pyetje të dëshmitarëve;
- përcaktim të ekspertizës;
- inspektim dhe rekonstruktim, si dhe
- masa të veçanta hetimore.

Veprime hetimore mund të ndërmerren edhe para inicimit të procedurës hetimore nëse ekziston rrezik për shtyrje, nën kushte dhe procedurë të rregulluar me këtë ligj.

Koncepti i ri i procedurës hetimore paraqiti disa dilema edhe në pjesën e rregullativës ligjore të mjeteve dëshmuese, edhe atë, para së gjithash, në lidhje me marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe në pjesën që ka të bëjë me marrjen në pyetje të të dyshuarit. Kjo nuk është vetëm një çështje nomoteknike, por bëhet fjalë për një koncept krejt të ndryshëm nga ai i tanishmi, ku veprimet dëshmuese rregullohen në kapitull të veçantë, e jo te hetimi. Në fakt, çështjet që kanë të bëjnë me dëshmitë ishin të rregulluara në kuadër të hetimit (Kapitulli XVIII nga Ligji aktual i procedurës penale). Kjo është karakteristikë e procedurës së deritanishme penale e cila formalisht fillon qysh gjatë hetimit, ku gjykatësi hetues ndërmerr

veprime valide dëshmuere si veprime hetimore, me pjesëmarrje të palëve. Dëshmitë e prezantuara gjatë hetimit, më vonë, gjyqi pa vështirësi të mëdha i inkorporon në materialin dëshmuues me lexim gjatë shqyrtimit kryesor dhe i shfrytëzon si bazë për aktgjykimin.¹⁸

Me Ligjin e ri të procedurës penale parashihet që vendimi gjyqësor të bazohet vetëm mbi dëshmi të prezantuara në shqyrtimin kryesor, kështu që deklaratat e dëshmitarëve që janë marrë në pyetje dhe siguruar gjatë procedurës paraprake mund të shërbejnë vetëm për t'i paraqitur gjatë shqyrtimit kryesor, nëse këta persona nuk japin deklaratë apo i ndryshojnë deklaratat e tyre. Përfundimisht nga kjo është e qartë se paraparë vetëm për dëshmitë e siguruar në seancë dëshmuere, ku në cilësinë e dëshmitarit do të merren në pyetje ata persona që nuk do të mund të merren në pyetje gjatë shqyrtimit kryesor. Nga kjo që u tha, është e qartë se vlera dëshmuere e deklaratave të dëshmitarëve që janë marrë në pyetje gjatë procedurës paraprake nuk është e njëjtë me vlerën dëshmuere të deklaratave të dhëna në shqyrtimin kryesor apo në seancë dëshmuere. Ideja prapa kësaj është e qartë, mbrojtja duhet patjetër të ketë mundësi përkatëse që dëshmitë kundër të akuzuarit t'i kontestojë në shqyrtim kundërshtues në gjyq. Tjetër trajtim kanë deklaratat, gjegjësisht pranimit të veprës nga i dyshuari, të cilat mund të shfrytëzohen gjithmonë kur janë dhënë vullnetarisht, me respektim të të drejtave të akuzuarit (e drejta për të pasur mbrojtës, e drejta për heshtje e të ngjashme).¹⁹

5.1. Bastisja

Dispozitat e Ligjit të ri për procedurë penale që lidhen me bastisjen fillojnë me definimin e saj si veprim i kontrollimit të hapësirave dhe i personave në kushte dhe në mënyra të përcaktuara në këtë ligj dhe në dispozita të tjera. Ligji parasheh disa çështje që merren si bazë për bastisje varësisht nga ajo se ç'është objekt i bastisjes, kurse risi është futja e bastisjes së zyrave të avokaturës, që mund të ndërmerret vetëm për ndonjë lëndë, akt apo certifikatë të veçantë. Ligji i ri i procedurës penale parasheh më shumë *lloje të bastisjes*: të shtëpisë dhe të hapësirave të tjera; të mjeteve transportuese, të sendeve apo mjeteve helmuese, atyre që digjen lehtë dhe të ngjashme, të sistemit kompjuterik; të objekteve lëvizëse dhe bastisje të personit me precizim të kushteve në të cilat bëhen ato.

Bastisja bëhet në bazë të *urdhrit gjyqësor me shkrim dhe të arsyetuar* i lëshuar me *kërkesë* të prokurorit publik ose me *kërkesë* të Policisë gjyqësore, e cila ka marrë leje nga prokurori publik. Nëse ekziston rreziku për shtyrje, *kërkesa* për dhënie të urdhrit për bastisje mund të bëhet edhe në *formë gojore* – mund t'i kumtohet gjykatësit gjatë procedurës paraprake edhe nëpërmjet telefonit, radio-lidhjes, ose

¹⁸ Thënë të vërtetën, në praktikën tonë gjyqësore, gjyqet u jepnin peshë edhe më të madhe deklaratave që merreshin gjatë hetimit, duke vlerësuar se deklaratat e dhëna më vonë janë ndryshuar me qëllim që t'i iket përgjegjësisë penale.

¹⁹ Shprehja „i dyshuar“ shfrytëzohet për tërë procedurën paraprake.

nëpërmjet ndonjë mjeti tjetër të komunikimit elektronik (neni 187). Sa i përket *kohës së ekzekutimit të urdhrimit për bastisje*, është paraparë që urdhri mund të ekzekutohet në cilëndo ditë të javës, mirëpo edhe se duhet të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e lëshimit të tij. Pas kalimit të këtij afati, urdhri duhet t'i kthehet gjyqit pa vonesë, që të anulohet. Bastisja bëhet ditën, në periudhë kohore prej orës 5 e deri në orën 21.

5.2. Sigurimi i përkohshëm dhe konfiskimi i sendeve apo i pronës

Ndërmerret në bazë të urdhrimit gjyqësor. Ligji i ri i procedurës penale si propozues të autorizuar për lëshim të kësaj urdhërese e thekson prokurorin publik apo Policinë gjyqësore e cila ka marrë leje nga prokurori publik. Nëse ekziston rreziku për shtyrje, ligji parasheh konfiskim të përkohshëm pa urdhëresë.

5.3. Marrja në pyetje e të dyshuarit

Para fillimit të marrjes në pyetje (për herë të parë) të akuzuarit, si risi, detyrimisht do t'i tregohet edhe ajo se ka të drejtë për kontrollim nga mjeku nëse ka nevojë për trajtim mjekësor apo me qëllim të vërtetimit të tejkalimeve eventuale policore (neni 206). Ky udhëzim është futur me rekomandim të Komitetit të Këshillit të Evropës për preventivë nga tortura, për shkak të rasteve të shpeshtuara të torturës policore. I akuzuari, nënkuptohet, mund të heqë dorë në mënyrë vullnetare nga ndonjë e drejtë, mirëpo marrja e tij në pyetje nuk mund të fillojë nëse deklarata se heq dorë nga ndonjëra prej të drejtave nuk shkruhet me shkrim dhe derisa nuk e nënshkruan atë. I akuzuari nuk mund të heq dorë nga e drejta për mbrojtës nëse mbrojtja është e obligueshme.

Si risi e rëndësishme parashihet që të dyshuarit i cili nuk ka avokat të tij, apo nuk mund të bjerë në kontakt me të, t'i jepet lista avokatëve kujdestarë e përgatitur nga Oda e avokatëve. Nëse i akuzuari në fillim nuk ka dashur mbrojtës, mirëpo më vonë shpreh dëshirë të marrë, marrja në pyetje do të ndërpritet dhe do të vazhdojë përsëri kur i akuzuari të ketë mbrojtës, me të cilin mund të këshillohet. Pa mos folur paraprakisht me ndonjë avokat si mbrojtës, i akuzuari mund të merret në pyetje vetëm nëse mbrojtësi nuk paraqitet në afat prej 2 orësh nga momenti kur është njoftuar. Nëse është vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, vendimi gjyqësor nuk mund të bazohet mbi atë deklaratë (neni 206).

Pas udhëzimit për të drejtat e tij, i akuzuari do të pyetet se ç'dëshiron të thotë në mbrojtje të tij. Gjatë marrjes në pyetje, të akuzuarit duhet t'i mundësohet në një deklaram të pandërprerë të deklarohet për të gjitha rrethanat që e ngarkojnë atë dhe t'i përmendë të gjitha faktet që i shërbejnë për t'u mbrojtur. I akuzuari merret

në pyetje gojarisht. Gjatë marrjes në pyetje, të akuzuarit mund t'i lejohet t'i shfrytëzojë vërejtjet e tij. Marrja në pyetje duhet të realizohet në atë mënyrë që do të respektohet personaliteti i të akuzuarit. Ndaj të akuzuarit nuk guxon të përdoret forca, kërcënimi apo mjete të tjera të ngjashme për të marrë deklaratë nga ai apo pranim të kimit. I akuzuari mund të merret në pyetje në mungesë të mbrojtësit vetëm nëse në mënyrë të prerë ka hequr dorë nga kjo e drejtë, e mbrojtja nuk është obligueshme apo nëse në afat prej 24 orësh nga momenti kur i është treguar kjo e drejtë vet nuk siguron mbrojtës, përveç në raste kur mbrojtja është e detyrueshme. Nëse është vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, deklaratat e të akuzuarit nuk mund të shfrytëzohet gjatë procedurës.

Si risi e rëndësishme tani parashihet që marrja në pyetje e të akuzuarit të incizohet me aparat për incizim audio-vizual (neni 207). Për këtë incizim i akuzuari do të njoftohet në mënyrë të veçantë, me ç'rast do t'i tërhiqet vërejtja se deklaratat e incizuara mund të shfrytëzohen dhe të paraqiten gjatë gjykimit.

5.4. Marrja në pyetje e dëshmitarëve

Me konceptin e ri parashihet se vendimi gjyqësor do të bazohet vetëm mbi dëshmi të prezantuara gjatë shqyrtimit kryesor, kështu që deklaratat e dëshmitarëve dhe të të akuzuarit që janë marrë në pyetje gjatë procedurës paraprake mund të shërbejnë vetëm për t'u paraqitur gjatë shqyrtimit kryesor, nëse këta persona nuk japin deklaratë ose i ndryshojnë deklaratat e tyre. Përrjashtim nga kjo është paraparë vetëm për dëshmitë të cilat janë siguruar në seancë dëshmuese, ku në cilësi të dëshmitarit do të dëgjohen ata persona të cilët nuk do të mund të dëgjohen gjatë shqyrtimit kryesor. Nga kjo që u tha, është e qartë se vlera dëshmuese e deklaratave të marra nga dëshmitarët e dëgjuar gjatë procedurës paraprake nuk është e njëjtë me vlerën dëshmuese të deklaratave të dëshmitarëve të dhëna gjatë shqyrtimit kryesor apo në seancë dëshmuese.

Mbrojtja e dëshmitarëve gjatë hetimit. Nëse ka gjasa që me dhënien e deklaratës apo me përgjigje në ndonjë pyetje, dëshmitari, bashkëpunëtori i drejtësisë ose viktima, gjegjësisht i dëmtuari, ta fusë veten e tij apo ndonjë të afërm të tij në rrezik serioz për jetën, shëndetin apo integritetin fizik, dëshmitari i kërcënuar mund të refuzojë të japë deklaratë apo t'i japë të dhënat personale derisa nuk sigurohen kushte për mbrojtjen e tij. Prokurori publik me aktvendim do ta përcaktojë pseudonimin e dëshmitarit të kërcënuar, si dhe mënyrën e veçantë të pjesëmarrjes në procedurë dhe të marrjes në pyetje. Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit të kërcënuar gjatë procedurës paraprake nuk marrin pjesë i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, as i dëmtuari dhe përfaqësuesi i tij ligjor.

5.5. Ekspertiza

Ekspertiza *përcaktohet* atëherë kur, për të vërtetuar apo vlerësuar ndonjë fakt të rëndësishëm, duhet të sigurohet qëndrim dhe mendim nga personi që ka dijen e nevojshme profesionale. Te *përcaktimi i ekspertit* ekzistonte dilema se vallë duhet që ekspertiza gjatë procedurës hetimore të përcaktohet me urdhër me shkrim të gjyqit apo të prokurorisë publike si organ që udhëheq me procedurën hetimore. Dominoi mendimi se duke pasur parasysh faktin që gjykatësi i procedurës paraprake tani nuk është i kyçur në mënyrë aktive në hetim, prokurori publik është organi i vetëm shtetëror i cili gjendet në pozitë të tillë të udhëheq në mënyrë adekuate me ekspertizën. E ashtuquajtura “barazi e armës” e mbrojtjes kompensohet me mundësinë që ajo të shfrytëzojë ekspertë të saj si këshilltarë teknikë.

Prokurori publik, i akuzuari dhe mbrojtësi kanë të drejtë të emërojnë këshilltarë teknikë nga regjistri i ekspertëve gjyqësorë, numri i të cilëve nuk mund të jetë më i madh se dy, me qëllim që t’u ndihmojnë në mbledhjen e të dhënave për çështje profesionale apo kontestim të ekspertizës. Në raste të parapara me këtë ligj, për mbrojtje të personave të varfër, mbrojtja ka të drejtë për ndihmë nga një këshilltar teknik që do të paguhet nga buxheti i shtetit. Të drejtat dhe obligimet e ekspertit, të përcaktuara me këtë ligj, në mënyrë përkatëse zbatohen edhe për këshilltarët teknikë (neni 244).

Këshilltarët teknikë mund të marrin pjesë kur u jepen detyrat ekspertëve dhe munden gjyqit t’i parashtrojnë kërkesa dhe vërejtje sa i përket ekspertizës, të cilat shënohen në procesverbal. Me kërkesë të palëve, këshilltarët teknikë mund të marrin pjesë gjatë veprimeve të ekspertizës, me ç’rast mund të propozojnë hulumtime të veçanta për ekspertin, si dhe të japin vërejtje të cilat do të futen në raport (neni 245).

5.6. Inspektimi dhe rekonstruktimi

Inspektimin e bën prokurori publik, ndërsa me autorizim të tij edhe policia gjyqësore, kur për vërtetimin apo qartësimin e ndonjë fakti të rëndësishëm gjatë procedurës nevojitet vëzhgim i drejtpërdrejtë. Për t’i kontrolluar dëshmitë e mbledhura apo për vërtetimin e fakteve të cilat janë me rëndësi për qartësim të çështjeve, organi që udhëheq me procedurën mund të përcaktojë rekonstruktim të ngjarjes, gjë që bëhet në atë mënyrë që do të përsëriten veprimet apo situatat në kushtet në të cilat kanë ndodhur ngjarja sipas dëshmive të siguruara. Nëse në deklaratat e dëshmitarëve apo të dyshuarve të caktuar, gje gjegjësisht të të akuzuarve, veprimet apo situatat janë paraqitur ndryshe, rekonstruktimi i ngjarjes, sipas rregullit, do të bëhet me secilin prej tyre në mënyrë të pavarur.

6. MASAT E VEÇANTA HETIMORE

Masat e veçanta hetimore, me të cilat në masë të konsiderueshme hyhet në privatësinë e njerëzve, mund të përcaktohen vetëm atëherë kur ka gjasa të mira se do të sigurohen të dhëna dhe dëshmi të domosdoshme për udhëheqje të suksesshme të procedurës penale, e të cilat nuk mund të mblidhen në ndonjë mënyrë tjetër. Katalogu i masave për hetimet penale është përmendur në mënyrë taksative në ligj dhe nuk mund të ndryshojë me ndonjë ligj tjetër apo akt nënligjor.²⁰ Si masa të veçanta në LPP tani janë shënuar 12 masa:

- përcjellja dhe incizim të komunikimeve telefonike dhe elektronike;
- përcjellja dhe incizim në shtëpi, në hapësirë të mbyllur apo të rrethuar;
- përcjellja dhe incizimi i fshehtë i personave dhe i sendeve me mjete teknike;
- inspektimi i fshehtë dhe kërkimi në sistem kompjuterik;
- kërkimi automatik dhe krahasimi i të dhënave personale;
- inspektimi i komunikimeve të realizuara telefonike dhe i komunikimeve të tjera elektronike;
- blerja e simuluar e sendeve;
- dhënia dhe marrja e simuluar e ryshfetit;
- dërgesa e kontrolluar dhe transporti i personave dhe i sendeve;
- shfrytëzimi i personave me identitet të fshehur;
- hapja e llogarisë bankare, dhe
- regjistrim i simuluar i personave juridikë.

Masat e veçanta hetimore mund të përcaktohen vetëm për vepra penale për të cilat është paraparë dënim me burg së paku prej katër vjetësh, e për të cilat ekziston dyshim i arsyeshëm se janë kryer nga ana e një grupi të organizuar, bande apo shoqërie tjetër kriminale, si dhe për disa vepra penale të përcaktuara në mënyrë eksplicite në Kodoin Penal.

Masat me të cilat ndikohet më intenzivisht në të drejtën e privatitetit (neni 252 paragrafi 1, pikat 1 deri në 5) i përcakton gjykatësi i procedurës paraprake urdhëresë me shkrim pas kërkesës së arsyetuar të prokurorit publik, ndërsa masat tjera (neni 252 paragrafi 1, pika 6 deri në pikën 11) i përcakton prokurori publik me urdhëresë me shkrim.

Të dhënat, njoftimet, dokumentet dhe sendet e siguruara me zbatim të masave të veçanta hetimore, nën kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj, mund të shfrytëzohen si dëshmi gjatë procedurës penale.

²⁰ Shih J. JOVÇESKI, G. KALLAJXHIEV dhe të tjerët, Masat speciale hetimore në legjislacionin penal të RM-së, RMDPK, nr.2, 2009, fq. 155.

7. HETIMET E MBROJTJES

Koncepti i ri i hetimit nga ana e palëve e aktualizon edhe më tepër pjesëmarrjen e mbrojtjes në procedurën paraprake. Sado që prokurori të jetë i obliguar për të bërë hetim objektiv dhe të ligjshëm të rastit, ai megjithatë është palë në procedurë dhe me vet këtë tenton ta vërtetojë tezën të cilën e ka mbështetur me vendimin për të iniciuar hetim se i dyshuari me të vërtetë e ka kryer veprën për të cilën ngarkohet. Prandaj Ligji i ri për Procedurë Penale mundohet të krijojë një baraspeshë të re në mes shtetit dhe të akuzuarit duke mundësuar hetime të mbrojtjes.

Në atë drejtim, LPP parashih që mbrojtësi, që nga fillimi i ushtrimit të detyrës së tij, të mund të ndërmarrë veprime të caktuara për të gjetur dhe mbledhur dëshmi në dobi të mbrojtjes. Me qëllim që t'i mbledhë njoftimet e nevojshme, mbrojtësi apo hetuesi privat i autorizuar nga ai mund të bisedojë me persona të cilët mund të shpalosin rrethana të dobishme për qëllimet e veprimeve hetuese. Mbrojtësi do të mund që prokurorit publik dhe gjykatësit gjatë procedurës paraprake drejtpërdrejt t'ua prezantojë informatat dhe dëshmitë që janë në favor të personit të cilin e përfaqëson.

Kështu, Ligji i ri në masë të konsiderueshme e redukton **pjesëmarrjen e mbrojtjes** gjatë ndërmarrjes së veprimeve procedurale të cilat i udhëheq prokurori publik. Megjithatë, përveç te marrja në pyetje e dëshmitarëve, avokatët si mbrojtës do të mund të marrin pjesë në shumë veprime të rëndësishme gjatë hetimit, si për shembull, te bastisjet (neni 191),²¹ marrja në pyetje e të akuzuarit (neni 71, 206), ekspertizat dhe inspektimi (neni 233).²²

Tanimë pamë se i dyshuari nuk do të ketë më mundësi që ta kontestojë iniciimin e procedurës hetimore, që do të thotë se standardi i *dyshimit të bazuar* për iniciim formal të hetimit nuk do të mund të kontestohet para gjyqit (përveç te paraburgimi) dhe do të jetë vetëm i natyrës së dhënies së instruksioneve. Aq më tepër që **i akuzuari aspak nuk do të lajmërohet** për faktin se kundër tij është iniciuar procedurë hetimore!²³ Kjo padyshim është më tepër në favor të prokurorisë, për arsye të thjeshtë se mundësia që hetimi të pengohet nga ana e

²¹ Sipas nenit 191, personi tek i cili apo ndaj të cilit bëhet bastisje do të udhëzohet se ka të drejtë të marrë mbrojtës, i cili mund të marrë pjesë gjatë bastisjes, e nëse ka gjasa që ai nuk do të mund të vijë në afat prej 2 orësh, personit do t'i mundësohet të marrë mbrojtës nga lista e mbrojtësve kujdestarë. Ky përcaktim duket pak si joadekuat kur bastisja nuk bëhet te i akuzuari por te ndonjë person i tretë.

²² Ligji i ri për procedurë penale përmend prani të mbrojtësit vetëm gjatë inspektimit, e jo gjatë rekonstruktimit, që është e qartë se kjo paraqet një lëshim. Prania e mbrojtësit gjatë ekspertizës nuk përmendet në mënyrë eksplicite, mirëpo se mbrojtja është e kyçur në mënyrë aktive gjatë këtij veprimi shihet nga mundësia që gjatë ekspertizës të angazhohen edhe ekspertë të mbrojtjes si këshilltarë teknikë (neni 244, 245).

²³ Shih te: D. ILIQ, Reforma e hetimit në Republikën e Maqedonisë, Punim magjistrature, Fakulteti Juridik, Shkup, 2009.

VEPRIMET HETIMORE - DORACAK PËR PROFESIONISTËT 33

të dyshuarve në këtë mënyrë do të jetë më e vogël. Ky është një handicap i konsiderueshëm për mbrojtjen, mirëpo nuk duhet të harrohet se kjo zgjidhje ka edhe disa përparësi për të dyshuarit: kështu, mund të shqetësohen qytetarë të cilët ndoshta edhe asnjëherë nuk do të akuzohen; gjasat për paraburgosje të tyre janë më të vogla (gjë që mund të ndodhë poqë se ata informohen se janë nën hetim nga frika se do të mund të ikin apo se do të ndikojnë në ecurinë e procedurës me fshehjen apo shkatërrimin e dëshmimeve etj.) etj.

Ky largim i mbrojtjes nga hetimet e prokurorisë (dhe të policisë) në Ligjin e ri për procedurë penale, në shikim të parë, duket se shkon në dëm të interesave të mbrojtjes, mirëpo duhet të shihet nga aspekti i deformalizimit të hetimit dhe insistimit që dëshmitë të prezantohen vetëm gjatë diskutimit publik në gjyq. Veprimet e palëve në fakt nënkuptojnë “barazi të armëve” pas mbarimit të hetimit; atëherë palët duhet patjetër t’i zbulojnë dëshmitë me të cilat disponojnë, dhe të njëjtat t’i testojnë në diskutim publik kundërshtues para gjyqit të paanshëm.



PJESA 2. PRAKTIKA KOMPARATIVE MBI HETIMIN

1. HYRJE

Trendet moderne në hetimet penale në Evropë është larguar shumë prej metodave të hetuesisë inkuizitore që përfshijnë një gjyqësi me shumë lëshime në hetime policore që mbikëqyren nga ana e prokurorit publik.

Sistemet e vëzhguara në këtë punim i nxjerin në dukje dallimet dhe ngjajshmëritë në Evropë dhe gjykatat e tribunalet ndërkombëtare.

Disa paraqitje kryesore dallojnë procedurat hetuese në sistemet e së drejtës zakonore/kundërshtuese dhe hetuesisë civile ose sistemit kundërshtues hibrid. Në përmbëkdhje këta janë përgjegjësia momentale për hetim, shtrirja e e hetimit, diskrecioni që të zbulojnë ose të ndjekin dhe roli i gjykatës në akt gjykimin dhe procesin e hetimit.

Me përjashtim të Anglisë dhe të Uellsit (Britania e Madhe) në secilën prej sistemeve nacionale dhe ndërkombëtare të përzgjedhura për krahasim, prokurori është përgjegjës për kundërvajtjet në hetuesi, edhe pse në praktikë në shtetet e së drejtës zakonore përdoret procedurë gjyqësore kundërshtuese dhe shumë punë hetimore përcillen në polici.

Në Angli dhe në Uells, si përjashtim, policia bën hetimin e krimeve dhe në shumicën e rasteve ato ia referon për ndjekje penale Shërbimit të Prokurorisë Penale. Disa agjenci të specializuara, siç janë autoritetet statusore me funksione specifike, kombinojnë zbatuesit e ligjit për hetime dhe ndjekje penale. Në sistemet e pastra të së drejtës civile të cilat janë pikëvëzhgimi i ketij punimi si dhe gjykatat e tribunalet ndërkombëtare prokurorët janë ata të cilët e hetojnë dhe e kontrollojnë hetuesit ose policinë. Kontrolli i gjyqësorit ose mbikqyrja janë pjesë e sistemit civil kundërshtues Italian por jo edhe pjesë e sistemit hibrit të Bosnës.

36

Në shumë sisteme civile, hetimi është i obligueshëm nëse dërgohet denoncim penal. Në sistemet e së drejtës zakonore policia ka diskrecion që të mos hetojë, prokurori ka një diskrecion tepër të gjërë për të mos ngritur çështjen në gjykatë.

Në sistemet e hetimit civil, hetuesi qoftë ai gjykatës, prokuror ose polic duhet të të zbulojnë edhe dëshmitë materiale në favor të të pandehurit. Sistemet e të drejtës zakonore, të udhëhequra nga ana e palës, nuk kërkojnë nga agjencitë hetimore të hetojnë në mënyrë aktive gjetjen e dëshmimeve materiale në favor të të pandehurit, edhe pse nga ato kërkohet, që të zbardhin para mbrojtjes materiale të tilla që ato i posedojnë.

Si rregull e përgjithshme sistemet e të drejtës zakonore i japin diskrecion të gjerë prokurorisë për atë nëse një rast duhet të dërgohet para gjykatës. Në Angli dhe në Uells prokurori sjell akuzën ose padinë para gjykatës. Pasi lexohet padia dhe i pandehuri dëshiron që të hyjë në përcaktimin e tij se a është fajtor ose jo; gjykata vazhdon me procedurën gjyqësore ose me shqyrtimin e dënimit. Për dallim në sistemet e tjera nacionale dhe ndërkombëtare, vendimi i nënshtrohet një shqyrtimi gjyqësor për të parë vullë ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme për të konfirmuar akuzën dhe kështu të vazhdohet me rastin.

Në secilin sistem të vëzhguar për këtë punim nga autoriteti i gjyqësor kërkohet që për disa metoda të caktuara hetimore siç janë urdhëresat për bastisje ose ndërhyrja elektronike.

Roli i avokatit mbrojtës është i ngjashëm në çdo sistem në mënyrë që avokati mbrojtës është përgjegjës për t'u përgjigjur në rastin e prokurorisë dhe për përpilimin e rastit të mbrojtjes. Ndihma gjyqësore është në dispozicion në sistemin Italian dhe sistemet ndërkombëtare. Sistemi italian dallon nga sistemet e tjera në atë se avokati mbrojtës mund të jetë i pranishëm në të gjitha aktet formale të hetimit.

Në gjykatat dhe në tribunalët ndërkombëtarë mbrojtja kryen hetimet e veta. Prokurori e ka tërë përgjegjësinë për hetimin. Gjykata Ndërkombëtare e Krimeve lejon përfshirje të kufizuar nga ana e dhomës para-gjyqësore në procesin hetimor.

2. ANGLIA DHE UELLSI (BRITANIA E MADHE)

2.1. Hyrje

Anglia dhe Uells gjatë kohë zbatojnë një procedurë të hetimit kriminal të përshkruar si “me rrënjë në traditën kundërshtuese”²⁴. Roli i prokurorit në hetimin e kriminit është i kufizuar. Agjencia hetimore kryen hetime nëse një kundërvajtje është kryer dhe, nëse po, duhet parë se kush është përgjegjës. Përgjegjësia nuk është grumbullim aktiv i informacionit dhe i dëshmimeve që janë në favor për të dyshuarit dhe të pandehurit.

Fuqitë hetuese siç janë arrestimi, bastisja dhe konfiskimi i pronës, pyetja e të dyshuarve dhe paraburgimi janë të definuara dhe të regulluara nga një përzierje e statuteve, kodekseve dhe vendimeve gjyqësore të së drejtës zakonore. Ndryshimet ligjore të shpeshta e kanë kodifikuar në mënyrë efektive të gjitha fuqitë policore por jo nën të njëjtin statut (si rasti i Italisë). Burimi kryesor është Akti i Policisë për Dëshmi Penale i vitit 1984 dhe tetë kodet e tij. Ekzistojnë edhe statute të tjera të cilat përfshijnë Regulloret për Fuqitë Hetuese të vitit 2000 dhe Akti i Procedurës Penale dhe Hetimve i vitit 1996 i cili gjithashtu përmban fuqi relevante.

Shërbimi i Prokurorisë Penale është agjencia kryesore për ndjekje penale udhëhiqet nga Drejtori i Prokurorisë Publike i cili gjithashtu është edhe Drejtor i Ndjekjeve Penale për të Hyrat Publike dhe Ndjekjet Doganore.

Policët janë hetuesit primarë dhe nuk janë subjekt i udhëzimit ose kontrollimit nga të Shërbimi i Prokurorisë Penale (SHPP), roli i hetuesit dhe prokurorit kryesisht janë të ndara, përjashtim bën Zyra për Mashtrime të Rënda e cila ka për detyrë për ndjekjen e dhe zbulimin e krimeve të mashtimeve të rënda mitmarrjeve dhe korupcionit. Sikurse edhe tribunalët ndërkombëtarë punëson nën mbikëqyrje ligjore, ekipe shumë-disiplinore të kontabilistëve, bankierëve, specialistë për kompjuterë, dhe hetues policorë. Funkcionet e tij të specializuara i japin të drejtë që të përpilojë prodhimin të cilat janë në lidhje me ndonjë hetim ose ndjekje si dhe për mos prodhimin dhe kërkimin e fletëurdhëresës për kontrollim²⁵. Disa agjenci tjera të specializuara, që bëjnë edhe hetimet edhe ndjekjet penale janë Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë, Ekzekutivin e Shëndetësisë dhe Sigurisë, Agjencioni i Mjedisit, dhe Departamentin për Siguri Sociale. Autoritetet vendore gjithashtu kombinojnë që të dyja.

²⁴ “Faza e Hetimore e Procesit Penal në Angli dhe Uells Cape dhe Hodgson” Ed Cape, Jacqueline Hodgson, Ties Prakken (eds) Të dyshuarit në Evropë: Të drejtat procedurale në fazën hetimore të procesit penal në Unionin Evropian (Studime Ndërkombëtare për Sigurinë shëndetësore (Intersentia)) 2007, faqe 59.

²⁵ Seksioni 2 Akti për të drejtën penale 1987

Hetimet duhet të jenë në përputhje me garancitë për të drejtat e njeriut nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Akti i të Drejtave të Njeriut nga viti 1998 (seksioni 3) siguron “Deri më tani aq sa është e mundshme të bëhet, duhet të lexohet dhe të hyn në fuqi legjislacioni primar dhe i sekondar në mënyrë që të jetë në përputhje me drejtat e Konventës”. Si shembull, SHPP duhet të zbardhë informacione në favor të të padehurit ose material që nuk është në favor të dëshmitarëve të prokurorisë.

Metodat të bezdisshme hetuese siç janë fletë-arresti dhe ndërhyrja elektronike detyrimisht duhet të jenë të autorizuar nga zyrtarët gjyqësorë.

2.2. Roli i policisë si hetuese

Policia pikësëpari është përgjegjëse për hetimin e krimeve dhe pyetjen e arrestimin e të dyshuarve, ajo duhet që të bëjë këtë pa kontrollin e prokurorit ose ndonjë autoriteti gjyqësor.

Policia vendos se cilat krime do ti zbulojë, si ti zbulojë ata dhe kë të pyesë e arestojë. Policia mbledh dëshmi, mer në pyetje dëshmitarë, për arrestimin dhe paraburgimin e të dyshuarve, marrjen në pyetje të të dyshuarve, marrjen dhe ekzekutimin e urdhër-arresteve të lëshuara nga gjyqësia, si dhe sekuestrimin dhe vëzhgimin elektronik. Ata mund të arestojnë nëse ekziston një dyshim i arsyeshëm së një vepër penale është bërë, po bëhet ose do të bëhet.²⁶

Kodi i bashkëngjitur në Aktin policor për Dëshmitë Kriminale rregullon kryesisht kryerjen e hetimeve përfshirë edhe marrjen në pyetje të të dyshuarve, të drejtat e tyre gjatë qëndrimit në paraburgim, lirimi i tyre me garanci etj. Policia dhe zyrtarët e tjerë përgjegjës për hetimin e kundërvajtjeve, siç janë zyrtarët e të Hyrave Publike dhe të Doganave të cilët bëjnë hetime lidhur me mashtrimet tatimore dhe me kundërvajtjet doganore ose akuzojnë të pandehurit sipas Kodeve.²⁷ Dëshmitë e mbledhura me shkelje të Kodeve mund të përjashtohen nga ana e gjykatës²⁸

Intervistat me të dyshuarit në lidhje me ndonjë kundërvajtje të veçantë dhe ata që dëshohen nga Gjykata e Qarkut, duhet që të inçizohen ose nëse kjo nuk është e mundur të mbahet proces verbal i shkruar.²⁹ Shpesh herë prokurorët përdorin këta shënime si dëshmi kundra të pandehurit dhe secila palë mund që të kërkojë të ketë një kasetë të cilën do ta përdorte në gjykatë.

²⁶ Seksioni 60, 67 Akti për polici dhe për dëshmi penale 1984.

²⁷ Seksioni 78 i Aktit për polici dhe për dëshmi penale 1984.

²⁸ Seksioni 24 Akti për polici dhe për dëshmi penale 1984.

²⁹ Seksioni 58 Akti për polici dhe për dëshmi penale 1984.

Një deklaratë pranimit e marrë nën presion, i definuar si torturë, trajtim johuman apo degradues, ushtrim dhune ose kërcënim nga një person i cili ka dhënë atë ose rrethanat e dhënies së saj e bëjnë atë jo të besueshme mund të mos përdoret kundër personit në gjykatë.³⁰ Nëse në seancë mbrojtja sugjeron se deklarata e pranimit është marrë me presion gjyqi nuk mund të pranohet atë në dosje të dëshmive përderisa nuk dëshmohet se ajo nuk është marrë me presion.³¹ Gjykata po ashtu ka një diskrecion të përgjithshëm për të përjashtuar dëshminë nëse “duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, përfshirë edhe rrethanat në të cilat është marrë dëshmia, pranimit i dëshmisë do të kishte një efekt aq kundërshtues në drejtësinë e procedurës gjyqësore sa që gjyqi nuk do duhet të pranohet atë”.³²

I pandehuri paralajmërohet me fjalët “ju mund të dëmtoni mbrojtjen tuaj nëse nuk përmendni gjatë marrjes suaj në pyetje diçka në të cilën ju do të mbështeteni më vonë gjatë seancës në gjyq”³³ Konkluzione kundërshtuese mund që të nxiren kundër të pandehurit i cili mbështetet në materjale të tilla gjatë senacës gjyqësore.³⁴ Kjo mund të arëdojë punën avokatit mbrojtës i cili këshillon klientin e vet gjatë qëndrimit në arrest në polici meqë në atë pikë mund të jetë shumë vështirë të përcaktohet nëse mund që ti propozojë atij ndonjë nga mjetet për vetëmbrojtje nëse ata ekzistojnë, si dhe në pikën se çfarë këshille ti japë klientit, është plot e përplot me vështirësi.

Gjykata duhet të ketë para sysh se një i dyshuar mund të ketë marrë këshillë juridike të mbrohet në heshtje.³⁵ Numri i këtyre rasteve dhe interpretimi i kësaj dispozite është shumë e gjerë. Gjyqata Evropiane vendosi që konkluzionet e këtilla kundërshtuese të jenë “domosdoshmërisht të kufizuara”³⁶ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vendosur se shtyrja e kohës për qasje të këshillat juridike në rrethana kur mund të nxirren konkluzione kundërshtuese nga heshtja nuk janë në përputhshmëri me të drejtat e garantuara sipas Nenit 6 (3) të Koventës.³⁷

Gjatë një hetimi policia mund të aplikojë te gjykata për urdhër-bastisje për të ekzekutuar bastisje të pronave.³⁸ Ndërhyrja në telekomunikime mund të përdoret si një vegël hetimore, por nuk mund të përdoret në gjyq si dëshmi. Përkundër urdhëresës për bastisje e cila kërkon autorizim gjyqësor, urdhri për ndërhyrje elektronike kërkon miratim ministror të Sekretarit Shtetëror. Ai mund të autorizohet nëse është në interes shtetëror ose është për të parandaluar ose detektuar një krim të rëndë, pjesë përkufizimi i të cilit është një dënim i pritur prej

³⁰ Për shembull, Murray kundër Britanisë së Madhe A 300-A (1994) paragrafi 55, Condron kundër Britanisë së Madhe (2001) 31 EHRR 1.

³¹ Seksioni 60 Akti për polici dhe për dëshmi penale 1984, Kodi C, seksioni 11 dhe Kodi E.

³² Seksioni 76 Akti për polici dhe për dëshmi penale 1984.

³³ Seksioni 76 (2) Akti për polici dhe për dëshmi penale 1984.

³⁴ Seksioni 78 Akti për polici dhe për dëshmi penale 1984.

³⁵ Seksioni 34 Akti për të drejtën penale dhe për rend publik 1994.

³⁶ Akti për polici dhe për dëshmi penale 1984 Kodi C 10.5.

³⁷ Averill kundër Britanisë së Madhe (2001) 31 EHRR 839 në paragrafin 47.

³⁸ Shih Condron kundër Britanisë së Madhe (2001) 31 EHRR 1.

40

tre viteve burgim.³⁹ Materjali dëshmuës i marrë me anë të dhunës, jo si në të gjithë jurisdikcionet, është i pa pranueshëm si dëshmi në gjykatë.

Policia mund që të zbatojë një procedurë identifikimi para shqyrtimit të akuzës si për shembull rradhitja e të dyshuarvedhe identifikimi grupuese gjatë të cilave të pandehurve do t’ju jepet “një mundësi e arsyeshme që të kenë përfaqësues (avokat) ose ndonjë mik gjatë procedurës.”⁴⁰

Nuk ekzistojnë rregulla formale për marrjen në pyetje të dëshmitarëve të cilët nuk janë të dyshuar.

Përkundër shumë sistemeve Evropiane, Britania e Madhe nuk ka përkufizim juridik të termit “i dyshuar”. Paraburgimi në arrest policor më i gjatë se 36 orë kërkon autorizim gjyqësor.⁴¹ Paraburgim pa akuzë deri në 28 ditë lejohet sipas akteve për terrorizëm të vitit 2000 dhe 2006. Një person i arrestuar ka të drejtë konsultimi me një avokat privat nëse personi “kërkon një gjë të tillë”, dhe atë duhet lejuar të bëjë një gjë të tillë sa më shpejt që të jetë e mundshme. Kjo mund të shtyhet për deri në 36 orë në rrethana të caktuara ose shtatë ditë në raste të llojit të krimit të definuar “terrorizëm”.⁴²

Një oficer arresti me detyrë në stacionin policor ngarkon të dyshuarit për kryerje të krimeve dhe vendos nëse ata duhet të lëshohen me garanci ose të mbahen në paraburgim në pritje të shqyrtimit gjyqësor për paraburgimin.

2.3. Roli i prokurorit

Prokurorët mund të këshillojnë policinë gjatë procesit të hetimit, SHPP drejton akuzën për shumë vepra penale.

Shërbimi i Prokurorisë Penale është themeluar më 1995. Një qëllim i ndarjes së rolit të policisë dhe prokurorit, si dhe garantimi të pavarësisë së tyre nga policia, shihet në ndarjeje të qartë të punës mes tyre, ashtu që prokuroria të mos ketë kurrfarë roli mbikëqyrës ndaj policisë. Kështu, SHPP është përgjegjës për sjelljen e rasteve para gjykatës. Megjithatë, një dyfishim i shquar ekziston mes dy funksioneve në faktin se SHPP këshillojnë dhe udhëheq policinë, shqyrtojnë materialin hetimor para parashtrimit të akuzave penale dhe udhëzojnë policinë në lidhje me atë se çfarë akuzave penale mund të parashtrohen.

³⁹ Seksioni 8 Akti për polici dhe për dëshmi penale 1984.

⁴⁰ Seksionet 5 dhe 17, Akti për rregulloren e kompetencave hetimore 2000.

⁴¹ Seksionet 34, 37, 39, 40, 41, 42, 44 dhe Kodi C Akti për polici dhe për dëshmi penale 1984.

⁴² “Udhëzimi i Drejtorit për udhëzimet për akuzim për policët dhe prokurorët penal, lëshuar nga Drejtori për ndjekje penale publike ndër S37A të Aktit për polici dhe për dëshmi penale 1984” botimi i 3-të, shkurt 2007.

⁴³ Seksionet 71 dhe 72 të Aktit për krime të organizuara të rënda dhe për polici 2005.

Prokurorët penal që punojnë brenda zyrës së Drejtorit të Prokurorisë Publike iu japin “hetuesve udhëzim dhe këshilla gjatë procesit të hetuesisë dhe të ndjekjes penale. Kjo mund të përfshijë pika të hetimit, të kërkesave për dëshmi, dhe të asistencës në çfarëdo procedure para-akuzuese. Prokurorët Penal do të jenë proaktivë gjatë identifikimit, dhe aty ku është e mundshme, korrigjimit të mangësive në dëshmi dhe në sjelljen e konkluzioneve të parakohshme për rastet të cilat nuk mund të përforcohen me anë të hetimit të mëtejshëm” Prokurorët duhet të sigurohen se i kanë të gjitha informacionet e nevojshme për të sjellë një vendim me informacion për mënyrën se si të veprohet më së miri me atë rast. Megjithatë, prokurorët “nuk mund të udhëzojnë policinë apo hetues të tjerë.”⁴³

Prokurori po ashtu mund të ofrojë imunitet nga ndjekja penale kur një gjë e tillë është e përshtatshme për hetimin apo ndjekjen penale për çfarëdo kundërvajtje, ose kur një person ofron asistencë, mund të siguron një veprim për të mos përdorë një dëshmi të caktuar kundër atij personi.⁴⁴

2.4. Akuzimi i të dyshuarve për veprën penale

Përkundër disa sistemeve të së drejtës civile, ndjekja penale nuk është e detyrueshme dhe prokurori ka diskrecion të gjerë për mënyrën se si të ngrihet padia me një pohim të pabazuar për një kundërvajtje penale. Drejtori i Prokurorisë Publike ka sjellë udhëzime të detyrueshme për vendimet për dhënien e akuzës duke theksuar në formë të dispozitës se “Prokurorët dhe hetuesit punojnë ngushtë me njëri tjetrin, por përgjegjësinë përfundimtare për sjelljen e vendimit nëse një rast duhet të përcillet më tej qëndron tek shërbimi i prokurorisë.”⁴⁵ Ndryshe nga sistemet tjera të vëzhguara për qëllimet e këtij punimi, gjykatat në Angli dhe Uells nuk e rinovojë ose vërtetojnë ndonjë akt-padi ose dëshmi të cilat e përmbajnë atë ose të rishikojnë vendimin e prokurorit.

Prokurori, gjithashtu, mund të marrë vendim unik për ngritjen e padisë në Gjykatë e Qarkut ose Gjykatës së Magjistraturës. ka një rol të rëndësishëm në vendosjen nëse duhet akuzuar një i dyshuar dhe prokurorët japin asistencë 24 orë policisë për mundësimin e konsultimeve efikase dhe efektive të parakohshme dhe marrjen e vendimit për akuzë.

Polici i arrestit në çdo stacion policor vendos nëse duhet që të ngrihet padi penale kundra një personi të dyshuar i cili ndodhet në arrestim, kjo nuk mund që të bëhet nga oficeri policor i hetuesisë.⁴⁶ Policia mund të ngre akuzë pa informacion prej SHPP vetëm në rast të kundërvajtjeve të lehta të cilat mund të gjykohen në Gjykatat Magjistruese. Në raste të tilla SHPP ndjek, prokurorët rishikojnë dëshmitë, përcaktojnë veprën penale dhe njoftojnë oficerin e arrestit i cili vendos

⁴⁴ Pjesa IV, Akti për polici dhe për dëshmi penale 1984.

⁴⁵ Seksionet 37, 37A, 37B të Aktit për polici dhe për dëshmi penale 1984.

⁴⁶ “Udhëzimi i Drejtorit për udhëzimet për akuzim për policët dhe prokurorët penal, lëshuar nga Drejtori për ndjekje penale publike ndër S37A të Aktit për polici dhe për dëshmi penale 1984” botimi i 3-të, shkurt 2007.

42

nëse allë a ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme për të akuzuar një person me padi penale ose për të autorizuar paraburgimin e tij për një periudhë kohore të nevojshme për mbledhjen e dëshmive, ose të pyesin të dyshuarin me qëllim që të marrin dëshmi.

SHPP mund që të vendosë në mënyrë alternative si dhe në diskrecion, nëse nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të ngarkuar dikë me vepër penale, ose përveç ekzistimit të dëshmive një njeri nuk duhet që të ngarkohet ose ndëshkohet. SHPP mund të vendosë për t'i tërhequr vërejtjen personit në vend se ta akuzojë atë.⁴⁷ Polici i arrestit atëherë duhet që me shkrim të informojë atë se nuk do të ndiqet.⁴⁸

Polici për arrest, po ashtu, mund të lirojë personin pa akuzë ose ta paraburgosë atë në pritje të vendimit nga ana e SHPP për ngritje të akuzës.

Prokurorët kanë një diskrecion tepër të gjerë në atë se a të ngrejë çështjen përpara gjykatës ose jo; normalisht që SHPP vendos vetëm se pasi të kenë mbaruar të gjitha hetimet dhe pas rishikimit të të gjitha dëshmitë e mundshme.

DPP vendosin udhëzime nëse duhet që të aplikohen testim për interesat publike dhe dëshmuese gjatë vendimit se vallë mos ndoshta një rast do të dërgohet në gjykatë. Testimi i dëshmive duhet të shihet nëse ka “prova të mjaftueshme për të siguruar një pamje reale të dënimit kundër secilit të dyshuar për çfarëdo akuze.” Gjatë përcaktimit të kësaj prokurori “patjetër të marrë në konsideratë çfarë mund të jetë rasti i mbrojtjes, dhe sa është e mundshme që ajo të ndikojë në pamjen e dënimit. Një rast i cili nuk kalon fazën që merret me dëshmitë nuk duhet të kalojë më tutje, pavarësisht sa i rëndë dhe sa i ndjeshëm që mund të jetë rasti.” Por “kur është e qartë, para grumbullimit dhe marrjes në konsideratë të të gjitha dëshmive të mundshme, se interesi publik nuk kërkon ndjekje penale. Në këto raste të rralla prokurori mund të vendosë që rasti nuk duhet të vazhdojë më tej”.

Në vend se një rast të dërgohet në gjyq, në “raste të përshtatshme” një person, nën udhëzimin e prokurorit, mund të pranojë vërejtje, një vërejtje të kushtëzuar, një qortim ose një paralajmërim të fundit.⁴⁹ Prokurorë mundën që personalisht të lëshojnë vërejtje formale për të dyshuarit. Një vërejtje e kushtëzuar mund të kërkojë ndonjë formë të riparimit ose kryerjes së ndonjë akti tjetër.⁵⁰

⁴⁷ “Udhëzimi i Drejtorit për udhëzimet për akuzim për policët dhe prokurorët penal, lëshuar nga Drejtori për ndjekje penale publike ndër S37A të Aktit për polici dhe për dëshmi penale 1984” botimi i 3të, shkurt 2007. 2. Dispozitat dhe principet kryesore të këtij udhëzimi; seksioni 37B (5) i aktit për polici dhe për dëshmi penale 1984

⁴⁸ Seksioni 37B (6) i Akti për polici dhe për dëshmi penale 1984.

⁴⁹ Akti për të drejtën penale 2003, pjesa 3 dhe Kodi i praktikës për vërejtje të kushtëzuar.

⁵⁰ R. kundër Drejtorit të Zyrës për mashtime të rënda, ex parte Smith [1993] AC1 (House of Lords).

2.5. Hetimet nga Prokurori

Drejtori i Prokurorisë Publike është i autorizuar për hetimin e veprave penale të caktuara ngritje padie nga ana e forcave kundër krimit, trafikimit me drogë, terrorizmit, larjes së parave, kundërvajtjeve lidhur me të drejtat autoriale, dhe shmangieve të pagimit të tatimeve⁵¹. Prokurori mund të lëshojë njoftim për zbulim me të cilën kërkon nga personi që do t'u përgjigjet pyetjeve të ndërlidhura me hetimin, të sigurojë informacione që kanë të bëjnë me çështjen specifike dhe të përpilojë dokumentacionin. Hyrja në pronat për të gjetur materiale kërkon një urdhër-arrest, por vetëm se prokuroria (jo policia) mund të aplikojnë për urdhër-bastisjeje. Nuk ekziston kurrfarë kriteri që avokati mbrojtës të jetë i pranishëm gjatë bastisjes. Zyra për mashtrime të rënda mund të detyrojë një person të jep përgjigje në pyetje edhe pasi që një i pandehur të jetë akuzuar.⁵² Përgjigjet e detyruara mund të mos shfrytëzohen kundër personit në ndjekje penale ose në hetime.⁵³

2.6. Roli i avokatit mbrojtës

Duke mos pasur një hetim kontrollues nga ana e gjyqësorit dhe për arsyen se shumica e të pandehurve pranojnë fajin, roli i avokatit mbrojtës është shumë i rëndësishëm. Në Angli dhe Uells, zakonisht, përveç prokurorit, avokatit mbrojtës është i vetmi person juridik i përgatitur për të shqyrtuar vallë a ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të dyshuarit.

Roli i avokatit mbrojtës buron drejtpërdrejtë nga e drejta e të pandehurve për të mbrojtur veten e tyre. Një avokat "e ka për detyrë të thotë në emër të klientit në mënyrë të duhur atë që klienti do të thoshte për vete po qe se klienti do posedonte aftësitë dhe njohuritë e duhura".⁵⁴ Avokati mbrojtës mund ta këshillojë klientin e dyshuar në stacionin policor dhe të jetë prezent gjatë marrjes në pyetje. Kodi C nga Akti i policisë dhe i dëshmimeve penale shpjegon rolin e avokatëve mbrojtës në stacionin policor për "të mbrojtur dhe avancuar të drejtat ligjore të klientit të tyre." Kjo mund të kërkojë që të bëhet këshillimi i klientit për të shmangur përforsimin e rastit të prokurorisë. Ata po ashtu mund të intervenojnë gjatë marrjes në pyetje në kërkim të qartësimi, të sfidojnë pyetjet jo të përshtatshme dhe mënyrën në të cilën ato parashtrohen dhe të këshillojnë klientin të mos përgjigjet në pyetje të veçanta ose të japin këshilla të mëtejme juridike.⁵⁵

⁵¹ Seksioni 65 i Aktit për procedura dhe hetime penale 1996, por mund të përdoret kundër personit për kundërvajtje për shkak të dështimit për të siguruar një deklaratë ose për dëshmi të rreme.

⁵² Udhëzuesi në Punë profesionale të avokatëve, Shoqata e Drejtësisë në Londër, Londër, 1999 f. 382.

⁵³ Akti për polici dhe për dëshmi penale 1984, Kodi C, shënime për udhëzim 6D

⁵⁴ Akti për polici dhe për dëshmi penale 1984, Kodi D.

⁵⁵ Udhëzime për zbardhje të prokurorit të përgjithshëm, paragrafi 8

Kështu, i dyshuari ose avokati nuk ka të drejtë të qasjes në hetimet policore ose në dosjen e rastit. Ai nuk ka as të drejtën e kërkimit për ndërmarrjen e disa hetimeve. Përveç kësaj, Kodi i SHPP për prokurorinë e Qarkut thekson “Edhe pse prokurori fillimisht merr në konsideratë dëshmitë dhe informacion të siguruar nga policia dhe hetuesit tjerë, i dyshuari ose ata të cilët kryejnë detyrën në emër të tij ose asaj mund që të dorëzojnë dëshmi ose informacione te prokurori nëpërmjet policisë ose hetuesve tjerë, para shqiptimit të akuzës, për të ndihmuar në informimin e vendimit të prokurorit”.

Gjithashtu duke mos pasur qasje në dosjen e hetimit policor, avokatët mbrojtës duhet që të kenë një kopje të dosjes së kompletuar në arrest përderisa në stacionin policor dhe më pas për shqyrtimin e fajit, një kopje të kompletuar të dosjes.

Avokatët mbrojtës mund të kryejnë hetimet e veta dhe të intervistojnë dëshmitarët e mundshëm. Megjithatë, ata nuk kanë kompetenca formale për të bërë këtë gjë dhe kurrfarë fondesh publike për këtë. Në praktikë kjo do të thotë një intervistim i thjeshtë i dëshmitarëve të cilët kanë dëshirë për bashkëpunim

2.7. Zbulimi i dëshmive

I padituri ka të drejtë që të marrë një kopje të dëshmive të prokurorisë vetëm pasi që të jetë ngritur aktpadi kundra tij ose është i thirrur në gjykatë.

Zbardhja e dëshmive për mbrojtjen është e rregulluar me Aktin për Procedurë Penale dhe Hetime të vitit 1996 dhe me një doracakun për Kodin e Praktikave i botuar nga Avokati i Përgjithshëm. Këto dispozita janë të shprehura si “Zbardhje që kanë lidhje me sigurimin e mbrojtjes me kopje, ose qasje të çfarëdo materiali i cili me arsye mund të konsiderohet i aftë për të zvogëluar rastin e prokurorisë kundër të akuzuarit, të ndihmojë rastin e për të akuzuarin ose të ndihmojë rastin për të akuzuarin, risi që më parë nuk ka qenë të zbuluara.”⁵⁶

Në praktikë, megjithatë, policia shpesh dhe në një fazë të hershme, do të zbardhë për të dyshuarit dhe për avokatët informacionin për rastin dhe qëndrimin e policisë. Kjo mund të jetë e rëndësishme më vonë kur përcaktohet nëse një konkluzion mund të nxirret nga heshtja pa marrë parasysh marrjen në pyetje ose dështimin për të siguruar shpjegim në kohë, ndërsa më vonë duke u bazuar në gjykatë si mbrojtje.

Mbrojtja për prokurorinë mund të sigurojë zbardhjen vullnetare në formë të një deklarate mbrojtjeje duke vendosur natyrën e mbrojtjes, fakteve që i pandehuri i merr si çështje, arsyen për mospajtim, hollësitë e fakteve për t’u mbështetur në

⁵⁶ Udhëzime për zbardhje të prokurorit të përgjithshëm, paragrafi 8

rastin e mbrojtjes dhe pikat e ligjeve që duhet marrë. Po ashtu mund të sigurohen hollësitë e një mbrojtjeje me alibi.⁵⁷

Udhëzimet e Avokatit të Përgjithshëm thonë “Sa më shumë hollësi që përmban deklarata e mbrojtjes, aq më shumë ka gjasa që prokurori të marrë një vendim të bazuar në informacion për atë vallë ndonjë material i mbetur i pazbardhur mundet me arsye të llogaritet i aftë për të minuar rastin e prokurorit ose për të asistuar rastin për të akuzuarin, e nëse duhet të këshillohet hetuesi për të ndërmarrë hetime të mëtejme.” Prokurori ka një detyrë të vazhdueshme për zbardhjen e fakteve gjatë tërë ndjekjes penale.

3. ITALI

3.1. Hyrje

Sistemi Italian i hetimeve penale është shumë më i ndryshëm se sa sistemi i Anglisë dhe Uellsit. Ndryshe nga sistemet e të drejtës civile Kushtetuta italiane e detyron hetimin e një krimi të paraqitur te Prokurori Publik (*Pubblico Ministero*) dhe thekson “Prokurori Publik e ka për obligim të ndërmerr masa penale”.⁵⁸ Kjo natyrisht se nuk është e mundshme dhe e realizueshme fizikisht dhe si rezultat i pashmangshëm bëhet sistem i mbingarkuar. Si vijim i kësaj, në praktikë detyrimi është përmbushur nëse prokurori në mënyrë formale regjistron denoncimin dhe hap dosjen e çështjes, por nëse çështja është “hetuar” në të vërtetë në mënyrë aktive varret nga shumë faktorë siç janë për shembull rëndësia e krimit, nëse një person i veçantë është i dyshuar i çështjes, si dhe ngarkesa me punë e prokurorit dhe policisë gjyqësore e cila është e ngarkuar që të punojë me prokurorin.

Para reformave të vitit 1988, gjykatësi hetues *guidice istruttore* udhëhiqte hetimet me qëllim të “vërtetimit të së vërtetës” dhe gjykatësi i çështjes përdorte dosjen e hetimeve gjatë seancës gjyqësore.⁵⁹ Kodi për procedurë penale i vitit 1988 bën dallim të qartë mes fazës hetimore dhe asaj gjyqësore të ndjekjes penale dhe jep një ndarje të qartë të përgjegjësisë mes funksioneve hetimore dhe atyre gjyqësore gjatë hetimit preliminar. Kodi ndan masat penale në tri faza: në hetim preliminar, dëgjim preliminar, dhe në seancën gjyqësore.

Gjyqësia ose policia hetimore *ufficiali di polizia giudiziaria* punojnë me autoritetin ose udhëzimin e autoritetit gjyqësor, prokurorit publik.⁶⁰ Kjo është menduar me qëllim që të mbahet ndarja mes gjyqësisë dhe fuqisë ekzekutuese. Zyrtarët e policisë vijnë nga forcat e ndryshme policore dha ta mund që të punojnë me forcat

⁵⁷ Seksioni 6A Akti për Procedurë Penale dhe Hetimet 1996.

⁵⁸ Neni 112 i Kushtetutës italiane

⁵⁹ Neni 299, Kodi për procedurë penale, 1930.

⁶⁰ Neni 109 nga Kushtetuta, nenet 55 deri 59 të Kodit për procedurë penale, 1998.

vendore ose nacionale ose me prokurorinë i cili ka zbatuar funksionin e hetimit penal *funzioni di polizia giudiziari*. Secila zyrë e prokurorit publik ka zyrën e veçantë policore në mënyrë që oficerët e policisë mund që të avancohen në pozitë ose të largohen nga pozita me aprovimin e krye prokurorit. Policia gjyqësore gjithashtu duhet që t’ju përmbahet disa rregullave disiplinore të Kodit të mirësjelljes për policinë. Forcat Speciale Policore siç është Drejtoria Hetuese Kundra Mafisë *Direzione Investigativa Antimafia* në një mënyrë për hetim të veçantë të krimeve të organizuara.⁶¹

Si “dosje e dyfishtë” funksionon sistemi në Itali në të cilin gjatë fazës hetimore regjistrimet hetimore sistemohen në një dosje ose skedar të hetimeve. Në fund të hetimeve, skedari është në dispozicion të palëve, por jo edhe të gjykatësit të seancës gjyqësore. Palët mund të shfrytëzojnë këtë skedar hetimor për përgatitje për seancë, dhe gjatë seancës mund të përdorin materialin nga dosja për të sfiduar dëshmitë e prezantuara gojarisht.

Disa nga funksionet e mëparshme të gjykatësit hetues tani kryhen nga gjykatësi për ndjekje penale preliminare “*giudice per le indagini preliminare*” ose *gip*, i cili intervenon vetëm me kërkesë të palëve (normalisht të prokurorit) dhe për vepra të përcaktuara dhe specifike. *Gip*-i mbikëqyr autoritetet hetuese duke vëzhguar aktivitetet e prokurorit dhe duke garantuar të drejtat e personit në hetime.

3.2. Prokurori si hetues

Prokurorët në mënyrë formale janë anëtarë të gjyqësisë dhe garantojnë pavarësinë e gjyqësorit.⁶² Roli i tyre në thelb ka role të dyfishta të kryerjes së hetimit preliminar dhe të dërgimit të rastit në seancë gjyqësore.

Prokurori publik inicion hetime të para *indagini preliminari* në momentin kur ndonjë krim paraqitet, *notitia criminis*. Prokurori duhet të regjistrojë njoftimin. Pastaj Prokurori ka gjashtë muaj kohë për të kompletuar hetimin. *Gip*-i mund të japë autorizim për shtyrje të afatit deri në 18 muaj, ose në raste të rënda, deri në dy vjet, nëse prezantohet shkak i arsyeshëm. Prokurori dhe policia juridike mund të veprojnë *sua sponte* ose sipas njoftimit⁶³.

Koha e hetimeve fillon që nga momenti i identifikimit të kundërvajtësit të mundshëm. Dëshmitë e marra pas skadimit të kohës për hetime nuk mund të shfrytëzohen nga ana e prokurorit.⁶⁴

⁶¹ Shiko Astolfo Di Amato “Itali” në Ekciklopedia Ndërkombëtare e Drejtësisë, Volumi 3, E drejta penale, Kluwer 2008 parag. 40 – 42.

⁶² Neni 107 i Kushtetutës Italiane

⁶³ 40. Neni 330, Kodi për procedurë penale, 1998.

⁶⁴ Neni 406, 407, Kodi për procedurë penale 1998

Prokurori është përgjegjës për grumbullimin e dëshmive. Prokurori mund të marrë nën pyetje personat e dyshuar, mund të pranojë deklaratat spontane, të marrë nën pyetje persona në lidhje me faktet, të kërkojë identifikimin, të kontrollojë persona dhe vende, të bëjë fotografi dhe të bëjë hetime teknike të bën autorizimin e ndërhyrjeve elektronike, nga *gip* dhe të zbatojë ndonjë kërkesë urgjente për bastisje të çastit.⁶⁵

Kur policia raporton një krim te prokurori, kompetencat kalojnë në mbikëqyrje të prokurorit. Prokuroria mund që të urdhërojë policinë që të zbatojë disa veprime hetimore përfshirë këtu pyetjen e të dyshuarve, dëshmitarëve dhe të dëmtuarve.⁶⁶ Megjithatë, policia në praktikë ka të drejtë diskrecioni të gjerë, ata kur bëjnë hetime *notitia criminis* dhe kur kryejnë hetime penale në vendngjarje, mund të veprojnë pa kontrollin e prokurorit. Në kushte normale, prokurori bën vetëm mbikëqyrje sipërfaqësore mbi hetimet policore, përveç se në rastet e mëdha ku prokurori në mënyrë aktive udhëheqë hetimet.⁶⁷ Shtrirja e kontrollit gjithashtu varet nga marrëdhënia e punës që kanë prokurori i posaçëm dhe polici hetues.

Prokurori mund të autorizojë policinë të kryejë punë të fshehtë, siç janë blerjet e kontrolluara të drogës në rastet e mëdha të trafikimit me drogë, krimin të organizuar dhe të terrorizmit.

3.3. Roli i gjykatësit të procedurës preliminare *giudice per le indagini preliminare (gip)*

Një rol të veçantë statusor në parashikimin e aktiviteteve të prokurorit dhe garantimin e të drejtave të personave nën hetime ka edhe *gip*.

Prokurori mund që të kërkojë nga *gip* që të kufizojë lirinë e personit. *Gip* mund që të lejojë përgjimin e telefonatave, paraburgimin, nën kërkesën e prokurorit gjithashtu mund të lejojë edhe ndërprerjen e hetimeve. Paraburgimi është normal për shumicën e krimeve të rënda, siç janë terrorizmi, krimi i organizuar, ose trafikimi me drogë të përmasave të mëdha edhe pse mund të aplikohet edhe paraburgimi shtëpiak. *Gip-i* mund të autorizojë marrjen në pyetje të një të dyshuari gjatë arrestit. Marrja në pyetje duhet patjetër të ndodhë brenda pesë ditëve, përndryshe i dyshuari do të lirohet.

⁶⁵ Neni 266, Kodi për procedurë penale 1998.

⁶⁶ Neni 267, Kodi për procedurë penale 1998.

⁶⁷ Giulio Illuminati dhe Michele Caianello "Faza hetimore e procesit penal në Itali" në Ed Cape, Jacqueline Hodgson, Ties Prakken dhe Taru Spronken (eds.) Të dyshuarit në Evropë: të drejtat procedurale në fazën hetimore të procesit penal në Unionin Evropian, Intersentia 2009, f. 134.

48

Prokurori mund të kërkojë një urdhëresë për përgjim të bisedave dhe telekomunikimeve për klasë të veçanta të kundërvajtjeve⁶⁸ dhe urdhëresa mund të bëhet nëse ekziston “indic serioz” për një kundërvajtje dhe se ndërhyrja është absolutisht e domosdoshme për hetimin.⁶⁹ Pragu është më i lartë se në çdo juridiksion tjetër evropian, përfshirë Anglinë, Uellsin dhe Bosnjë e Hercegovinën. Një ndërhyrje mund të zgjasë pesëmbëdhjetë ditë – afati kohor mund të zgjatet nga ana e *gip* edhe për periudha tjera kohore pesëmbëdhjetëditëshe nga ana e gjykatësit, në bazë të kërkesës së prokurorit.

Në raste urgjente, atëherë kur prokurori beson se zvarritja do ta paragjykojë hetimin, prokurori mund të fillojë ndërhyrjen dhe menjëherë (brenda 24 orëve) ia bën me dije gjykatësit i cili duhet të sjellë vendim brenda 48 orëve për miratimin e veprimeve të prokurorit. Nëse nuk miratohet, ndërhyrja duhet ndaluar dhe rezultatet nga ajo mund të mos shfrytëzohet.⁷⁰

Regjistrimet nga përgjimet i jepen prokurorit. Mbrojtja ka të drejtë të kryejë inspektim të regjistrimeve, të dëgjojë ndërhyrjet dhe të marrë shënime për rrjedhën e përgjimeve brenda një kohe të caktuar.⁷¹

3.4. Marrja në pyetje e personave të cilët janë nën hetime, të dyshuarve dhe të drejtat e tyre

Prokuroria mund që të detyrojë të dyshuarin, me një vërtetim të dërguar brenda afatit kohor deri tek avokati mbrojtës ose te avokati mbrojtës i emërtuar nga ana e gjykatës. Refuzimi për përgjigjen në pyetje do të dokumentohet në dosjen e çështjes. Nuk duhet të nxirren konkluzione të pafavorshme nga të heshturit. Edhe pse njoftimi i këshillit është i detyrueshëm, prania e tyre në marrje në pyetje nuk është e detyrueshme.

Policia po ashtu mund të ftojë dhe të marrë në pyetje dëshmitarët dhe të dyshuarin gjatë fazës hetimore, që do të thotë, para arrestimit apo paraburgimit. I dyshuari patjetër të jetë i pranishëm, por mund të heshtë. I dyshuari duhet patjetër të ketë një avokat të pranishëm gjatë marrjes në pyetje.⁷² Ftesa duhet patjetër të njoftojë të dyshuarin për faktet që kanë të bëjnë me hetimin. Intervista duhet, patjetër, të regjistrohet në formë me shkrim, dhe nëse i dyshuari është i arrestuar, duhet të ketë audio ose video- incizim.

⁶⁸ Neni 266, Kodi për procedurë penale 1998

⁶⁹ Neni 267, Kodi për procedurë penale 1998.

⁷⁰ Neni 267 Kodi për procedurë penale 1998.

⁷¹ Neni 268 Kodi për procedurë penale 1998.

⁷² Neni 364, Kodi për procedurë penale 1998.

⁷³ Neni 63, Kodi për procedurë penale 1998.

Personi në hetime ka të drejtë të informohet se është i dyshuar. Dëshmia vetinkriminuese e dhënë policisë apo prokurorit gjatë marrjes në pyetje por para se të paralajmërohet për rrezikun e vetinkriminimit nuk mund të përdoret kundër tyre, por mund të shfrytëzohet kundër të tjerëve. Në rast se nuk jepet paralajmërim deklarata e dhënë nuk mund të shfrytëzohet kundër askujt në kurrfarë seance gjyqësore penale.⁷³

Nga këndvështrimi i fazës hetimore kur i pandehuri mund të asistohet nga këshilli, prokurori mund të emërojë një *ex officio*, i cili do të veprojë deri sa ose nëse i pandehuri të njoftojë avokat privat.⁷⁴ Një i paraburgosur ka të drejtë absolute për të takuar avokatin e tij në çdo kohë edhe pse qasja për tek këshilli mund të shtyhet deri në pesë ditë gjatë fazës hetimore në veçanti, dhe në rrethana të jashtëzakonshme, siç janë frika e kalitjes së dëshmitë.⁷⁵ Deklaratat në të cilat parashihet vërejtja mund që të mos përdoren kundra një personi në gjykatë.⁷⁶

3.5. Mbarimi i hetimeve

Me mbarimin e hetimit preliminar, prokurori duhet të njoftojë të pandehurin se hetimi ka mbaruar. Atëherë bëhet zbardhja e plotë e dëshmitë dhe mbrojtja ka të drejtë të shqyrtojë dosjen e hetimit dhe të marrë kopje.⁷⁷

Prokurori mund të kërkojë nga *gip*-i ta anulojë rastin në bazë të asaj se është shumë i dobët për të kaluar në seancë gjyqësore ose të dërgojë atë për gjykim “një dënim penal me pagesë”, ose nëse dëshmitë janë tepër të forta atëherë mund që të kërkojë gjykim të menjëhershëm. Prokurori mundet që menjëherë të dërgojë rastin për gjykim për krimet të cilat parashohim dënime për më pak se katër vjet burgim.⁷⁸

Nëse prokurori kërkon dërgimin e rastit në gjykatë atëherë *gip* urdhëron që të ketë dëgjim preliminar *udienza preliminare*.

Prokurori duhet që të kërkojë nga *gip* që të anulojë rastin nëse nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të përdëftuar fajin, janë në konflikt ose nuk mund që të përdoren në gjykatë, ose në rastet kur i pandehuri nuk mundet që të gjendet. *Gip* mund që të aprovojë kërkesën dhe të kthejë rastin ose të mbajë dëgjimin ku do përfshijë prokurorin, personin nën hetime dhe avokatin mbrojtës dhe ndonjëherë nga palët e lënduara. Pasi që të ketë dëgjuar palët *gip* mund që të shkarkojë rastin, të bëjë vërejtje se duhet që të bëhen hetime të tjera, të regjistrojë ndonjë person tjetër

⁷⁴ Neni 369 bis, Kodi për procedurë penale 1998.

⁷⁵ Neni 104 (3) Kodi për procedurë penale 1998.

⁷⁶ Neni 63, Kodi për procedurë penale 1998.

⁷⁷ Neni 419 i Kodit të procedurës penale 1998.

⁷⁸ Neni 408, 416, 550, 459, 453 i Kodit të procedurës penale 1998.

si kryes i veprës, ose të urdhërojë prokurorin që të dërgojë një akt-akuzë për një afat kohor prej dhjetë ditëve.⁷⁹

Hetimi preliminar mund të anashkalohet nëse policia paraburgosë një preson *in flagrante* gjatë kryerjes së një krimi, brenda 48 orëve të arrestit, dërgon personin drejt para gjykatësit gjyqësor për “miratim”. Në rast se gjykatësi nuk e miraton arrestin, rasti ridërgohet te prokurori dhe nëse prokurori dhe mbrojtja bien dakord, vazhdon në seancë të përshpejtuar gjyqësore. Në rastet tjera prokurori mund ta kalojë atë në një seancë të përshpejtuar gjyqësore nëse arrestimi *in flagrante* është miratuar. I akuzuari atëherë sillet para gjyqit brenda pesëmbëdhjetë ditëve.⁸⁰ Procedurë e njëjtë mund të adoptohet nëse i akuzuari ka pranuar gjatë marrjes në pyetje.

3.6. Dëgjimi preliminar

Dëgjimi preliminar mbahet atëherë kur prokurori kërkon që të dërgohet një rast përpara këshillit të gjykatësve. Prokurori përmbledhë rezultatet e hetimit dhe diskuton nëse rasti duhet të dërgohet për gjykim. Dosja e rastit referohet tek gjykatësi i dëgjimit preliminar “*giudice per l’udienza preliminare*” (*gup*) që ai të vendosë nëse rastin duhet përcjellë në seancë gjyqësore. Dëgjimi preliminar mbahet dhe aty marrin pjesë palët. Prokurorët përmbledhin rezultatet e hetimit dhe bëjnë arsyetimin nëse rasti duhet të dërgohet për gjykim. Mbrojtja mund të sjellë prova të kundërta. I pandehuri mund të kërkojë të merret në pyetje sipas rregullave për pyetjen e dëshmitarit që aplikohen në gjyq, marrja në pyetje ka vlerë të plotë dëshmuese në seancën gjyqësore.⁸¹ Mbrojtja mund të paraqesë dëshmi gjatë dëgjimit preliminar. Ata mund të prezantojnë dëshmi shfajësuese duke u përpjekur të ndalojnë rastin që të dërgohet në seancë gjyqësore.

Prokurori mund që të kërkojë që *gup* të anulojë një rast nëse rasti është shumë i dobët për të vazhduar më tej me gjykimin,⁸² ai ka një detyrë pozitive të bëjë këtë nëse mendon në atë mënyrë. *Gup-i* vendosë vallë ka nevojë për informacion plotësues para vendosjes së rastit për seancë ose të anulim të tij. *Gup-i* mund ta anulojë rastin, por kjo nuk ndalon që ai të rihapet nëse zbulohen dëshmi të reja.⁸³

Gup-i ka një funksion të rëndësishëm në kryesimin me *incidente probatorio*, një mekanizëm i ngjashëm me depozitimim për ruajtjen e dëshmimeve. Prokurori ose personi në hetime mund të kërkojë që *gup-i* të pranojë depozitimim si dëshmi që mund të shfrytëzohet në seancë gjyqësore. *Incidente probatorio* përdoret në rastet kur ekzistojnë rrethana bindëse, si për shembull mbrojtja e dëshmitarëve nga lëndimet, sigurimi i dëshmisë nga dikush që është në prag të vdekjes. Mund që të mbahet nëse: (a) nëse

⁷⁹ Neni 409, 415, 550, 417, i Kodit të procedurës penale 1998.

⁸⁰ Neni 449 i Kodit të procedurës penale 1998.

⁸¹ Neni 514 i Kodit të procedurës penale 1998.

⁸² Neni 125 i Kodit të procedurës penale 1998.

⁸³ Neni 434 i Kodit të procedurës penale 1998.

është e arsyeshme që dëshmitari nuk do të mund të paraqitet përpara gjykatës për shkak të ndonjë sëmundjeje ose ndonjë shkakut tjetër serioz (b) kur ekziston arsye të besohet se personi në fjalë u nënshtrohet kërcënimeve, dhunës, ofron ose premtion shuma të larta parash ose përfitimeve të tjera për të dëshmuar ose për të mos dëshmuar në mënyrë të rrejshme (c) kur është e nevojshme që të pyetet i pandehuri si është përshkruar në faktet të përgjegjësisë së të tjerëve (ç) të pyesë ata të cilët janë akuzuar për krime të ndërlidhura me këta, (d) të caktojë konfrontim mes tyre që kanë deklarata kundërshtuese që të ndalojnë dëshmitë (dh) të marrin dëshmi nga ekspertët ose të zbatojnë eksperimente gjyqësore nëse një person, një send ose vend janë subjekt i ndryshimeve të pashmangshme dhe (e) të bëjë një identifikim i cili nuk mund që të bëhet në gjykatë.⁸⁴

3.7. Të drejtat e të pandehurit dhe hetimet e mbrojtjes

Kushtetuta Italiane jep të drejtën e mbrojtjes, e cila përfshin kohë të mjaftueshme dhe kushte adekuate për përgatitjen e mbrojtjes dhe të drejtës në avokat mbrojtës.⁸⁵

Avokati mbrojtës në sistemin Italian ka një rol shumë më aktiv në fazën hetimore se sa në sistemin e të drejtës zakonore. Gjatë fazës preliminare, mbrojtja gjithashtu mund që të ndërmarrë hetime, ky proces duhet që të jetë i barabartë me hetimet e prokurorisë. Sidoqoftë, nuk përdoret shumë nga ana e avokatëve mbrojtës. Shënimet mbi hetimet e mbrojtjes mund që të prezantohen në secilën fazë të procedurës dhe ju jepet e njëjtë peshë sikurse edhe dëshmitë të nxjerra nga ana e prokurorisë.⁸⁶ Mbrojtja mund që të kontaktojë dëshmitarë të mundshëm dhe nëse një person refuzon që të japë deklaratë, mbrojtja mund që të kërkojë nga prokuroria ose *gip* që të thërrasë personin në fjalë për pyetje. Nëse dëshmitari i mundshëm pranon që të flasë me avokatin mbrojtës mund që të bëhet një deklaratë me shkrim ose pyetjet të incizuara. Nga ana e avokatit mbrojtës këta do të dërgohen deri te *gip*.

I pandehuri dhe avokati mbrojtës munden, po ashtu, të kërkojnë autorizim nga *gip-i* për qasje në pronat private. Mund të mbahen shënime për çdo qasje të tillë të siguruar dhe, ato mund të paraqiten si dëshmi në seancën gjyqësore. Sido që të jetë mbrojtja nuk ka të drejtë të kërkojë urdhra për përgjim nga *gip* gjatë hetimeve.

Përkundër ndarjes së posteve gjyqësore dhe hetuese të cilat u sollën si risi në vitin 1988 kritikant kanë vërejtur një shkallë të lartë të pranimit nga ana e *gip* dhe *gup* në kërkesën e prokurorit për paraburgim, përgjimin e telefonatave dhe dorëzimin për gjykime.⁸⁷

⁸⁴ Neni 392 i Kodit të procedurës penale 1998.

⁸⁵ Neni 24 dhe 111 i Kushtetutës Italiane

⁸⁶ Neni 327 bis Kodit të procedurës penale.

⁸⁷ Për shembull, Elisabetta Grande, "E drejta penale: Rezistenca e një Mentaliteti" në Jeffrey S.Lena dhe Ugo Mattei (Eds) Hyrje në Ligjin Italian 2002 Kluëer, f.191.

4. BOSNJA E HERCEGOVINA

4.1. Hyrje

Reformat e mëdha në sistemin e drejtësisë penale të vitit 2003 vendosën rolin e prokurorit në hetime dhe në ndjekje penale të krimeve. Reformat anuluan zyrën e gjykatësit hetues, duke i dhënë përgjegjësitë Zyrës së Prokurorit për të kryer hetimet e kundërvajtjeve brenda juridiksionit të Gjykatës së Bosnjë e Hercegovinës.

Kapitulli i VI i Kodit për Procedurë Penale, të vitit 2003, thekson rolin e Prokurorit. Sistemi nuk ka gjykatës hetues, në vend të tij prokurori mund t'i marrë punët e gjykatësit para procesit të dëgjimit gjyqësor, të njohur si gjykatës i seancave preliminare, për procedurat e para-padisë, siç është arresti, urdhëresa për bastisje, kërkesat për urdhra për ndërhyrje dhe paraburgimi i të dyshuarve gjatë hetimit.

Të drejtat dhe detyrat e prokurorit janë të definuar si “zbulimi dhe ndjekja penale e autorëve të veprave penale që bien në juridiksion të gjykatës⁸⁸”.

Prokurori, duke qenë i vetëdijshëm për bazat e dyshimit se një vepër penale është kryer, duhet, patjetër, t'i ndërmerret hapat e nevojshëm për të zbuluar, hetuar dhe për t'i identifikuar të dyshuarit, të udhëheqë dhe të mbikëqyrë hetimin dhe të udhëzojë zyrtarët e autorizuar se si duhet identifikuar të dyshuarit. Prokurori, gjithashtu, mund të sigurojë imunitet,⁸⁹ të lëshojë ftesë dhe urdhëresa, të urdhërojë zyrtarët e autorizuar t'i zbatojnë urdhrat gjyqësore, të vendosë për fakte të nevojshme, siç janë kërkesat për pronë dhe për konfiskim.

Në praktikë, Prokurori punon me Agjencinë shtetërore për hetime dhe mbrojtje (ASHM) për të kryer këto detyra, ose mund të bëjë delegimin e detyrave të ndryshme në mbikëqyrje të ASHM-së. Hetuesit të cilët mund të jenë policë ose avokatë që janë të punësuar në Zyrën e Prokurorit për të ndihmuar prokurorët për të hetuar.

Detyrat përfshijnë grumbullimin e dëshmive, dhënien e imuniteteve, kërkimin e informacionit nga autoritetet, lëshimin e ftesave dhe urdhëresave, urdhërimin e zyrtarëve të kryejnë detyrat e parapara, përpilimin e kërkesave për prona dhe lëshimin e padive penale. Në praktikë, Prokurori kryen intervistat me të dyshuarit, për shembull, gjatë realizimit të urdhëresës për bastisje.

Neni 14 i Kodit për procedurë penale: “Barazia e armëve” siguron gjykatën se duhet t'i trajtojë të gjitha palët dhe avokatin mbrojtës në mënyrë të barabartë dhe të sigurojë për secilin mundësi të barabarta për qasje te dëshmitë dhe t'i prezantojë

⁸⁸ Neni 35, Kodi për procedurë penale 2003.

⁸⁹ Vetëm se kryeprokurori mund që të japë imunitet

dëshmitë në seancën kryesore. Ai, po ashtu, siguron se Prokurori dhe trupat e tjerë pjesëmarrës, duhet patjetër të studiojnë dhe të vendosin me vëmendje të njëjtë faktet të cilat janë shfajësuese si edhe fajësuese për të dyshuarin e akuzuar.

Janë shprehur brenga serioze për Gjykatën e Bosnjë e Hercegovinës për deficit të financimit lidhur me hetimet e mbrojtjes të cilat janë kërkuar që nga viti 2003, që si gjykatë hetimore nuk i kryen dhe nuk e luan më këtë rol.⁹⁰

4.2. Paraburgimi gjyqësor

Kodi për procedurë penale autorizon gjerësisht paraburgimin paragjyqësor të një të dyshuari pa akuzë. Në rrethana specifike ku ekziston “dyshimi i bazuar” se një person ka kryer një kundërvajtje (frikë nga fluturimi, dëshmitar ose ngatërrim të dëshmitave, frikë nga kryerja e veprave tjera, lirim me dorëzani (kaucion) duke shkaktuar shqetësim në rendin publik në aspekt të krimeve që marrin dënime me më shumë se dhjetë vjet) gjykatësi i seancës preliminare mund të japë urdhër për paraburgimin e të dyshuarit në kohëzgjatje një muaj. Një panel rishqyrtimi i përbërë nga tre gjykatës mund të zgjasin këtë edhe për dy muaj tjerë. Ai mund të zgjatet për tre muaj në rastet e dënueshme me dhjetë vjet burgim, nëse ekzistojnë “arsye posaçërisht të rëndësishme”. Zgjatje prej tre muajve të tjerë mund të urdhërohet edhe dy herë për qëllim të përfundimit të hetimit në rrethanat e kombinuara të veçanta kur bëhet fjalë për mundësi të një dënimi për më shumë se 20 vjet dhe për “rast jashtëzakonisht kompleks”. Personi duhet të lirohet me skadimin e cilës do periudhë kohore nëse nuk konfirmohet kurrfarë padie penale. Lejohet apelimi në secilën fazë.⁹¹ Kështu një person mund të paraburgoset për dymbëdhjetë muaj pa akuzë gjatë kohës së hetimit (në bazë të asaj që shkruhet në statut).

4.3. Roli i prokurorit

Prokurori duhet të japë urdhër për hetim nëse ekziston bazë për dyshim se një vepër kriminale është kryer. Prokurori duhet të cekë hapat e nevojshëm të hetimit. Në rast se prokurori nuk vendosë të japë urdhër për hetime, për shembull nëse statuti i kufizimeve ka skaduar apo është evidente se nuk është kryer kurrfarë veprave penale, pala e prekur dhe personi i cili raporton veprën duhet të njoftohen brenda tre ditëve të marrjes së vendimit.⁹²

“Zyrtarët e autorizuar” sipas Kodit (kryesisht zyrtarët e forcave policore duhet të njoftojnë prokurorin nëse ekzistojnë baza për dyshim të kryerjes së veprës penale për të cilën parashihet dënim me burg mbi pesë vjet. Nën udhëheqje të prokurorit zyrtari duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për gjetjen e kundërvajtësit dhe të

⁹⁰ Shih p.sh. Bogdan Ivanisheviq, Dhoma për Krime Luftë në Bosnje e Hercegovinë: Nga Gjykata Hibride tek ajo Vendore (2008), Qendra Ndërkombëtare për të Drejtën Transitore, f. 17.

⁹¹ Neni 131, Kodi për procedurë penale 2003.

⁹² Neni 216, Kodi për procedurë penale 2003.

54

grumbullojë dëshmi në lidhje me veprën e kryer. Zyrtari mund të veprojë pa njoftuar prokurorin, në rast se zvarritja në kohë do të ishte e rrezikshme.⁹³ Prokurorët dhe hetuesit të punësuar nga Zyra e Prokurorëve gjithashtu konsiderohen si “zyrtarë të autorizuar”⁹⁴.

Prokurori është i autorizuar për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore, siç është marrja në pyetje e të dyshuarit, të palës së prekur dhe të dëshmitarëve, kryerja e hetimeve të vendit të krimit dhe rikonstruksioni i rastit, mbrojtja e dëshmitarëve dhe e informacioneve, si dhe marrja e asistencës nga ekspertët. Prokurori mund të urdhërojë mbajtjen e të dyshuarit nën arrest për ta marrë atë në pyetje, por duhet ta njoftojë gjykatësin e gjykimit preliminar.⁹⁵

Prokurorët ose hetuesit mund të ndërmarrin hapa hetimi siç janë kryerja e bastisjeve dhe sekuestrimi, si dhe marrja e deklaratave. Gjykata mund të lëshojë urdhër për bastisje në bazë të kërkesës së bërë nga prokurori.⁹⁶

Ata gjithashtu mund të dërgojnë kërkesë me shkrim një personi për t'u paraqitur dhe për të marrë deklaratën, por personi nuk është i detyruar të japë deklaratë të tillë. I dyshuari duhet, patjetër, të informohet për të drejtat e tij/të saj siç janë e drejta për tu mbrojtur me heshtje, për avokat, për përkthyes, dhe se deklarata mund të shfrytëzohet kundër personit në seancën gjyqësore dhe për akuzën dhe për bazat e akuzës.⁹⁷ Gjatë marrjes në pyetje dëshmitari duhet të përgjigjet me gojë dhe “Pas pyetjeve të përgjithshme ftohet të paraqesë çdo gjë që e di në lidhje me rastin, ndërsa më vonë i parashtrihen pyetje që kanë për qëllim kontrollimin, plotësimin dhe shpjegimin e deklaratës. Gjatë dëgjimit të dëshmitarit ndalohet ushtrimi i mashtrimit ose parashtrimit i pyetjeve të cilat veç më përbëjnë përgjigjen e dëshiruar” dhe “Dëshmitari duhet të pyetet prej nga i di faktet për të cilat ai po dëshmon”.⁹⁸

Prokurori ose gjyqi mund të ftojë një dëshmitar që të paraqitet për t'u marrë në pyetje: në bazë të kërkesës së prokurorit gjyqi mund të gjobitë një dëshmitar për mosparaqitje në gjyq pa arsye të vërtetë.⁹⁹

Një i dyshuar nën hetime duhet të merret në pyetje nga ana e prokurorit ose zyrtarit të autorizuar. Përdorimi i “forcës, kërcënimit, mashtrimit, narkotikëve dhe i mjeteve tjera që mund të ndikojnë në lirinë e vendimmarrjes dhe të shprehurit të vullnetit gjatë dhënies së deklaratës ose rrëfimit” është e ndaluar dhe një deklaratë të këtillë do të llogaritet si e pavlefshme për në gjykatë¹⁰⁰. Duhet mbajtur

⁹³ Neni 218, Kodi për procedurë penale 2003

⁹⁴ Neni 20 (g), Kodi për procedurë penale 2003

⁹⁵ Neni 217, Kodi për procedurë penale 2003

⁹⁶ Neni 53, Kodi për procedurë penale 2003

⁹⁷ Neni 219 (3), 78 dhe 86 i Kodi për procedurë penale 2003

⁹⁸ Neni 86 (7), dhe 8 Kodi për procedurë penale 2003

⁹⁹ Neni 81) Kodi për procedurë penale 2003

¹⁰⁰ Neni 77 Kodi për procedurë penale 2003

shënime për marrjen në pyetje të dyshuarit dhe “Pjesët e rëndësishme të deklaratës duhet futur në regjistër fjalë për fjalë”, dhe sipas rregullës ato duhet të regjistrohen në audio dhe video.¹⁰¹

Një aktpadi nuk mund të lëshohet pa u bërë pyetja e të dyshuarit.¹⁰² Kjo është në kundërshtim me sistemet e të drejtës zakonore sipas të cilëve nuk është e domosdoshme marrja në pyetje e të dyshuarve para shpalljes së padisë. Kuptohet se i dyshuari mund të realizojë të drejtën për të heshtur gjatë marrjes në pyetje.

Zyrtari i autorizuar duhet të kompletojë raportin penal për prokurorin, i cili përmban deklaratat dhe dëshmitë e grumbulluara gjatë hetimit.

Me përfundimin e hetimit prokurori mund ta përbyll hetimin ose të vendosë të sjellë akuzë duke dorëzuar padinë në gjykatë. Hetimi mund të mbyllet nëse vepra nuk është kundërvajtje penale, i dyshuari është i paaftë në bazë psikike, nëse periudha kohore e kufizuar ka skaduar, ose pengesa tjera që pengojnë ndjekjen penale. Nëse hetimi nuk është përbyllur brenda gjashtë muajve, Kolegji i Zyrës së Prokurorit duhet të ndërmerr masa të nevojshme për kompletim të tij.¹⁰³

Prokurori lëshon padi dhe dëshmi të cilat mbështesin akuzat deri në gjykatë. Gjykatësi i seancës preliminare pastaj e konfirmon padinë ose liron disa ose të gjitha akuzat apo paditë.¹⁰⁴

Pasi të lëshohet padia palët ose avokati mbrojtës mund të kërkojë nga gjykatësi për dëgjim preliminar për të kryer një dëgjim special për të marrë dëshmi nga një dëshmitar të paaftë për të dëshmuar në seancën kryesore, ose të ndërmerr hapat e nevojshëm për mbrojtjen e dëshmitëve të cilat mund të mos jenë në dispozicion në seancën gjyqësore.¹⁰⁵

4.4. Roli i mbrojtjes në fazën hetimore

Neni 47 parasheh të drejtën statusore të avokatit mbrojtës për t'i shqyrtuar dosjet dhe dëshmitë në favor të të dyshuarit gjatë hetimit, përveç rasteve kur zbardhja e dosjeve dhe e provave gjatë marrjes në pyetje do ta rrezikonte qëllimin e hetimit. Pas padisë avokati mbrojtës dhe i dyshuari ose i akuzuari mund t'i shqyrtojnë dhe t'i kopjojnë dosjet dhe dëshmitë.

Pas lëshimit të aktpadisë, avokati mbrojtës mund që të kontrollojë kopjen e të gjithë dosjes dhe dëshmitëve. Sidoqoftë, avokatët mbrojtës në praktikë ballafaqohen me shumë pengesa gjatë përgatitjes të mbrojtjes së tyre, për shkak të deficitit në

¹⁰¹. Neni 79 Kodi për procedurë penale 2003

¹⁰². Neni 225 (3) Kodi për procedurë penale 2003

¹⁰³. Neni 224 dhe 225 Kodi për procedurë penale 2003

¹⁰⁴. Neni 228 Kodi për procedurë penale 2003

¹⁰⁵. Neni 226 (5) Kodi për procedurë penale 2003

zbulimet publike dhe mos pasja e përvojës. Për arsye se me reformat e reja po mënjahet gjykatësi hetues dhe po vendoset sistemi i ri gjyqësor kundërshtues, avokatët mbrojtës nuk kanë shumë përvojë gjatë zhvillimeve të strategjive të tyre adekuatë gjatë fazës së hetimeve.

5. GJYKATAT DHE TRIBUNALËT NDËRKOMBËTARE PENALE

5.1. Hyrje dhe pasqyrim

Në gjykatat dhe tribunalët ndërkombëtare palët janë përgjegjëse për kryerjen e hetimeve të tyre. (Përjashtim nga kjo është Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat në Kamboxhia (DhJGJK) ku gjykatësit hetues kryen hetimin). Institucionet e tjera ndërkombëtare dallojnë në atë se sa në mënyrë aktive janë të involvuara Dhomat në proceset hetuese.

Në Gjykatën Ndërkombëtare për Krime (GjNK) dhe tribunalet ndërkombëtare *ad hoc* dhe hibride prokurori është plotësisht në krye të hetimeve. Hetimet janë në duar të avokatëve të cilët udhëhiqen nga ekupe multidisiplinore të avokatëve, të hetuesve, të analistëve dhe të kuadrit tjetër relevant e të kualifikuar. GjNK-ja dhe Tribunali Special i Libanit (TSL) mund t'ia përcjellin juridiksionit shtetëror disa detyra hetuesie .

Prokurori i secilit institucion është përgjegjës për grumbullimin e dëshmive përfshirë edhe marrjen në pyetje të viktimave, të dëshmitarëve, të ekspertëve, të të dyshuarve dhe të personave të akuzuar.

Në GjNK viktimat kanë të drejtë të marrin pjesë në seancat gjyqësore gjatë hetimeve, ndërsa në TSL viktimat nuk kanë të drejtë të marrin pjesë deri sa të bëhet konfirmimi i padisë.

TNKJ-ja (Tribunali Ndërkombëtar për Krime në Ish Jugosllavi) dhe TNKR-ja (Tribunali Ndërkombëtar për Krime në Ruanda) nuk u jep kurrfarë roli statusor viktimave gjatë hetimeve.

Statuti i TSL-së është nën ndikim të ligjit Libanez i cili gjykatësit paragjyqësor i jep një rol aktiv e sidomos në fushën e grumbullimit të dëshmive. Gjykatësi mund të lëshojë urdhra ose urdhëresa për arrestim, për grumbullimin e dëshmive të caktuara, ose sipas kërkesës nga Pala ose nga viktimat-pjesëmarrëse, ose *proprio motu*. Gjykatësit paragjyqësorë po ashtu i është besuar marrja e disa dëshmive siç është rasti prej “dëshmitarëve anonim”.

Një numër i principeve të përgjithshme aplikohen në tribunalët dhe gjykatat ndërkombëtare, fjala vjen: prokurori mund të marrë në pyetje të dyshuarit dhe personat e akuzuar, i dyshuari ose i akuzuari kanë të drejtën në heshtje, të drejtën për asistencë juridike gjatë intervistimit, si dhe të drejtën për të qenë mjaft të informuar. E drejta për avokat mund të refuzohet vullnetarisht. Nga heshtja nuk mund të nxirret asnjë konkluzion i pafavorshëm. Ndalohet përdorimi i sjelljes me presion. I akuzuari duhet të informohet për natyrën e akuzave para se të merret në pyetje. Interpretimi i lirë është një e drejtë. Intervista duhet të regjistrohet me audio dhe video. I dyshuari ose i akuzuari duhet të paralajmërohen se çdo gjë e thënë mund të përdoret kundër tyre.

Gjatë kryerjes thelbësore të së njëjtit funksion në grumbullimin e dëshmimeve për krime në korniza të juridiksioneve përkatëse, rolet dhe detyrat e Prokurorëve të GjNK-së dhe të TNKJ-së janë të shprehura mjaft ndryshe. Statuti dhe Rregullorja e GjNK-së janë rezultat i negociatave të gjera dhe të detajuara për marrëveshje duke përfshirë shumë shtete dhe organizata, për më shumë vite, ndërsa Statuti i TNKJ-së ishte shpallur nga Këshilli i Sigurimit duke shkuar në përputhje me Kaptinën VII të Kartës së KB-së në vitin 1993. Statuti dhe Rregullorja e GjNK-së më shumë janë pasqyrim i përzjerjes së filozofive kundërshtuese dhe inkuizitore dhe ngarkojnë Prokurorin e GjNK-së me detyrë pozitive të kërkimit të së vërtetës dhe për të “hetuar rrethana inkriminuese dhe shfajësuese në mënyrë të barabartë”. Prokurori i TNKJ-së nuk ka obligime të tilla.

5.2. Tribunali Ndërkombëtar për Krime në ish Jugosllavi

Statutit i TNKJ-së parasheh që “Prokurori është përgjegjës për hetime dhe ndjekje penale të personave përgjegjës për shkeljet e rënda të ligjeve humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e ish Jugosllavisë deri më 1 janar 1991”.¹⁰⁶ Sipas statutit “Prokurori duhet të iniciojë hetimet *ex-officio* ose në bazë të informacioneve të fituara nga burimet, në veçanti nga Qeveritë, organet e Kombeve të Bashkuara, organizatave ndërqeveritare dhe joqeveritare. Prokurori duhet të vlerësojë informacionin e pranuar ose të fituar dhe të vendosë vallë ekziston bazë e mjaftueshme për të ngritur padi.” Dhe “Prokurori duhet të ketë kompetencë të marrë në pyetje të dyshuarit, viktimat dhe dëshmitarët, të grumbullojë dëshmi dhe të kryejë hetime në vendngjarje. Gjatë kryerjes së këtyre detyrave, Prokurori mundet, nëse është e përshtatshme, të kërkojë asistencë nga autoritetet shtetërore”¹⁰⁷.

Një i dyshuar ka të drejtë “të ndihmohet nga një avokat sipas zgjedhjes së tij, përfshirë këtu edhe të drejtën për të pasur asistencë juridike të caktuar pa pagesë

¹⁰⁶. Neni 16 i Statutit të TNKJ

¹⁰⁷. Neni 18 (1) i Statutit të TNKJ

në çfarëdo rasti, si edhe për përkthim të nevojshëm në gjuhën dhe prej gjuhës të cilën e flet dhe e kupton”¹⁰⁸.

Hetimi përkufizohet me “të gjitha aktivitetet të ndërmarra nga ana e Prokurorit ... për grumbullimin e informacionit dhe dëshmime” si para, ashtu edhe pas konfirmimit të padisë. Ato parashohin se Prokurori është përgjegjës për të ftuar dhe për marrjen në pyetje të të dyshuarve, të viktimave dhe dëshmitarëve, për incizimin e deklaratave të tyre dhe për kryerjen e hetimeve në vendngjarje¹⁰⁹.

Prokurori mund të ndërmerr hapa tjerë të nevojshëm, përfshirë edhe ndërmarrjen e hapave specialë për mbrojtjen e dëshmitarit, kërkimin e asistencës prej cilitdo autoritet shtetëror ose organ relevant ndërkombëtar, siç është INTERPOL-i dhe të kërkojë urdhëresat e nevojshme nga gjykatësi¹¹⁰. Urdhëresa për bastisje është një shembull nga urdhëresat në fjalë.

Në raste urgjente prokurori mund të kërkojë që shteti të arrestojë, përkohësisht, një të dyshuar ose të akuzuar, të sekuestrojë dëshmi materiale, të parandalojë ikjen e të dyshuarit apo e të akuzuarit, lëndimin ose ngacmimin e viktimës ose të dëshmitarit, si dhe shkatërrimin e çfarëdo dëshmie.¹¹¹

Prokurorin është i obliguar që të informojë të dyshuarin, para marrjes në pyetje, për të drejtën për asistencë juridike, përkthim dhe për mbrojtjen me heshtje. I dyshuari mund të refuzojë të drejtën për avokat. Marrja në pyetje duhet patjetër të incizohet me audio¹¹². Pranimi faji i dhënë nga ana e të pandehurit supozohet se është dhënë në mënyrë vullnetare, përveç se nëse vërtetohet që të jetë e kundërta.¹¹³ Prokurori, gjithashtu, është përgjegjës për ruajtjen dhe deponimin e dëshmime në TNKJ.¹¹⁴ Prokurori ka obligime të gjera për zbardhjen me kohë të dëshmime që do të përdoren në seancë dhe për obligimet për zbardhjet në rrjedhë e sipër në aspekt të materialit shfajësues. Mund të parashihen sanksione për thyerje të obligimeve për zbardhje.¹¹⁵

Rregullat e TNKJ-së lejojnë marrjen e depozitimeve sipas kërkesës së palës ose *propio motu* për përdorim në seancë, në rast se depozituesi mundet ose nuk mundet të paraqitet fizikisht në Tribunal për të dhënë dëshmi.¹¹⁶ Për dallim nga Statuti i GJNK-së dhe Kodit për Procedurë Penale të Italisë dhe të Bosnjë e Hercegovinës kjo procedurë nuk kufizohet me dëshmi e cila nuk duhet të jetë në dispozicion në seancë, por mund të urdhërohet për të “në interes të së drejtës”.

¹⁰⁸. Neni 18 (3) i Statutit të TNKJ

¹⁰⁹. Rregulla 2 nga Rregullat e TNKJ-së për procedurë dhe dëshmi

¹¹⁰. Rregulla 39 i nga Rregullat e TNKJ-së për procedurë dhe dëshmi

¹¹¹. Rregulla 40 i nga Rregullat e TNKJ-së për procedurë dhe dëshmi

¹¹². Rregulla 42 dhe 43 nga Rregullat e TNKJ-së për procedurë dhe dëshmi

¹¹³. Rregulla 92 nga Rregullat e TNKJ-së për procedurë dhe dëshmi

¹¹⁴. Rregulla 41 nga Rregullat e TNKJ-së për procedurë dhe dëshmi

¹¹⁵. Rregulla 66 deri te 70 nga Rregullat e TNKJ-së për procedurë dhe dëshmi

¹¹⁶. Rregulla 71 nga Rregullat e TNKJ-së për procedurë dhe dëshmi

Neni 18 (4) parasheh “Në bazë të vendimit se ekziston rasti *prima facie*, Prokurori të përgatisë padinë e cila përmban një deklaratë të përpiktë për faktet dhe për krimin ose krimet me të cilët i akuzuari do të akuzohet sipas këtij Statuti. Padia duhet të transmetohet tek Gjykatësi i dhomës për proces gjyqësor”. Pastaj një gjykatës tjetër bën shqyrtimin e padisë për të konfirmuar vallë plotësohet ekzistimi i rastit *prima facie*, e nëse nuk plotësohet, atëherë ai e anulon atë¹¹⁷.

5.3. II Gjykata Ndërkombëtare për Krime

Prokurori i GjNK-së fillon një hetim në “një situatë” sipas referimit të Këshillit të Sigurimit, sipas Palës Shtetërore (në Gjykatë) ose *proprio motu*. Për të iniciuar një hetim prokurori duhet të ketë informacion që të ketë bazë të arsyeshme për të besuar se është kryer një krim në kornizat e juridiksionit të Gjykatës dhe, se rasti do të jetë i pranueshëm sipas Statutit¹¹⁸.

Zyra e Prokurorit si “përgjegjëse për pranimin e referimeve dhe çfarëdo informacioni thelbësor për krime brenda juridiksionit të Gjykatës, për marrjen në pyetje, për kryerjen e hetimeve dhe për ndjekjen penale para Gjyqit”.¹¹⁹

Statuti bën përkufizimin e detyrave dhe të kompetencave të Prokurorit në mënyrë të qartë.

“Me qëllim që të vërtetimit të së vërtetës, të shtrijë hetimin dhe të përfshijë të gjitha faktet dhe dëshmitë relevante për një vlerësim të asaj se vallë ekziston përgjegjësi penale sipas këtij Statuti dhe, duke bërë këtë, të kryejë hetim të barabartë të rrethanave inkriminuese dhe shfajësuese. Të ndërmer masa të përshtatshme për sigurimin efektiv të hetimit dhe të ndjekjes penale të krimeve në kuadër të juridiksionit të gjykatës ... dhe plotësisht të respekton të drejtat e personave që dalin nga ky Statut.”¹²⁰

Prokurori ka autorizim për grumbullimin dhe shqyrtimin e dëshmimeve, të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të personave në hetime, të viktimave dhe dëshmitarëve, të kërkojë bashkëpunim prej shtetit ose organizatave ndërmministrorë, të hyjë në marrëveshje për lehtësim të bashkëpunimit, të merret vesh për moszbardhje të dokumentacionit ose informacionit të fituar në kushte të fshehtësisë dhe, vetëm se për qëllim të nxjerrjes së dëshmimeve të reja, kur dhënësi i informacionit jep pëlqimin. Ai duhet të kërkojë marrjen e masave të nevojshme për fshehtësinë e informacionit, mbrojtjen e cilitdo person ose ruajtjen e dëshmimeve.

Personi ka të drejtë të jetë i informuar para marrjes në pyetje se ka kryer krimin që bie nën juridiksionin e gjykatës, se ka drejtë për të heshtur dhe të merret në

¹¹⁷. Neni 19 i TNKJ

¹¹⁸. Neni 53 (1) i GJNK

¹¹⁹. Neni 42 i GJNK

¹²⁰. Neni 54 (1) (a) i GJNK

pyetje në praninë e avokatit, përveç se në mënyrë vullnetare refuzon të drejtën për avokat¹²¹.

Dhoma paragjyqësore ka një rol të rëndësishëm gjatë hetimit për “mundësi unike të hetimit” në asistimin e Prokurorit dhe të mbrojtjes¹²². “Mundësia unike e hetimit” është e ngjashme me procedurat që i përdorin gjykatat në Itali dhe në Bosnje e Hercegovinë për ruajtjen e dëshmive dhe mbajtjen e dëgjimeve të mundshme speciale apo atyreve depozituese.

Prokurori duhet ta informojë dhomën nëse hetuesia paraqet “situatë unike hetimore për të marrë dëshmi ose deklarata ose të ekzaminojë, të mbledhë ose testojë dëshmitë, të cilat mund të mos jenë të kapshme për qëllimet e gjykimit”¹²³. Dhoma mund të marrë masa të këtilla si të nevojshme për sigurimin e efikasitetit dhe integritetit të masave dhe për mbrojtjen e të drejtave të mbrojtjes. Kjo mund të përfshijë dëgjimin dhe marrjen e veprimeve të nevojshme për ruajtjen e dëshmive.

Dhoma Paragjyqësore ka një rol të rëndësishëm në fazën hetimore. Kjo përfshinë: lëshimin e urdhrave ose urdhëresave sipas kërkesës së Prokurorit, sigurimin e mbrojtjes dhe intimitetit të viktimave, mbrojtjen e të arrestuarve dhe të ftuarve, si dhe mbrojtjen e informacionit për siguri shtetërore¹²⁴. Është me rëndësi që kjo dhomë, po ashtu, me kërkesë të personit të arrestuar ose të ftuar të paraqitet, të lëshojë urdhër i cili është i aplikueshëm në, ose të kërkojë bashkëpunim ndërkombëtar që mund të jetë i nevojshëm për asistim të personit për përgatitjen e mbrojtjes së vet. Përveç kësaj, ajo mund¹²⁵:

”Të autorizojë Prokurorin për të ndërmarrë hapa të posaçëm hetues brenda territorit të shtetit të palës pa pasur bashkëpunim të siguruar me shtetin..., që kur do që të jetë e mundshme të ketë konsideratë për pikëpamjet e shtetit përkatës. Dhoma Paragjyqësore vërteton rastin kur shteti është i paaftë të zbatojë një kërkesë një kërkesë të tillë për shkak se nuk ka në dispozicion asnjë autoritet të sistemit gjyqësor kompetentë për zbatim të kërkesës për bashkëpunim...”

Për dallim nga TNKJ-ja, GjNK-ja ka dhomë paragjyqësore e angazhuar për kryerjen e dëgjimeve për konfirmimin e padisë.

5.4. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut garanton disa të drejta të veçanta sa i përket personave të dyshuar dhe atyre që janë në arrest policie. Konventa

¹²¹. Neni 55 i Statutit të GJNK

¹²². Neni 56 dhe 57 i Statutit të GJNK

¹²³. Rregulla 40 nga Rregullat e TNKJ-së për procedurë dhe dëshmi

¹²⁴. Neni 57 (3) i Statutit të GJNK

¹²⁵. Neni 57 (3) (d) i Statutit të GJNK

VEPRIMET HETIMORE - DORACAK PËR PROFESIONISTËT 61

Evropiane për të Drejtat e Njeriut përmban disa garanci relevante për fazën hetimore, në veçanti në nenet 5 dhe 6.

Neni 5 – në të drejtat për liri dhe siguri të personit – parasheh të drejta të rëndësishme për të arrestuarit nën dyshimin se kanë kryer kundërvajtje. Neni 5 (1) (c) parasheh se

“askujt nuk duhet t’i mohohet sigurimi i lirisë në rastet në vijim dhe në përputhje me një procedurë të përshtuar me ligj:

arrestimi ose paraburgimi i ligjshëm i një personi i bërë për qëllim të sjelljes para autoritetit kompetent ligjor nën dyshimin e arsyeshëm se ka kryer kundërvajtje ose kur konsiderohet me arsye të parandalohet kjo kundërvajtje me të ikur pasi të ketë vepruar ashtu.”

Një dyshim duhet gjithmonë të ketë pikëmbështetje të vërtetë, dhe Gjykata Evropiane ka gjetur raste të shkeljeve kur bazat për arrestim nuk kanë ekzistuar¹²⁶.

Ky nen nuk e rregullon mënyrën e marrjes në pyetje e të dyshuarve nën arrest policor, por neni 5 (2) ngarkon shtetin me obligime të caktuara. Personi i arrestuar “duhet të informohet me përpikëri në gjuhën të cilën e kupton, për arsyet e arrestimit dhe për ndonjë akuzë kundër tij”. Personi i arrestuar ka të drejtë të dijë arsyen, duke i lejuar personit të mohojë krimin dhe të kërkojë lirim pa u drejtuar në seancë gjyqësore¹²⁷. Personi duhet të informohet për këto “brenda disa orëve të arrestimit të tij”.¹²⁸

Neni 5 (3) parasheh se:

“Çdonjëri i arrestuar ose i paraburgosur në pajtim me dispozitat e paragrafit 1.c të këtij neni duhet të dërgohet me shpejtësi para gjykatësit ose para zyrtarit tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar autoritet gjyqësor dhe duhet t’i jepet e drejta për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm ose të lirohet në pritje të gjyqimit. Lirimi mund të kushtëzohet me garanci për t’u paraqitur në gjykim.”

Neni 5 (4) garanton se:

“Secilit që iu është hequr liria me arrestim apo me paraburgim duhet t’i jepet e drejta për seancë gjyqësore me të cilën nga ana e gjyqit me shpejtësi vendoset ligjshmëria e paraburgimit të tij dhe urdhërohet lirimi i tij nëse paraburgimi nuk është i ligjshëm”.

Me të vërtetuar se personi është objekt i “akuzës penale”, do të aplikohen të gjitha garancitë e nenit 6. Gjykata përkufizon “akuzën” si “njoftim oficial të dhënë një individ nga ana e autoritetit kompetent për një deklaram se ai është i dyshuar për kryerjen a

¹²⁶. Për shembull, Steel kundër Britanisë së Madhe 23 shtator 1998, 1998-VII.

¹²⁷. Fox, Campbell dhe Hartley kundër Britanisë së Madhe A-182 (1990) para. 40.

¹²⁸. Murray kundër Britanisë së Madhe A 300-A (1994) par. 55.

veprës penale”, ose, kur “situata e të dyshuarit është ndikuar thellësisht për shkak të dyshimit të njëjtë”¹²⁹.

Akuza mund të jetë: kur një person së pari merret në pyetje si një i dyshuar¹³⁰; kur është dhënë urdher për arrestimin e tij për vepër penale¹³¹; kur kjo bëhet në bazë të informimit oficial të tij për ndjekjen penale¹³²; kur një person ka caktuar avokatin mbrojtës pasi që prokurori të ketë hapur një dosje në bazë të raportit policor¹³³; dhe, kur hetuesit kërkojnë nga personi të japë dëshmi për t'i ngrirë llogaritë e tij bankare¹³⁴.

Në kontekst të hetimeve dhe të drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 6 (të drejtat minimale të garantuara me nenin 6 (3) janë po ashtu të rëndësishme). Neni 6 (3) (b) parasheh “të drejtë për të pasur kohë dhe vend adekuat për përgatitjen e mbrojtjes”. Neni 6 (3) (c) parasheh një garanci të dyfishtë të së drejtës që “dëshmitarët kundër tij”. Kjo garanton, gjithashtu në mënyrë më specifike dëgjimin relevant të veprave penale në seancën gjyqësore, e cila ndërlihet me procedurën paragjyqësore siç është për shembull deponimi i dëgjimeve që mund të ndodhin gjatë fazës hetuese. Gjykata Evropiane ka interpretuar Nenin 6(3) me sigurimin e barazisë së armëve mes prokurorisë dhe mbrojtjes në procedurat penale si “një përmbajtje e termit drejtësi” sipas Nenit 6 (1)¹³⁵. E drejta për seancë kundërshtuese do të thotë, në rastet penale, se edhe prokurorit edhe mbrojtjes duhet dhënë mundësinë për të pasur njohuri t'i komentojnë vërejtjet e dorëzuara dhe dëshmitë e përmendura nga pala tjetër¹³⁶. Kështu mbrojtja ka të drejtë të zbardhë çdo material që posedon kundra ose material tek i cili mund të ketë qasje dhe mund të ndihmojë të akuzuarin për shfaqësim të vetvetes ose në marrjen e një dënimi të zvogëluar. Kjo përfshinë material i cili mund të minojë kredibilitetin e dëshmitarit të prokurorisë¹³⁷.

Në *Foucher kundër Francës* Komisioni shpalli thyerje të nenit 6 (3) dhe të principit të barazisë në procedurë gjyqësore kur prokurori ka refuzuar qasje tek dosjet e tij për të pandehurin e papërfaqësuar dhe nuk ka lejuar kopjimin e dokumenteve që përmbante dosja, me se e ka pamundësuar përgatitjen e një mbrojtje adekuate¹³⁸.

Një e drejtë e garantuar është e drejtë për vetë-inkriminim. Gjykata e konsideron këtë të garantuar sipas të drejtës për dëgjim të drejtë në bazë të nenit 6 (1).¹³⁹ Kjo

¹²⁹. Deweer kundër Belgjikës A-35 (1980) 27 shkurt 1980, par. 44 dhe 46.

¹³⁰. Hozee kundër Holandës, 1998-III, 22 maj 1998.

¹³¹. Wemhoff kundër Republikës Federale të Gjermanisë, A-7, 27 qershor 1968

¹³². Neumeister kundër Austrisë, A-8, 27 qershor 1986

¹³³. Angelucci kundër Italisë, A-196-C (1991), 19 shkurt 1991.

¹³⁴. Funke kundër Francës, 25 shkurt 1993, A-256-A.

¹³⁵. Monnell dhe Morris kundër Britanisë së Madhe A-115 (1987), parag. 62.

¹³⁶. Edwards dhe Lewis kundër Britanisë së Madhe 2004-X, 24 tetor 2004, par. 46, 48

¹³⁷. Jaspers kundër Belgjikës Nr 8403/78 27 DR 61 (1981).

¹³⁸. Foucher kundër Francës 1997-II, 18 mars 1997.

¹³⁹. Saunders kundër Britanisë së Madhe 1996-VI, par. 68.

VEPRIMET HETIMORE - DORACAK PËR PROFESIONISTËT **63**

e drejtë edhe pse nuk është specifikuar nën Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, është e garantuar me Nenin 14 të Konventës Ndërkombëtare Për të Drejtat Qytetare dhe Politike.

Pranimi i transkripteve në dosjen e dëshmimeve të një intervistimi detyrues me hetuesit, detyra për t'u përgjigjur të jetë i detyrueshme nga seanca përbuzëse, thyejnë nenin 6 (1).¹⁴⁰

¹⁴⁰. Saunders kundër Britanisë së Madhe 1996-VI, 17 dhjetor 1996



PJESA 3. **MBLEDHJA E** **DËSHMIVE NGA** **PALËT**

1. HYRJE

Ligji i ri lidhur me procedurën penale (LPP-në) ka futur në mënyrë efektive koncepte dhe mekanizma "adversare" kundërshtore duke e bërë në këtë mënyrë procedurën të drejtuar nga kuazi-palët. Kjo, mes tjerash, nënkupton se palët në procedurë duhet të luajnë një rol më të madh para fazës së daljes në gjykim, d.m.th. gjatë grumbullimit të dëshmimeve. Mirëpo, kjo prodhon përgjegjësi të shtuar. Avokati i mbrojtjes ose prokurori nuk mund më ta mbikëqyrin procedurën në mënyrë pasive ashtu sikur gjykatësi hetues ose gjykatësi i ngarkuar me çështjen e kryerjes së funksionit të tyre respektiv. Për avokatin e mbrojtjes mundësia e grumbullimit të dëshmimeve është risi.¹⁴¹ Edhe pse kjo jep mundësi për të, që në mënyrë aktive, të kërkojë dëshmitarë dhe dëshmi materiale, po ashtu prodhon një sërë dilemash etike. Personat e angazhuar nga ana e avokatit të mbrojtës që të mbledhin dëshmi janë anëtarët e tij, dhe si të tillë, nëse sjellja e tyre është joprofesionale ose joetike, do të implikojë drejtpërdrejt avokatin mbrojtës. Ligji i ri mbi procedurën penale (LPP) kërkon që palët të jenë dinamike dhe proaktive. Pasiqë marrja në pyetje dhe marrëveshja mbi pranimin e fajësisë varet në masë të madhe nga grumbullimi i dëshmimeve (hetimi), meriton që ky aspekt i ri i LPP-së të diskutohet në hollësi. Provat që grumbullohen dhe që janë në dispozicion të Palëve do të kenë ndikim direkt mbi shqyrtimin e dëshmitarëve (marrja në pyetje të dëshmitarëve të vet dhe të dëshmitarëve të palës tjetër) si edhe mbi marrëveshjen e pranimit të fajësisë.

Nga pikëpamja e prokurorit, provat grumbullohen nga autoritetet profesionale për zbatimin e ligjit.¹⁴² Deri në këtë masë, prokurori mbështetet në këto shërbime të autorizuar që ta kryejnë hetimin e nevojshëm në mënyrë korrekte dhe të paanshme. Prokurori duhet ta drejtojë dhe mbikëqyrë progresin e hetimit, duke u siguruar se janë identifikuar dhe marrë në pyetje të gjithë dëshmitarët, se janë ndjekur me korrektësi procedurat e veçanta hetimore, se janë grumbulluar dhe testuar provat materiale siç duhet, se janë gjetur dhe grumbulluar prova në favor

¹⁴¹. Shih nenin 306 i cili i lejon mbrojtjes të "ndërmarrë masa dhe aktivitete për të mbledhur dëshmi të cilat janë në favor të mbrojtjes dhe ta bëjë këtë vet ose përmes hetuesve të autorizuar privatë apo këshilltarëve teknikë.

¹⁴². Shih nenin 46 (2).

të të dyshimit ose të të akuzuarit (prova shfajësuese) me zell të barabartë gjatë gjetjes së provave inkriminuese¹⁴³, etj. Pasiqë pikësnyimi – nga pikëpamja e prokurorit– është që të sigurojë vendosjen e drejtësisë, është e domosdoshme që prokurori ti qaset fazës hetimore sa më objektivisht që mundet. Sa më i plotë të jetë hetimi, aq në pozitë më të mirë do të jetë prokurori gjatë gjykimit ose gjatë marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë – ku qëllimi është që të bindet i akuzuari se provat e grumbulluara kundër tij ose saj dëshmojnë mjaftueshëm fajësinë dhe se për ta zbutur dënimin është më mirë që të bashkëpunojë i akuzuari, ta pranojë fajësinë dhe përgjegjësinë.

Nga pikëpamja e palës mbrojtëse, provat grumbullohen nga hetuesit privatë me mjete financiare të siguruar nga buxheti shtetëror.¹⁴⁴ Nëse e krahasojmë aftësinë e hetuesisë për grumbullimin e provave mund të identifikohen shumë pabarazi; burimet financiare dhe njerëzore të involvuara, shtrirja e tyre (lloji i akteve hetimore i lejuar), si edhe momenti i ndodhjes së tyre gjatë procedurës, janë mjaft të ndryshme midis prokurorisë dhe mbrojtjes. Për shembull, neni 305 lejon të parashtrihen propozime nga ana e mbrojtjes gjatë procedurës hetimore me qëllim të “dhënies së sugjerimeve prokurorit për veprime të mundshme hetimore me qëllim të grumbullimit të ndonjë prove të caktuar.” Megjithëse kjo nënkupton se mbrojtja mund ta drejtojë prokurorinë kah prova të favorshme, kjo me siguri ngjall shqetësime serioze për korrektësinë e kësaj procedure. Mund të ketë raste kur mbrojtja nuk do ta shohë të udhës të kërkojë nga prokurori që të kryen ndonjë hetim për ndonjë çështje diskrete e cila do të ishte relevante ose e rëndësishme për të. Nëse mbrojtja nuk e di rezultatin nga hetimi, ka rrezik prokurorit t’i kërkohej të bëjë hetime lidhur me ndonjë çështje që mund të rezultojë në dëm të mbrojtjes. Për dallim nga prokuroria, avokati i mbrojtjes nuk ka për obligim ta kërkojë të vërtetën. Edhe pse nuk do t’i dëmtonte provat, mbrojtja me siguri nuk është e obliguar të kërkojë dhe t’ia dorëzojë provat inkriminuese prokurorisë.

Për mbrojtjen, qëllimi i grumbullimit të provave është përforcimi i lëndës mbrojtëse për gjykim ose për marrëveshjen e pranimin të fajësisë. Nuk ndodh çdoherë që avokati i mbrojtjes të gjejë dëshmitarë ose prova materiale që ta fitojë apo lehtësojë lëndën. Mund të ndodh që informatat e grumbulluara të jenë relevante dhe të nevojshme për qëllime të marrjes në pyetje të palës tjetër. Mjafton të thuhet se grumbullimi i provave duhet bërë sistematikisht dhe me një qëllim në mendje. Edhe pse nuk hetohen dy raste në mënyrë të njëjtë, ekziston një proces i përgjithshëm me anë të cilit identifikohen nevojat hetimore. Ky proces në sistemet adversive njihet si identifikimi ose zhvillimi i teorisë së rastit. Grumbullimi i provave dhe identifikimi i teorisë së rastit shkojnë paralelisht. Avokati i mbrojtjes, nga provat e grumbulluara prej organeve kompetente dhe udhëzimeve të klientit (i dyshuari ose i akuzuari), do të vendosë se çfarë hetimi të mëtutjeshëm duhet të bëjë hetuesi privat i angazhuar nga mbrojtja. Nëpërmjet këtij procesi, do të lindin

¹⁴³. Shih nenin 291(4). Shih gjithashtu nenin 15 i cili obligon gjyqin dhe organet e shtetit për objektivitet.

¹⁴⁴. Shih nenin 75(3)

teori ose qasje potenciale sesi më mirë ta mbrojnë çështjen. Kjo, si shpërblim, do të ndihmojë në përqendrimin dhe ngushtimin e përpjekjeve hetimore. Dhe në fund do të lind teoria e rastit të mbrojtjes. Pastaj të gjitha veprimet – brenda ose jashtë procedurës gjyqësore – do ta diktojnë drejtimin e duhur që duhet ta marr avokati i mbrojtjes. Duke pasur parasysh këtë përvojë, do të ishte e dobishme të shqyrtojmë më afër se si zhvillohet teoria e rastit.

2. ZHVILLIMI I TEORISË SË RASTIT

Asnjë rast nuk mund të gjykohet kurrë me sukses pa pasur “teorinë e rastit”. Nëse avokati nuk ka drejtim të qartë dhe nuk i di rrugët e mundshme, asnjëherë nuk do të arrijë atje ku dëshiron të shkojë. Nëse avokati nuk e ka të qartë çështjen dhe se pse i akuzuari duhet të shpallet fajtor (nëse është prokuror) ose i pafajshëm (nëse është avokati i mbrojtjes), atëherë ai nuk është i përgatitur në mënyrë adekuate për gjykimin.

Teoria e rastit s’është asgjë më shumë nga ajo sesa tregimi bindës logjik për atë se çka ka ndodhur nga pikëpamja e prokurorit/mbrojtjes. Kjo është “arsyeja”, “justifikimi” ose “shpjegimi” për atë se pse prokuroria ose mbrojtja duhet ta fitojë gjykimin. Teoria e rastit duhet të zhvillohet logjikisht dhe permanent ashtu që pas shqyrtimit të provave dhe dëshmive të të gjithë dëshmitarëve, trupi gjyqësor të mund të japë vendim të arsyeshëm në dobinë tuaj. Për shembull, në një rast vrasjeje, prokurori do të argumentonte se provat e dhëna dëshmojnë se i akuzuari ka vepruar me qellim të plotë. Nga ana tjetër, mbrojtja do të argumentonte ose sugjeronte se provat, kur shihen nga aspekti tjetër, dëshmojnë se i akuzuari ka vepruar në vetëmbrojtje, ose dikush tjetër është përgjegjës, ose kanë gabuar në identitetin e të akuzuarit ose pretendim i rremë, etj.

Çdo lëndë ka teorinë e vete të rastit, e cila duhet prezantuar qartë dhe pa mëdyshje. Për prokurorin teoria e rastit është e pandarë në padinë dhe dokumetet përkrahëse. Duke u bazuar në provat e mundshme, prokurori do ta ushtrojë lirinë e tij të veprimit për përcaktimin e akuzave të cilat duhet prezantuar në seancën konfirmuese dëgjimore. Në ndërtimin e teorisë së rastit me qëllim të përpilimit të padisë, prokurori sipas gjitha gjasave duhet të ketë identifikuar sesi të gjithë pjesët e provave dhe të dëshmive potenciale do të ndihmojnë në vërtetimin e të gjitha elementeve për secilën akuzë. Me fjalë tjera, për ndonjë element të caktuar të çdo akuze e cila duhet dëshmuar duke u bazuar në Kodin Penal, prokurori do të duhet të identifikojë përmes cilit dëshmitar ose cilës provë do ta bëjë këtë. Procesi i identifikimit të teorisë së rastit / padia për prokurorinë është çështje *konstruksioni*: kjo lind nga grumbullimi i provave dhe diktohet nga kërkesat statusore ose elementare të kodit penal.

Për sa i përket mbrojtjes, teoria e rastit do të lind pasi që avokati i mbrojtjes do të ketë pasur mundësi t'i shqyrtoj me imtësi provat e prokurorit, pasi të ketë kryer hetimin e vet dhe te jetë takuar me klientin dhe me dëshmitarët. Kështu, procesi i identifikimit të teorisë së rastit për lëndën e mbrojtjes është çështje *de-konstruksioni*: Kjo lind nga dobësimi dhe cënimi i cilësisë/ i thelbit të provave të prokurorisë. Kjo, në përgjithësi, arrihet nëpërmjet grumbullimit të provave të cilat i kontradiktojnë ose i zvogëlojnë provat e prokurorisë, sidomos nëse bëhet fjalë për etablimin e ndonjë elementi thelbësor të akuzës që duhet vërtetuar nga ana e prokurorisë.

Duke i pasur parasysh rolet e ndryshme të prokurorit dhe avokatit të mbrojtës dhe përgjegjësitë e tyre dalluese siç janë parashikuar me ligj, prokurori, në thelb, është i kufizuar ndaj padisë. Gjatë procesit të gjykimit, prokuroria mund ta ketë lirinë, nën disa rrethana të rralla, t'i ndryshoj akuzat. Në rrethana të tilla, teoria e mbrojtjes duhet të adaptohet me akuzat e reja të ndryshuara.

Derisa Avokati i mbrojtjes është i kufizuar nga provat në dispozicion, ai s'ka përgjegjësi për të vërtetuar lëndën, gjegjësisht ai s'duhet të vërtetojë asgjë gjatë gjykimit. Si i tillë, avokati i mbrojtjes mund të përcaktohet të mos bëjë hetime madje as edhe të ketë rol aktiv gjatë gjykimit – duke pasur parasysh teorinë e rastit se prokuroria nuk do të mund ta vërtetojë lëndën e vet me ato prova që i ka në dispozicion. Teoria e mbrojtjes do të mbështetet në faktet e rastit. Teoria e rastit në bashkëpunim me disa fakte të caktuara pastaj do ta diktojë strategjinë dhe taktikën e implementimit. Nëse, për shembull, në një rast vrasjeje, teoria e mbrojtjes është vetëmbrojtja, avokati i mbrojtjes duhet të bëjë *prima facie* duke vërtetuar me ndihmën e provave se i akuzuari ka vepruar në vetëmbrojtje. Pastaj do të varet nga prokuroria të vërtetojë se i akuzuari nuk ka vepruar në vetëmbrojtje ose i akuzuari i ka tejkuluar kufijtë e vetëmbrojtjes.

Për mbrojtjen mund të ekzistojnë teori të ndryshme. Mirëpo, mund të ndodh që teoritë në dispozicion ndeshen mes veti dhe avokati i mbrojtjes do të duhet të zgjedhë teorinë më bindëse. Për shembull, në një rast përdhunimi ku provat janë të pakta (s'ka prova materiale ose mjekësore që e implikojnë të akuzuarin me dëshmitarin/viktimën ankuese) dhe ku s'ka dëshmitar okular, teoritë e mbrojtjes në dispozicion janë: a) keqidentifikimi (kishte përdhunim por i akuzuari s'e ka bërë këtë vepër) ose b) marrëdhënie seksuale me konsensus (pala akuzuese gënjen se i akuzuari e ka detyruar të ketë marrëdhënie seksuale). Të dyja teoritë e mbrojtjes mund të jenë të frytshme nëse ka fakte të mjaftueshme. Mirëpo, do të ishte kontradiktore t'i shfrytëzojmë të dy teoritë, gjegjësisht, "Unë skam pasur marrëdhënie seksuale me këtë dëshmitar, por edhe po të kem pasur atëherë do të ishte me konsensus. Prapëseprapë, duhet theksuar se ekzistojnë edhe teori tjera alternative të cilat

s'duhet përjashtuar (që s'janë kontradiktore). Kështu, në disa raste, duke u mbështetur në faktet e rastit, avokati i mbrojtjes mund që me sukses të argumentojë më shumë se një teori. Cilado qoftë situatë, avokati i mbrojtjes patjetër të përcaktohet për ndonjë teori potenciale, ta zgjedhë teorinë më bindëse (më të besueshme) para se ta përgatisë ose prezantojë atë teori para trupit gjykues.

Mori idesh për të kërkuar teorinë e rastit

Pas shqyrtimit të materialit dhe diskutimit të rastit me ekipin përgjegjës për gjykimin e caktuar, avokati i mbrojtjes përgatitet për të analizuar çdo aspekt të rastit. Në këtë fazë, mbrojtja do jetë në kërkim të teorisë më të mirë për përparimin e rastit të të akuzuarit, duke pasur parasysh, natyrisht, se edhe prokuroria ta bëjë të njëjtën gjë: duke tentuar të identifikojë teorinë e mundshme të mbrojtjes dhe duke kërkuar mënyra për analizimin dhe asgjësimin e tyre. Ky proces, gjegjësisht, analizimi i fakteve dhe i ligjeve të zbatueshme dhe destilimi i rastit në imtësira quhet stuhi idesh (brainstorming).

Pikënisja më e mirë për procesin e stuhisë së ideve është ligji. Pa pasur njohuri të qarta për ligjin e zbatueshëm, është e pamundur të bëhet vlerësimi i fakteve. Njëri duhet të fillojë me akuzat e bëra dhe ligjet relevante. Të analizojë mirë të gjitha akuzat e padisë. Të bëjë listën e fakteve, nëse ka në dispozicion fakte të tilla. Dhe në fund, të bëjë listën e mangësive të mundshme që mund të gjenden në rastin e prokurorisë. Kjo është lista e parë për vlerësimin e fakteve në dispozicion dhe për përcaktimin e nevojës për aplikime ligjore, detyra hetimore, konsultime me dëshmitarë ekspertë etj.

Në takimin e stuhisë së ideve, të gjitha idetë dhe teorinë që parashtrohen duhet të shënohen në listë dhe të analizohen.

Marrja në konsideratë e shënimeve të mëposhtme është shumë e rëndësishme:

- Dëshmia e secilit dëshmitar të mundshëm;
- Çështjet dëshmuese duhet të identifikohen (hulumtohet dhe përpilohet një memorandum ligjor, nëse është e nevojshme);
- Vizita në vendin e ngjarjes;
- Shqyrtim të provave materiale, dhe nëse duhet, të organizohet testimi i tyre;
- Propozimet e mundshme preliminare duhet listuar;
- Parametrat për detyrat hetimore duhet caktuar me afate të caktuara;
- Nevoja e konsultimit të dëshmitarëve ekspertë;
- Përdorimi i provave demonstrative/materiale vizive; dhe
- Çfarëdo veprimi tjetër i nevojshëm që mund të ndihmojë në vlerësimin e rastit.

Çdo rast kërkon një mori të gjerë idesh. Rrjedhimisht, është me rëndësi që të krijohet shprehja që secilit rast t'i qaset në mënyrë metodike dhe analiza të thella. Nëse rasti kërkon përpjekje hetimore, është me rëndësi që të kyçet edhe hetuesi në takimin e morisë së ideve. Hetuesit me përvojë mund të jenë burime të dobishme për ide të reja për atë se çfarë duhet hetuar, ku të kërkohen dëshmi, çfarë mbrojtjesh potenciale mund të ekzistojnë etj. Në takimet e këtilla të ideve, detyra e hetuesit është t'i sfidojë qëndrimet e avokatit, të theksojë dobësitë në teorinë/të potenciale të rastit, dhe të bëjë sugjerime të çmuara. Me fjalë tjera, hetuesi në këtë rast vepron si gjykatës dhe si palë opozitare, me se e detyron avokatin t'i artikulojë argumentet e rastit logjikisht. Për të gjithë anëtarët e ekipit mbrojtës, duke përfshirë këtu edhe hetuesit, është me rëndësi të jenë sa më objektiv dhe sa më real që është e mundur. Është kundër-produktive të shtrembërohen dhe të injorohen faktet që janë të lakmueshme ose të dëmshme për rastin. Përkundrazi, qasja më e mirë është të pranohen këto fakte (të cilat zakonisht nuk mund të ndryshohen) dhe duke e bërë këtë, të shohin nëse mund të bëhet diçka – si p.sh. grumbullimi i provave plotësuese – që do ta zvogëlonte ndikimin e këtyre fakteve në teorinë e përgjithshme të mbrojtjes.

3. LISTA E DETYRAVE PËR PËRGATITJEN E RASTIT PËR NË GJYKIM

1. MËSONI TË GJITHA FAKTET E MUNDSHME

- të merren të gjitha materialet e rastit;
- të shënohen faktet e mira dhe të këqija, duke përfshirë edhe fakte për të cilat dëshironi të zbuloni gjatë hetimit;
- të bisedohet me dëshmitarët;
- të dilet në vendin e ngjarjes;
- të shqyrtohen provat material, dhe
- të studiohen deklaratat e dëshmitarëve në hollësi.

2. ANALIZONI FAKTET ME MORI IDESH

- në çfarë faktesh do të mbështetet prokuroria/mbrojtja?
- vallë mund të interpretohen në mënyra tjera këto fakte? (shihni fotografinë e madhe: realitetin);
- vallë dëshmitari ka dhënë fakte të duhura?- të njëanshme, me paragjykime ose të pabesueshme (kam dëgjuar, kam thënë);
- vallë mund të mposhten këto fakte dhe nëse po, si?
- cilat janë shpjegimet e mundshme për faktet dëmtuese?
- cilat fakte nuk mund të ndryshohen (fakte të cilat nuk mund të kontestohen ose s'mund të jepet ndonjë shpjegim alternativ)?
- çfarë konkluzione tjera mund të nxirren nga faktet? dhe

- si mund të bashkohen këto fakte që të vërtetohet mungesa e fajësisë ose pafajësia?
Shënim: disa fakte, kur i konsideroni veç e veç mund t'u japin drejtim të gabuar.
3. SHQYRTONI ME KUJDES LIGJIN NË FUQI
- studioni atë ligj të cilin mendoni se e studion edhe opozita;
 - bëni listë të elementeve për çdo akuzë;
 - kërkoni kundërvajtje alternative/më të buta në ligj;
 - kërkoni mbrojtje të mundshme (mbrojtje afirmative / parciales) të parapara me ligj.
4. BËNI LISTËN E TË GJITHA MBROJTJEVE TË MUNDSHME SIPAS LIGJIT
5. BËNI LISTËN E SULMEVE TË PARASHIKUARA PËR SECILËN TEORI TË MUNDSHME LIGJORE
6. PËRCAKTOHUNI PËR TEORINË MË TË MIRË TË RASTIT
- shfrytëzoni të gjitha kombinimet e mundshme të fakteve të vërtetoni fajësinë ose pafajësinë (varësisht cilën palë e përfaqësoni);
 - kërkoni interpretime logjike dhe të favorshme, konkluzione që mund të nxirren nga faktet;
 - përqendrohuni në faktet duke i shqyrtuar ato nga çdo kënd i mundshëm derisa të gjeni një shpjegim të besueshëm për atë se pse i akuzuari është fajtor ose i pafajshëm (varësisht cilën palë e përfaqësoni);
 - zhvilloni argumente për atë sesi ka gabuar opozita duke i parë faktet sipërfaqësisht;
 - demonstroi se si duke i shqyrtuar faktet më afër i akuzuari është fajtor apo i pafajshëm (varësisht cilën palë e përfaqësoni).
Shënim: Nëse avokati nuk e artikulon qartë dhe shkurt atë se për çka bëhet fjalë në rastin e dhënë, atëherë ai nuk ka njohuri për teorinë e vet të rastit. Avokati përgatitjen e tij duhet ta përqendrojë në çështjen kryesore. Ai duhet ta bëjë listën e çdo fakti të mundshëm të cilat e mbështesin teorinë e tij, së bashku me të gjitha arsyet dhe shpjegimet. Më tutje, ai duhet t'i identifikojë edhe argumentet e parashikuara të opozitës dhe të bëjë listën e kundër-argumenteve për çdo pikë diskutimi. Në fund, avokati duhet pasur parasysh shqetësimet e trupit gjykues dhe të gjejë shpjegime për secilin argument që mund të lind ose pyetjet e parashtruara nga gjykatësit.
7. PËRCAKTOHUNI PËR NJË TEMË – EMOCININ DOMINUES NJERËZOR QË DO T'JU NDIHMOJË NË PËRPARIMIN E TEORISË SË RASTIT
- Çfarë ndjenjash dëshironi të përcjellë avokati? P.sh. frikë, dashuri, urrejtje, tronditje, vetmi etj;
 - Tema duhet ta përparoj faktorin e “besueshmërisë” të teorisë së rastit.

8. SULMONI LËNDËN E PALËS OPOZITARE

- kërkoni parregullsi për çdo deklaratë ose sjellje të dëshmitarëve;
- shikoni vallë ato janë në përputhje deklaratat e dëshmitarëve opozitarë dhe me faktet fizike;
- theksoni gabimet e opozitës në analizën juridike dhe në zbatimin e ligjit;
- theksoni lëshimet dhe autorizimet e hetimeve të opozitës;
- shikoni vallë ekzistojnë parregullsi ndërmjet dëshmitarëve për sa i përket kohës/vendit/ngjarjeve etj;
- shqyrtoni motivin e secilit dëshmitar – çfarë arsyes ekzistojnë për motivimin e dëshmisë ose veprimit të dëshmitarit.

9. ZHVILLONI STRATEGJË!

- cila është rëndësia e çdo dëshmitari për lëndën? (bëhet fjalë edhe për dëshmitarët e prokurorisë edhe ata të mbrojtjes);
- çfarë pikash duhet marrë parasysh gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve të vet dhe të opozitës dhe pse? Avokati duhet të pyes vetveten se cila pikë e zhvillon më tej teorinë e rastit;
- cila është rëndësia e çdo prove për lëndën?
- çfarë propozimesh do të parashtrohen dhe kur?
- çfarë provash do të paraqiten në gjykim / çfarë provash nuk do të përfshihen aty?
- cilët dëshmitarë duhet ftuar?

Shënim: Avokati duhet të artikulojë se pse ndonjë dëshmitar i caktuar është i rëndësishëm, sa është pesha e dëshmisë së dëshmitarit dhe si kjo dëshmi do ta ndihmojë trupin gjykues të sjellë një konkluzion. Avokati duhet të marr parasysh se edhe gjyqtari edhe pala e opozitës do t'i marrë në pyetje dëshmitarët.

- cila është pika kyçe (çështja kyçe) e përkrahjes / sulmit të lëndës?

Shënim: Qasja më e mirë është të zgjidhet një argument. Avokati duhet ta zhvillojë argumentin e tij sipas rendit të rëndësisë duke i marrë parasysh të gjitha anët e forta të lëndës së tij kundrejt atij argumenti të vetëm. Gjatë gjyimit, ai duhet t'i përqendroj të gjitha përpjekjet në këtë dhe vetëm në këtë argument. Avokati duhet t'iu përgjigjet të gjitha argumenteve të palës së kundërt, derisa t'ia drejtojë vëmendjen trupit gjykues kah argumentimi kryesor i kontestit.

Me qëllim të zhvillimit të strategjisë së gjyimit, avokati duhet të ketë teori të rastit. Përmes morisë së ideve, avokati do ta zgjedhë teorinë më të mirë. Teoria më e fortë në çdo lëndë bazohet në një çështje kryesore të cilën lënda më së miri e mbron ose është më pak e ndjeshme ndaj sulmeve. Duke e zhvilluar një teori të vetme, ai mbani kontinuitet, kredibilitet dhe integritet me trupin gjykues. Kur nuk

ekziston ndonjë teori, alternativa tjetër është qasja e teorive të shumëfishtë. Mangësia e vetme e kësaj strategjie është ajo se bëhet mjaft vështirë, nëse edhe, e pamundur për avokatin ta mbajë kredibilitetin me trupin gjyqës.

4. GRUMBULLIMI I PROVAVE NËPËRMJET HETUESIT

Të keni njohuri për lëndën tuaj

Për ta shfrytëzuar me efikasitet një hetues, secila palë duhet të ketë dijeni për lëndën e vet. Kjo sidomos i përshtatet Mbrojtjes, burimet hetimore të së cilës zakonisht janë të kufizuara. Dhënia përparësi nevojave hetimore është thelbësore. Që të ndodh kjo, avokati i mbrojtjes duhet të ketë njohuri për të gjitha dokumentet në dosje dhe të ketë sens të përgjithshëm për teorinë e rastit.¹⁴⁵ Ai duhet të ketë njohuri për dëshmitarët potencialë dhe për rolin e tyre, t'i kuptojë anët e forta dhe të dobëta të lëndës, dhe të ketë një ide të përgjithshme për atë se çfarë përpjekjesh duhet bërë për ta përgatitur lëndën për gjykim.

Para se të shqyrtohet lënda me hetuesin, secila palë duhet të përpilojë një memorandum për dosjen, duke përfshirë: akuzat, faktet, dëshmitarët, mbrojtjet e mundshme, anët e forta dhe të dobëta të lëndës dhe çdo informatë tjetër të dobishme për hetuesin. Përpilimi i memorandumit e bën më të lehtë përqendrimin në çështjet (juridike dhe faktike) që duhen zgjidhur. Ky memorandum duhet të përmbajë propozimet e parashikuara preliminare, *teoritë* e mundshme të *mbrojtjes*, përshtypjet e avokatit të Mbrojtjes lidhur me dëshmitarët ankues, klientët, dëshmitarët, etj., nevoja për ekspertë, mospërputhjet brenda dokumenteve dhe një listë të përgjithshme për detyrat e mundshme hetimore. Pasiqë nga hetuesi nuk mund të pritët të ketë njohuri për të gjithë ngatërresat e kodit dhe procedurës penale, është mirë të theksohen elementet e çdo akuze të krimit në memorandum. Kjo do t'u mundësojë hetuesëve të kenë njohuri për atë se çka dëshiron të vërtetojë nëpërmjet dëshmitarëve dhe fakteve të dokumentuara. Nga ana tjetër, kjo e lejon hetuesin të përfitojë njohuri për sfidat e palëve. Sa më shumë që ka njohuri hetuesi për ligjin në fuqi, duke përfshirë këtu edhe atë sesi pranohen dhe vlerësohen provat nga ana e trupit gjyqës, aq më mirë do të jetë për hetuesin të ketë dijeni për atë se çfarë të kërkojë dhe pasi ta ketë gjetur këtë, si ta përdor të njëjtën në lëndën e dhënë.

Pasi të përgatitet memorandum, hapi i ardhshëm është koordinimi me hetuesin për të caktuar një takim me qëllim të diskutohet lënda, nëse paraqitet nevoja. Nëse kërkohen hetime ekstensive, duhet kopjuar pjesë nga lënda dhe t'i jepen hetuesit. Mirëpo, në shumicën e rasteve hetuesi duhet të njihet vetëm me

¹⁴⁵ Shih, nenin 79, i cili e lejon Avokatin të ketë qasje në Lëndën dhe provat e mundshme, si edhe në skedarët dhe raportet e mbajtura nga Prokurori.

74

dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij hetimore. Mjafton të thuhet se hetuesit do t'i nevojiten udhëzime, gati për secilin rast, për hetimet që duhet të bëjë.

Moria e ideve për lëndën

Diskutimi i lëndës me hetuesin është ndoshta aspekti më i rëndësishëm për përgatitjen dhe për zhvillimin e lëndës. Pas shqyrtimit të memorandumit dhe të dokumenteve të tjera të dorëzuara te ai, hetuesi do ta sjellë njohurinë dhe përvojën e tij në takimin e morisë së ideve, me ide dhe sugjerime konkrete për lëndën. Duke e shqyrtuar dokumentacionin dhe teorinë e rastit, hetuesi do t'i ndihmojë edhe më shumë avokatit të mbrojtjes të përqendrohet në çështjet kryesore. Ai do t'i japë përshtypjet e tij për anët e dobëta dhe të forta të lëndës, do ta bëjë listën dhe do t'u japë përparësi detyrave hetimore dhe, mbi të gjitha, të veprojë si drejtues dhe të argumentojë pikëpamjet e palës opozitare. Edhe prokurori edhe avokati i mbrojtjes edhe hetuesi duhet të përqendrohen në aspektet e papërputhshme të lëndës të cilat duhet patjetër të trajtohen dhe t'i sqarohen trupit gjykues.

Dhënia përparësi kërkesave

Me mbarimin e takimit të morisë së ideve, hetuesi duhet t'i ketë të qarta detyrat hetimore. Duhet të caktohen afate kohore dhe të njoftohet avokati i mbrojtjes nëse hetuesi nuk do të jetë në gjendje t'i kryejë ato detyra në kohë. Të gjitha kërkesat duhet të kenë një qëllim konkret dhe hetuesi duhet të ketë njohuri që ta kuptojë rëndësinë e çdo kërkesë për *teorinë e rastit* të mbrojtjes. Kjo i mundëson hetuesit të bëjë prioritetizimin e detyrave hetimore. Më tutje, nëse hetuesi e kupton rëndësinë dhe qëllimin e detyrës, atëherë edhe detyrat e tjera hetimore të hetuesit do të mund të kryen pa nxitjen e mëtejme të avokatit të mbrojtjes. Ashtu sikur lënda i afrohet kohës së gjykimit, palët duhet të konsultohen me hetuesin në baza të rregullta që të sigurohen se detyrat po kryhen: ndjekja e gjurmëve, kryerja e hollësive në çastin e fundit etj. Në vazhdim, nëse lënda shkon në drejtim të kundërt nga ajo që pritej, ose nëse data e gjykimit shtyhet, avokati i mbrojtjes duhet t'ia përcjellë këtë informatë hetuesit. Duke e mbajtur të informuar hetuesin, secila palë mund të zhvillojë marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi duke i shmangur kështu telashet që mund të ndodhin.

Konsideratat themelore (sidomos lidhur me hetuesit)

- a. Përpiloni plan para se të niseni të gjeni dhe merrni në pyetje dëshmitarët:** është me rëndësi planifikimi paraprak për sa i përket fushës së veprimit dhe qëllimit të hetimit. Asnjë hetim s’duhet kryer rastësisht.
- b. Përpiloni plan për çdo dëshmitar para se të caktoni takim:** është me rëndësi të dini më herët temat e përgjithshme të marrjes në pyetje për çdo dëshmitar. Asnjë intervistë s’duhet filluar rastësisht pa pasur një qëllim të qartë. Po ashtu, asnjë intervistë s’duhet të ndodh pa përgatitje paraprake. Me të vërtetë është praktikë e mirë të keni informata për ngjarjet në fjalë dhe nëse mundet, edhe për dëshmitarin që do të merret në pyetje.
- c. Kini durim dhe mos pritni shumë nga intervista e parë:** është e rëndësishme të vlerësohet se do të duhet të keni më shumë se një takim me një dëshmitar para se dëshmitari të ndjehet rehat ose fiton besim që t’ua rrëfejë të gjithë atë që e din. Nuk duhet të pritët shumë nga takimi i parë. Më me rëndësi është të tentoni të krijoni raporte të tilla që dëshmitari të ndjehet i sigurt për rrëfim. Është praktikë e mirë që gjatë takimit të parë ta njoftoni dëshmitarin për natyrën e vizitës suaj. Po ashtu duhet të jeni të sqartë për atë punë që e bëni. *Nuk është e pëlqyeshme t’i tregoni dëshmitarit për teorinë e përgjithshme të rastit tuaj të mbrojtjes* – edhe nëse ju pyet. Nëse ia tregoni dëshmitarit teorinë e mundshme të rastit mund të rrezikoni të ndikoni mbi dëshmitarin ose së paku të lihet ajo përshtypje, gjë që mund të ketë pasoja serioze: dëshmitari mund të keqkuptojë se i bëhet shtypje për t’ia përshtatur deklaratën e tij teorisë.
- d. Mendoni me kujdes para se të merrni një deklaratë ose incizoni intervistën:** Nuk është ide e mire - vetëm nëse doemos paraqitet nevoja- që avokati i mbrojtjes të marrë deklaratë ose ta incizojë intervistën pa pasur dijeni për atë se çka do të thotë dëshmitari. Me të vërtetë, as edhe nuk këshillohet që të merren shënime gjatë takimit të parë. Më së miri është të keni një bisedë joformale që të përcaktoni se dëshmimi është miqësor, i dobishëm, informativ etj. Vetëm pasi të dëgjoni dëshmitarin dhe vetëm nëse është e dobishme për lëndën, atëherë mund të merrni shënime. Para se të japë deklaratë, është me rëndësi t’ia parashtroni dëshmitarit të gjitha pyetjet e vështira (të mira, të keqia dhe të shëmtuara). Mund të ndodh që dëshmitari të ketë informata të mira por po ashtu edhe informata të këqija që ta dëmtojnë lëndën. Duhet të merrni vendim se a do të duhet ta kyçni në procesverbalin tuaj këtë informatë apo thjesht do ta braktisni këtë dëshmitar. Është me rëndësi të kuptohet se pasiqë është marrë deklarata dhe dëshmitari është ftuar të dëshmojë, ajo deklaratë mund të shqyrtohet edhe nga prokuroria. Pasiqë nuk keni asnjë obligim për ta informuar prokurorinë për ndonjë informatë që e keni marrë, por ajo është në dëm të

klientit tuaj, pse atëherë duhet të merrni një deklaratë apo ta incizoni të njëjtën e cila mund të bie në duart e prokurorisë. Me të vërtetë, para se të merrni një deklaratë, është mirë ta kontrolloni dy herë me dëshmitarët e tjerë ose provave tjera në dokumentacion. Po ashtu, do të ishte e dobishme të bëni një kontroll të historiatit të dëshmitarit që të siguroheni se s'ka asgjë në të kaluarën e dëshmitarit që do ta diskreditonte atë.

- e. Deklarata duhet të jetë e shkurtër, konkrete dhe relevante:** Praktika më e mirë në marrjen e deklaratës është ta mbani vëmendjen të përqendruar në lëndë dhe të bazuar në fakte. Kur merrni deklaratë, është e nevojshme t'i identifikoni fushat thelbësore që duhet mbuluar dhe ta bëni atë pa informata të tepërta. Fjali të thjeshta dhe të shkurta pa mbiemra dhe ndajfolje është zgjedhja më e mirë. Deklarata duhet ta shpjegojë rastin. Me fjalë tjera, nuk mjafton që dëshmitari të thotë p.sh. se e ka pa ngjarjen ose ajo përvojë ishte argëtuese, e tmerrshme, e rehatshme, etj., por ai duhet ta përshkruajë në hollësi atë çka ka parë ose çka dëgjuar që dëgjuesi ta ketë të qartë me shpresë se kjo do ta ngjallte të njëjtën përvojë edhe përvojat e tjera. Kjo e bën deklaratën të qartë dhe pa tepër informata. Më tutje, nuk duhet të ketë thurje të fakteve. Duhet të kuptohet se dëshmitari mund të ftohet në gjyq të japë dëshmi dhe rrjedhimisht duhet të mbajë përgjegjësi për atë se çka është regjistruar më parë si deklaratë e vërtetë, e saktë dhe e plotë.
- f. Mbani evidencë për dëshmitarët dhe mbani të informuar:** me rëndësi është mbajtja e evidencës për dëshmitarët duke ditur se ku dhe si të gjenden nëse paraqitet nevoja për takim të serishëm, madje edhe në gjykim. Po ashtu, është me rëndësi t'i mbani dëshmitarët tuaj të informuar për atë se çfarë duhet të presin, sidomos nëse japin dëshmi. Natyrisht, një pjesë është e mendimit t'u jepet dëshmitarëve një kopje e deklaratës së tyre dhe t'i informojnë për çfarëdo zhvillimi tjetër që mund të jetë relevant për dëshminë e tyre.
- g. Nxitja e dëshmitarit për të dëshmuar në gjyq:** Nëse një dëshmitar pritet të dëshmojë, ai duhet të njihet me pyetjet që do t'i parachutohen gjatë seancës gjyqësore. Këtë detyrë e ka avokati i mbrojtjes, edhe pse është e dobishme që edhe hetuesi të ketë njohuri për këtë teknikë e, nëse është e mundur duhet të jetë edhe prezent. Është me rëndësi të kuptohet se ky proces nuk ndodh me qëllim të "trajnit" të dëshmitarit për atë se çka duhet të thotë gjatë gjykimit. Kjo do të ishte joetike. Në përgjithësi, gjatë sesionit të nxitjes dëshmitari duhet informuar për atë sesi ndodh një proces i marrjes në pyetje, pyetjet që pritet t'i dëgjojë, renditjen e përgjithshme të pyetjeve dhe dokumentet për të cilat duhet të jep komente.

- h. Trajtimi i provave material është me vigjilencë të madhe:** Pasiqë një pjesë e procesit hetimor është edhe grumbullimi i provave materiale, është me rëndësi të ushtrohet vigjilencë e madhe gjatë trajtimit të tyre. Varësisht nga rasti, provat materiale mund të jenë në të gjitha format dhe nga burime të ndryshme. Një sërë çështjesh etike mund të lindin si pasojë e gjetjes dhe trajtimit të provave materiale. Rrjedhimisht, është me rëndësi që hetuesi të ketë udhëzime të hollësishme për atë se çka duhet apo s’duhet bërë kur ka të bëjë me prova materiale.
- **provat e vendngjarjes:** Ekzistojnë mënyra të ndryshme për trajtimin e provave varësisht nga natyra e tyre dhe origjina/burimi. Provat më delikate janë ato të vendngjarjes. Pasiqë një pjesë e procesit hetimor është të vizitohen vendet relevante ku mund të kenë ndodhur incidente apo krime, nuk është e pazakonshme që rastësisht të gjendet ndonjë prove materiale të cilën mund ta kenë anashkuar hetuesit e policisë. Në raste të tilla, ngacmimi i provave të tilla do të përbënte prishje të etikës, madje mund të konsiderohet edhe si vepër penale. Lind pyetja se çfarë duhet bërë nëse gjendemi në raste të tilla. Përgjigja është e thjeshtë: varet! Gjëja e parë që duhet bërë, pavarësisht se a është marrë vendim për grumbullimin apo braktisjen e atyre provave, është fotografimi në vendin e duhur ku është gjetur. Nëse vendoset që ato prova të merren dhe të shqyrtohen, provat mund të dëmtohen, sidomos nëse kanë fije ose shenja gishtërinjsh të cilat mund të jenë të dobishme. Si të tilla, duhet ngritur me kujdes të madh ato prova. Është e dobishme që të mbani doreza plastike mjekësore për të mos i dëmtuar provat dhe t’u shmangeni rreziqeve të mundshme shëndetësore nga trajtimi i atyre provave. Nëse vendoset që të merren ato prova, do të ishte e dobishme të keni një enë të pastër për grumbullimin e provave. Para se ta merrni atë vendim, është e nevojshme të pyeteni se çka do të ndodh (nëse ndodh) me ato prova. Me fjalë tjera, a do të testohen në mënyrë të pavarur (duke supozuar se kjo lejohet) ose do t’u dorëzohet hetuesëve të policisë. Është e ndalueshme të grumbullohen prova me qëllim të asgjësimit apo fshehjes së tyre. Sidoqoftë, varet nga avokati i mbrojtjes se çdo të bëjë me ato prova. Nëse dyshon, hetuesi s’duhet bërë asgjë para se të kontaktojë me avokatin e mbrojtjes për udhëzime të mëtutjeshme.
 - **provat e dokumentuara:**¹⁴⁶ Gjatë procesit hetimor do të ishte e nevojshme të grumbullohen prova të dokumentuara nga arkivi zyrtar ose nga individë privat. Pasiqë disa nga këto prova mund të jenë të dobishme të shqyrtohen gjatë procesit gjyqësorë, do të ishte e rëndësishme të demonstron se ato dokumente janë autentike, të besueshme dhe relevante. Pasiqë do të duhet të vërtetohet origjina dhe autenticiteti i dokumenteve, duhet të keni parasysh se dorëzuesi i dokumentit duhet të

¹⁴⁶. Sih nenin 392, i cili thotë se të gjitha dokumentet në pajtueshmëri me rregullat e paraparë në LPP do të lexohen.

japë prova për autenticitetin, kushtet dhe për origjinën e dokumentit. Për këtë gjë, është me rëndësi që hetuesi:

- a) të mbajë evidence se prej nga dhe prej kujt ka ardhur ai dokument; b) ta lusë dorëzuesin e dokumentit që ta zbulojë burimin e atij dokumenti; vallë ai kundërshton që emri i tij të ndërlidhet me atë dokument; vallë ai është i gatshëm të dëshmojë në gjyq, nën betim, për atë se si dhe në çfarë kushtesh ka ardhur në posedim të dokumentit në fjalë.
- i. **Trajtoni dëshmitarët me respekt dhe me vigjilencë:** është me rëndësi për secilin në ekipin e mbrojtjes të kuptojë se dëshmitarët duhen trajtuar me dinjitet dhe respekt. Mbi të gjitha, është e domosdoshme të kuptohet se një dëshmitar s'ka asnjë obligim për të bashkëpunuar, të flasë, t'u përgjigjet pyetjeve, të japë deklaratë ose të dorëzojë ndonjë prove materiale. Ashtu siç ekzistojnë mekanizma që e detyrojnë një dëshmitar të japë dëshmi në gjyq, po ashtu ekzistojnë mekanizma për mbrojtjen që ta detyrojnë një dëshmitar të ndihmojë jashtë gjyqit. Prandaj është me rëndësi të theksohet se nëse një dëshmitar nuk ka interesim për të bashkëpunuar, atëherë dëshira e dëshmitarit duhet respektuar. Jo vetëm që do të ishte kundërproduktive të detyrohet një dëshmitar të bashkëpunojë, por kjo do të krijonte përshtypjen se dëshmitari po ngacmohet dhe keqtrajtohet. Kjo do të kishte pasoja serioze, veçanërisht nëse dëshmitari paraqet ankesë për këtë. Një metodë që mund të shfrytëzohet për ta përfituar bashkëpunimin e dëshmitarit të mundshëm është ajo që së pari t'i afroheni mikut/mikeshës së dëshmitarit dhe të shihni vallë është e mundur që ta shfrytëzoni këtë mik/mikeshë si lidhje për ta caktuar takimin e parë dhe gjatë pirjes së një kafeje apo pije tjetër, do të mund t'i shpjegohet atij interesimi kryesor për marrjen e disa përgjigjeve nga ai. Duke e pasur prezent edhe mikun/mikeshën gjatë takimit të parë do të siguroheshe thyerja e "akullit" dhe se gjatë takimit do të bisedohet vetëm për shpjegime të përgjithshme (asnjëherë nuk është mirë të intervistohet një dëshmitar në prezencën e palës së tretë). Poashtu kjo ndihmon për të pasur një fytyrë të njohur në takim që do të mund të garantonte për tonin dhe për drejtimin e diskutimit.

5. MODEL RAPORTI HETIMOR

Kujt: Ekipit hetimor

Prej: X, avokat për _____

prokuror v _____

numri i lëndës _____

Re: Udhëzime për metodat hetimore dhe për sjelljen etike

Data: _____

Ky raport, konkretisht, përcakton qëllimin, metodën dhe kufizimet etike gjatë kryerjes së detyrave hetimore nga ana e ekipit hetimor të _____ ekipit mbrojtës. Duke pranuar se një hetues me përvojë do të kishte teknika të zhvilluara mirë dhe kohë-të testuar, është me rëndësi që të gjithë hetuesit e angazhuar nga ana e _____ ekipit mbrojtës ta kuptojnë dallimin midis të hetuarit në emër të ndonjë institucioni, siç është policia lokale ose ndonjë agjencie shtetërore dhe të hetuarit në emër të një të akuzuari si anëtar i ekipit mbrojtës. Në bazë të kësaj, me qëllim të shmangies së keqkuptimeve dhe për të siguruar se të gjitha përpjekjet hetimore janë kryer me profesionalizëm dhe etikë, patjetër të ndiqen udhëzimet e mëposhtme.

1. Qëllimi i hetimeve në emër të të akuzuarit

Duhet të kuptohet se Ligji i ri mbi procedurën penale ka adoptuar elemente të procedurës adversale, ku mbrojtjes i lejohet të kryejë disa hetime për përgatitjen e lëndës mbrojtëse. Pasiqë mbrojtja nuk ngarkohet me përgjegjësinë e vërtetimit të diçkaje, përpjekjet hetimore duhet përqendruar në arritjen e dy detyrave, në:

- a. identifikimin dhe zbulimin e dobësive të lëndës së prokurorit, dhe
- b. kërkimin e dëshmitarëve dhe provave të nevojshme për **teorinë e lëndës së mbrojtjes**. Kështu, para se të fillohet me hetime lidhur me lëndën konkrete, hetuesi duhet të njihet me pjesët relevante të lëndës, me teorinë e përgjithshme të rastit të përcaktuar nga avokati i mbrojtjes, dhe me qëllimin e saktë për kryerjen e detyrave të dhëna. Ekipi i mbrojtjes duhet të mbajë standarde të larta për sa i përket kryerjes së hetimeve të veta: asnjë anëtarë i mbrojtjes nuk guxon të ndërmarrë taktika presioni. Ky fakt duhet kuptuar dhe çmuar, prandaj hetuesi i angazhuar në emër të _____ patjetër të ketë sjellje profesionale dhe etike.

2. Metoda e Hetimit

Roli i hetuesit i cili punon për lëndën e mbrojtjes nuk ndryshon nga roli i inspektorit të policisë. Derisa inspektori i ndihmon prokurorisë në zgjidhjen e rastit duke grumbulluar prova dhe duke biseduar me dëshmitarët me qëllim që të krijojë lëndë ndaj të akuzuarit të dyshuar, nga ana tjetër hetuesi i mbrojtjes i ndihmon avokatit në asgjësimin e lëndës së prokurorisë duke grumbulluar prova dhe duke biseduar me dëshmitarët me qëllim që të tregojë se ka zbrazëtira në lëndën e prokurorisë, të ashtuquajtura dyshime të arsyeshme, për fajësinë e të akuzuarit.

Deri diku hetuesi i mbrojtjes ka përparësi për punën që është bërë para se ai të kyçet në hetim: dokumente gati të grumbulluara, dëshmitarë të intervistuar, prova të atestuara etj. Mirëpo, ekzistojnë mangësi të cilat i mbipeshojnë avantazhet e të pasurit një lëndë gati të hetuar: dëshmitarët s'kanë vullnet të bisedojnë me mbrojtjen, dëshmitarët kanë dhënë deklaratat nën presion ose frikë dhe mund të kenë qenë konfuz, dëshmitarët s'munden të gjenden sepse ka kaluar kohë, dokumentet nuk janë në dispozicion për shkak të mosbashkëpunimit të burimeve të arkivit, kufizimeve të burimeve materiale për ta hetuar rastin plotësisht etj. Rrjedhimisht, me qëllim që të përgatitet lënda për gjykim me efikasitet, hetimet e mbrojtjes duhet të kenë qëllime konkrete.

Qasja e përgjithshme e të hetuarit duke qenë anëtarë i _____ ekipit të mbrojtjes del si vijon:

- a. çdoherë të ndiqen udhëzimet e avokatit ose kolegut të tij;
- b. nëse detyra është e paqartë, të kërkojnë sqarime para se të ndërmerret diçka;
- c. të mbani evidence për detyrat e kërkuara;
- d. të mbani evidence për përpjekjet e bëra / rezultatet e arritura;
- e. të mbani shënime të mira personale;
- f. të dëgjohen me kujdes përgjigjet e dhëna nga dëshmitarët;
- g. kurrë mos bëni supozime për ndonjë gjë;
- h. çdoherë përgatituni para takimit me dëshmitarin;
- i. kurrë mos merrni iniciativë ta tejkaloni detyrën e dhënë, vetëm nëse rrjedh vet logjikisht;
- j. kurrë mos merrni deklaratë në formë të shkruar nëse nuk ju është urdhëruar; dhe
- k. të jeni të përpiktë kur t'i përshkruani ngjarjet, vendet, veprimet dhe informatat e fituara.

Pasiqë qëllimi është të nxirren informata nga dëshmitarët, hetuesit çdoherë duhet të fillojnë me pyetje të hapura të cilat nuk janë sugjестive. Nëse duhen më tepër

informata, sidomos për sqarimin e ndonjë çështje, mund të bëhen pyetje më direkte. Sipas kësaj, llojet vijuese të pyetjeve sugjerohen në fazën fillestare të sesionit të pyetjeve:

- Cili?
- Çka?
- Ku?
- Kur?
- Pse?
- Si?
- Përshkruaj!
- Sqaro!

3. Kufizimet etike

Qasja më e mirë me dëshmitarë është t'i njoftoni për pikësynimin e përgjithshëm: t'i ndihmohet të akuzuarit për përgatitjen e lëndës së mbrojtjes siç parashihet në Ligjin e ri mbi Procedurën Penale dhe duke e bërë këtë t'i afrohet të vërtetës sa më shumë që është e mundur. Që t'u shmangemi dilemave etike, i kemi udhëzimet vijuese:

- a. kurrë mos i sugjeroni dëshmitarit se cila duhet të jetë përgjigja;
- b. kurrë mos i thoni dëshmitarit se çka duhet të thotë/dëshmojë ai/ajo;
- c. kurrë mos i thoni një dëshmitari t'i asgjësojë provat;
- d. kurrë mos i thoni një dëshmitari mos të bashkëpunojë me prokurorinë;
- e. kurrë mos e kërcënoni një dëshmitar në mënyrë direkte apo indirekte;
- f. kurrë mos e keqinformoni një dëshmitar për identitetin apo funksionin tuaj;
- g. kurrë mos ia keqinterpretoni faktet një dëshmitari;
- h. çdoherë përkujtojani dëshmitarit se juve ju intereson vetëm e vërteta; dhe
- i. çdoherë të jeni të sjellshëm dhe të respektueshëm me dëshmitarin.

4. Provat materiale

Patjetër të ushtroni me vigjilencë (syhapur) kur të hasni në prova materiale. Mund të lindin një sërë çështjesh etike si pasojë e trajtimit jovigjilent të provave. Konsiderata të ndryshme mund të hynë në lojë varësisht nga ajo se a jeni ngarkuar për trajtimin e vendit të ngjarjes apo provave të dokumentuara.

(i) Provat e vendit të ngjarjes

- a. gjëja e parë që duhet bërë, pavarësisht nga ajo se a duhet grumbulluar apo braktisur provat, është të fotografohet pikërisht aty ku është gjetur prova;
- b. çdoherë mbani doreza kirurgjike prej gome për të mos i komprometuar provat materiale dhe të mbroheni nga rreziqet potenciale shëndetësore;
- c. çdoherë mbani një enë të pastër për grumbullimin e provave materiale;

82

- d. çdoherë pyeteni veten çka do të ndodh me provat. Për shembull, a do të testohen në mënyrë të pavarur (duke supozuar se kjo është e lejueshme) ose do t'u dorëzohen hetuesëve të policisë;
- e. mos harroni se grumbullimi i provave me qëllim të asgjësimit ose fshehjes së tyre në përgjithësi është e ndaluar;
- f. kur jeni në dyshim, mos bëni kurrgjë para se të kontaktoni me njerëz për t'ju dhënë udhëzime.

(ii) Provat e dokumentuara

- a. çdoherë mbani evidence për atë se prej ku dhe prej kujt kanë ardhur provat e dokumentuara;
- b. çdoherë pyeteni dorëzuesin e provave të dokumentuara vallë ka probleme të zbulohet burimi i dokumentit.

Këto janë udhëzimet më fundamentale, prandaj duhet çdoherë të zbatohen pa asnjë përjashtim. Më shumë udhëzime të detajuara do të jepen në kohën e duhur varësisht nga natyra e detyrës hetimore.

VEPRIMET HETIMORE - DORACAK PËR PROFESIONISTËT **83**





■ LITERATURA

- L. ARBOUR/ A. ESER/ K. AMBOS/ A. SANDERS (Eds.), *The Prosecutor of a Permanent International Criminal Court*, Max-Planck-Institut für ausländisches und internationales Strafrecht, Freiburg 2000;
- С. БЕЈАТОВИЌ, Нови Законик о кривичном поступку Републике Србије и тужилачки концепт истраге, МРКПК, год. 14, бр. 2, 2007, стр. 297-321
- Г. БУЖАРОВСКА/ Г. КАЛАЈЦИЕВ, Реформа на кривичната постапка, Зборник од текстови од проектот за борба со организираниот криминал на јавното обвинителство, Скопје/Охрид, 2009, 13;
- Т. ВИТЛАРОВ / Г. КАЛАЈЦИЕВ/ М. ЛАБОВИЌ/ Т. СТОЈАНОВСКИ, Системска анализа на законската рамка и соработката меѓу надлежните институции во борбата против организираниот криминал, ФИООМ, Скопје, 2005.
- M. DELMAS-MARTY / J. SPENCER (Eds.), *European Criminal Procedures*, Cambridge University Press, Cambridge 2002;
- P. FENNEL/ C. HARDIG/ N. JÖRG/ B. SWART, *Criminal Justice in Europe – A Comparative Study*, Clarendon Press, Oxford, 1995;
- S. GLUŠČIĆ, *Predistražni postupak u Republici Hrvatskoj kao osnova za reformu u novom Zakonu o kaznenom postupku*, МРКПК, год. 15, бр. 1, 2008;
- M. GRUBAČ, *Krivično procesno pravo*, Pravni fakultet, Univerzitet Union, Beograd, 2006;
- M. GRUBAČ, *Kritika predloga “novog” Zakonika o krivičnom postupku*, во XVIII Seminar Prava: Novo kazneno zakonodavstvo–dileme i problemi u teoriji i praksi, priredio: Dobrivoje Radovanović, Institut za kriminološka i sociološka istraživanja- Beograd /Viša škola unutrašnjih poslova- Zemun, Будва, 2006.
- M. ГРУБАЧ, *Кривично процесно право, Службени гласник, Београд, 2002;*
- M. ГРУБАЧ, *Треба ли судску истрагу заменити несудском*, Зборник трудови на Правниот факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, 2007;
- X. ХЕМБАХ, *Правото на бранителот во истражната постапка во Германија*, МРКПК, бр. 1, 2008;
- J. HERRMANN, *The Rule of Compulsory Prosecution and the Scope of Prosecutorial Discretion in Germany*, *The University of Chicago Law Review*, Vol. 41, No. 3. (Spring, 1974), pp. 468-505.
- J. HERRMANN, *Models for the reform of Criminal Procedure in Eastern Europe*, *Essays in Honor of G. Müller*, (E.Wise Ed.), 1994;

- J. HERRMANN, Najnoviji razvoj njemačkog kaznenog postupka, Hrvatski ljetopis za kazneno pravo i praksu, vol.2 – br.2, Zagreb, 1995;
- J. HERRMANN, Реформа на претходната постапка во споредбеното право, МРКПК, бр. 1, 2008;
- M. HILF, Country report Austria, http://www.eurojustice.org/member_states/austria/country_report.
- Д. ИЛИЌ, Реформата на истрагата во Република Македонија, Магистерски труд, Правен факултет, „Јустинијан Први“ Скопје, 2009;
- J. ЈОВЧЕСКИ/ Г. КАЛАЈЦИЕВ и др., Специјалните истражни мерки во кривичното законодавство на РМ, МРКПК, бр. 2, 2009, стр. 155.
- D. KRAPAC, Suvremeni prethodni krivični postupak – nastanak i glavne značajke, Naša zakonitost, br. 2-3, Zagreb, 1989, стр. 287-332;
- D. KRAPAC, Europsko kazneno pravo: konvergencijom nacionalnog kaznenog prava prema kaznenom pravu za Europu?, Hrvatski ljetopis za kazneno pravo i praksu, vol.13 – br.1, Zagreb, 2006;
- Д. КРАПАЦ, Reforma mješovitog kaznenog postupka: potpuna zamjena procesnog modela ili preinaka prethodnog postupka u stranački oblikovano postupaње?, Зборник трудови на Правниот факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, Zbornik radova Pravnog fakulteta u Zagrebu, 2007;
- Д. КРАПАЦ, Институционални рамки на полициските должности и овластувања за увидите на казнените дела во СР Германија, МРКК, год. 9, бр.1-2, Скопје, 2002;
- Д. КРАПАЦ/ В. КАМБОВСКИ/ Г. БУЖАРОВСКА/ Г. КАЛАЈЦИЕВ, Стратегија за реформа на казненото право на Р. Македонија, Министерство за Правда, Скопје, 2007;
- Г. КАЛАЈЦИЕВ/ Т. СТОЈАНОВСКИ/ С. ЗИКОВ., Новите односи меѓу полицијата, јавното обвинителство и судот во претходната постапка, МРКПК, бр. 1, 2008;
- Г. КАЛАЈЦИЕВ /Т. ВИТЛАРОВ/ М. ТРОМБЕВА/ Д. ИЛИЌ/ К. КРСТЕВСКА, Преуредување на претходната постапка во Република Македонија, МРКПК, бр. 2/3, 2008, 79-120;
- Г. КАЛАЈЦИЕВ /Т. СТОЈАНОВСКИ, Критички осврт кон Законот за полиција, Билтен бр. 1, ФИООМ, Скопје, 2006, стр. 13-28;
- Г. КАЛАЈЦИЕВ, Какви полициски овластувања за Царинската управа, МРКПК, бр.1, 2006, 51-84;
- Г. КАЛАЈЦИЕВ, Замки и заблуди на реформата на истрагата, во Зборник на трудови на Правните факултети во Скопје и Загреб, Скопје/Zagreb, 2009, 165;
- Г. КАЛАЈЦИЕВ, Дали имаме правец за реформите, во: Реформи на македонското судство, Агтис, Прилеп, 2005;
- Г. КАЛАЈЦИЕВ, Реформа на истрагата во Република Македонија, во: Iustitia, Бр. 2, 2010, стр. 12;

- Г. КАЛАЈЦИЕВ, Позначајни концепциски разлики во реформата на истрагата во Хрватска и Македонија, во Зборник на трудови на Правните факултети во Скопје и Загреб, Zagreb, 2010;
- Г. КАЛАЈЦИЕВ/ Д. ИЛИЌ, Формирање, организација и функционирање на правосудната полиција и истражните центри на јавното обвинителство, МРКПК, бр.2, 2009, стр. 121-154;
- Ф. ЛОЈ, Организација на истрагите и на односите со судската полиција, Collection of texts, Twinning project: Fight against organized crime and corruption unit – Public Prosecutor’s Office, ISISC, Ohrid 2009;
- В. МАФЕО/ Џ. САНТАЛУЧИЈА, Истражна постапка, Collection of texts, Twinning project: Fight against organized crime and corruption unit – Public Prosecutor’s Office, ISISC, Ohrid 2009;
- J.-M. JEHLE / M. WADE (Eds.), Coping with Overloaded Criminal Justice Systems- The Rise of Prosecutorial Power across Europe, Göttingen, 2005;
- Н. МАТОВСКИ, Казнено процесно право, Општ дел, Скопје/ Штип, 2003;
- Н. МАТОВСКИ, Казнено процесно право, Посебен дел, Скопје/ Штип, 2004;
- Н. МАТОВСКИ /Г. БУЖАРОВСКА/ Г. КАЛАЈЦИЕВ, Казнено процесно право, Скопје/ Штип, 2009;
- М. MOSKOWITZ, Problems in Criminal Procedure: The Police, 4th edition, LexisNexis, 2004;
- D. NOVOSEL, Rezultati istraživanja u vezi rada policije, državnog odvjetništva i istražnog suca u predkaznenom (predistražnom) postupku – uhićenja i odbačaj kaznene prijave, МРКПК, год. 15, бр. 1, Скопје, 2008;
- D. NOVOSEL., Prijedlozi i predložena rješenja o istrazi i posebnim istražnim radnjama u nacrtu Zakona o kaznenom postupku Republike Hrvatske i tekstu prednacrtu Zakona o kaznenom postupku Republike Makedonije, МРКПК, год. 15, бр. 2-3, Скопје, 2008;
- В. PAVIŠIĆ, Europski sustavi kaznene istrage na početku trećeg milenija, во Зборник на трудови на Правните факултети во Скопје и Загреб, Скопје/Zagreb, 2007, 321-341;
- В. PAVIŠIĆ, Pogled na prethodni postupak u europskom kaznenom pravu, во: Suzbijanje kriminaliteta, Beograd-Kragujevac 2004, 463-469;
- В. PAVIŠIĆ, Ed. and G. Insolera, G. Giostra, Talijanski kazneni postupak, Pravni fakultet Sveučilišta u Rijeci, 2002;
- П. ПРОФИТИ, Нов однос помеѓу полицијата и јавното обвинителство, Collection of texts, Twinning project: Fight against organized crime and corruption unit – Public Prosecutor’s Office, ISISC, Ohrid 2009.
- K. REID, A Practitioner’s Guide to the European Convention on Human Rights, Sweet & Maxwell, London, 1998;
- Т. СТОЈАНОВСКИ, Балансот на моќта меѓу полицијата и јавниот обвинител, МРКПК, год. 15, бр. 1, Скопје, 2008;

88

- М. ТРОМБЕВА, Претходната постапка според новините во Нацрт текстот на ЗКП на РМ, во: *Iustitia*, Бр. 2, 2010, стр. 20;
- Т. ВИТЛАРОВ, Улогата на јавниот обвинител во новиот нацрт на ЗКП, во: *Iustitia*, Бр. 2, 2010, стр. 16;
- М. ШКУЛИЌ, Коментар Законика о кривичном поступку, Сл. Гласник, Београд, 2007.







CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

343.132(497.7) (035)

БУЖАРОВСКА ГОРДАНА

Истражни дејствија : прирачник за практичари / [автори Гордана Бужаровска,
Дејвид Ре, Мајкл Г. Карнасас], - Скопје : OSCE, 2010 - 264 стр ; 21 см

Текст на мак., алб., и англ., јазик. - фусноти кон текстот -
Библиографија: стр. 91 - 94 ; 177 - 180 ; 261 - 264. -
Содржи: Vepimet hetimore ; Investigative activities

ISBN 978-608-4630-08-1

1. Ре, Дејвид [автор] 2. Карнасас Мајкл Г. [автор]. - I. Buzharovska, Gordana види
Бужаровска Гордана. - II Buzharovska Gordana види Бужаровска Гордана
а) Кривична постапка - Истражни дејства - Македонија - Прирачници
COBISS.MK-ID 86374154

The content of this publication does not necessarily represent
the view or the position of the OSCE Spillover Monitor Mission to Skopje.

Copyright:
OSCE Spillover Monitor Mission to Skopje
Oktomvriska Revolucija bb
Hyperium Building, Skopje
www.osce.org/skopje

INVESTIGATIVE ACTIVITIES

A GUIDEBOOK FOR PRACTITIONERS

December 2010

osce Organization for Security and
Co-operation in Europe
Spillover Monitor Mission to Skopje



Authors:

Investigative activities under the new law on criminal procedure*

Comparative practices on investigation

by David Re

Guidelines on investigative activities

by Michael G. Karnavas

** Prepared by Prof. Gordana Buzarovska, Ph.D
in cooperation with Prof. Gordan Kaladjiev, Ph. D*

6

■ CONTENTS

SECTION 1. INVESTIGATIVE ACTIVITIES UNDER THE NEW LAW ON CRIMINAL PROCEDURE	11
1. INTRODUCTORY COMMENTS.....	11
2. ABANDONMENT OF THE COURT INVESTIGATION	11
2.1. Brief analysis of the investigation system under the current Law on Criminal Procedure	11
2.2. Main reasons for abandonment of court investigation.....	13
3. NEW RELATIONSHIP BETWEEN THE PROSECUTION AND THE POLICE	15
3.1. Establishment of the Judiciary police	15
3.2. Investigation centers of the Public Prosecutor's Office	16
4. COURSE OF THE PRELIMINARY PROCEEDINGS	17
4.1. Pre-investigative procedure	18
4.2. Investigation procedure	23
5. INVESTIGATION ACTIONS	26
5.1. Search	27
5.2. Temporary security and confiscation of objects or property	28
5.3. Questioning the suspect	28
5.4. Examining the witnesses	29
5.5. Ekspertise	30
5.6. Site inspection and reconstruction	30
6. SPECIAL INVESTIGATIVE MEASURES.....	31
7. INVESTIGATIONS BY THE DEFENSE.....	32

SECTION 2. COMPARATIVE PRACTICES ON INVESTIGATION	35
1. INTRODUCTION	35
2. ENGLAND AND WALES (UNITED KINGDOM)	36
2.1. Introduction and overview	36
2.2. The role of the police as investigator	37
2.3. The role of the prosecutor	40
2.4. Charging suspects with criminal offences.....	40
2.5. Investigations by the Prosecutor	42
2.6. Role of defence counsel	42
2.7. Disclosure of evidence	43
3. ITALY	44
3.1. Introduction	44
3.2. The prosecutor as investigator	45
3.3. The role of the preliminary proceedings judge giudice	46
3.4. Interrogation of a person under investigation, suspect or defendant and their rights	47
3.5. The end of the investigation	48
3.6. The preliminary hearing	49
3.7. The rights of the defendant and defence investigations	50
4. BOSNIA AND HERZEGOVINA	51
4.1. Introduction	51
4.2. Pre-trial custody	52
4.3. Role of the prosecutor	53
4.4. The role of the defence in the investigation stage.....	55
5. INTERNATIONAL CRIMINAL COURTS AND TRIBUNALS	55
5.1. Introduction and overview	55
5.2. The International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia.....	56
5.3. The International Criminal Court	58
5.4. European Court of Human Rights	60

